



INDEKSI I REFORMËS GJYQËSORE



KOSOVË

VËLLIMI III
GUSHT 2007



ABA RULE OF LAW INITIATIVE



INDEKSI I REFORMËS GJYQËSORE

PËR

KOSOVË

Gusht 2007

© Shoqata e Avokatëve Amerikanë

VËLLIMI III

Deklaratat dhe analizat e dhëna në këtë dokument, përfaqësojnë punën e Shoqatës së avokatëve amerikanë/Iniciativa për sundimin e ligjit. Deklarimet dhe analizat e shprehura këtu janë vetëm të autorëve dhe nuk janë të miratuara nga Dhoma e delegatëve ose nga Bordi i drejtorëve të Shoqatës së avokatëve amerikanë, dhe nuk përfaqësojnë qëndrimin e as politikën e Shoqatës së avokatëve amerikanë. Gjithashtu, asnjë përmbajtje nga ky raport nuk duhet konsideruar si dhënie e këshillës juridike për rastet specifike, dhe lexuesit janë vetë përgjegjës për nxjerrjen e këshillës nga konsulta e tyre ligjore individuale. Ky raport është bërë i mundshëm si rezultat i mbështetjes zemërgjerë të popullit amerikan të dhënë përmes Agjencisë të SH.B.A-ve për zhvillim ndërkombëtar (USAID). Shoqata e avokatëve amerikanë/Iniciativa për sundimin e ligjit bartë përgjegjësinë për përmbajtjen e këtij raporti dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimin e USAID-it ose të Qeverisë të Shteteve të Bashkuara.

ISBN: 978-1-60442-007-7

13 Digit ISBN: 978-1-60442-008-1

Shtypur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Të drejtat autoriale © 2007 nga Shoqatat e Avokatëve Amerikanë
740 15th Street, NW, Washington, D.C. 20005

TABELA E PËRMBAJTJES

Parathënie	i
Përmbledhje ekzekutive.....	1
Historia e shkurtër e Kosovës.....	4
Historiku i gjyqësisë	5
Organizimi i gjykatave	7
Kushtet e shërbimit	8
Analiza e IRGJ-së 2007 për Kosovë.....	9
Tabela e korrelacioneve të faktorëve	11
I. Cilësia, arsimimi dhe diversiteti.....	12
Faktori 1: Kualifikimi dhe përgatitja e gjyqtarëve	12
Faktori 2: Procesi i përzgjedhjes/emërimit.....	14
Faktori 3: Arsimitimi i vazhdueshëm ligjor	16
Faktori 4: Përfaqësimi gjinor dhe i pakicave	18
II. Pushteti gjyqësor	22
Faktori 5: Rishqyrtimi gjyqësor legjislativ.....	22
Faktori 6: Mbikëqyrja gjyqësore e veprimtarisë administrative.....	23
Faktori 7: Juridiksioni gjyqësor ndaj lirive qytetare	25
Faktori 8: Sistemi i vendosjes sipas ankesës	26
Faktori 9: Mospërfilljet/thirrjet/ekzekutimet	28
III. Resurset financiare	31
Faktori 10: Të hyrat buxhetore.....	31
Faktori 11: Mjaftueshmëria e rrogave të gjyqësorit.....	34
Faktori 12: Ndërtesat (objektet) e gjykatave	35
Faktori 13: Siguria e gjyqësorit	36
IV. Masat mbrojtëse strukturore.....	38
Faktori 14: Mandati i garantuar	38
Faktori 15: Kriteret objektive për avancim në gjyqësi	39
Faktori 16: Imuniteti i gjyqtarëve për veprimet zyrtare.....	40
Faktori 17: Shkarkimi dhe disiplina për gjyqtarë	41
Faktori 18: Caktimi i lëndëve.....	43
Faktori 19: Shoqatat e gjyqtarëve	45
V. Llogaridhënia dhe transparencë.....	46
Faktori 20: Vendimet gjyqësore dhe ndikimi i pavend	46
Faktori 21: Kodi i Etikës	48
Faktori 22: Procesi ankimor për sjellje gjyqësore	50
Faktori 23: Qasja e publikut dhe mediave në procedurë	51
Faktori 24: Publikimi i vendimeve gjyqësore.....	53
Faktori 25: Mirëmbajtja e procesverbalit gjyqësor	55
VI. Efikasiteti.....	57
Faktori 26: Stafit përkrahës i gjykatave.....	57
Faktori 27: Pozitat gjyqësore	58
Faktori 28: Depozitimi i lëndëve dhe sistemi i përcjelljes	60
Faktori 29: Kompjuterët dhe pajisjet e zyrës.....	61
Faktori 30: Shpërndarja dhe renditja e ligjit të tanishëm	62

Parathënie

Indeksi i Reformës Gjyqësore (IRGJ) është një mjet vlerësues i cili aplikohet nga Shoqatat e Avokatëve Amerikan (ABA) – Iniciativa për sundimin e ligjit. Në vitin 2001 ishte zhvilluar nga Iniciativa Ligjore për Evropën Qendrore dhe Euro-Azinë (ABA/CEELI), tani pjesë e Iniciativës për sundimin e ligjit, së bashku me pjesët tjera rajonale nga Afrika, Azia, Amerika Latine dhe Lindja e Mesme/Afrika Veriore. Qëllimi i këtij vlerësimi është të analizohen faktorët kyç sektorial dhe të rëndësishëm për reformimin e gjyqësisë në demokracitë e reja. Në një epokë në të cilën reformat ligjore dhe të gjyqësisë janë duke tërhequr shumë e më shumë vëmendje se sa në të kaluarën, IRGJ duket të jetë një mekanizëm vlerësues që është i duhur, i rëndësishëm dhe i përshtatshëm. IRGJ do t'i mundësojë Iniciativës për sundimin e ligjit, themeluesit e saj dhe vetë demokracitë të posa lindura, që më mirë t'i caktojnë programet reformuese të gjyqësisë dhe ta përcjellin progresin e arritur drejt krijimit të një gjyqësori llogaridhënës, efektiv dhe të pavarur.

Iniciativa për sundimin e ligjit e ka nisur këtë projekt duke kuptuar se nuk ka pajtim uniform të të gjitha veçantive të cilat përfshihen në reformën e gjyqësisë. Në veçanti, Iniciativa për sundimin e ligjit pranon se ka diferenca nëpër kultura të ndryshme juridike dhe të cilat disa çështje i bëjnë më shumë ose më pak relevante për një kontekst të caktuar. Megjithatë, pas një dekade të punës në terren lidhur me këtë çështje, Iniciativa për sundimin e ligjit ka përfunduar se secili nga tridhjetë faktorët e analizuar në këtë vlerësim, mund të ketë ndikim të rëndësishëm në procesin e reformës gjyqësore. Prandaj, ekzaminimi i këtyre faktorëve krijon bazën mbi të cilën mund të vendosen programet për asistencë teknike dhe mbi të cilën mund të vlerësohen elementët e rëndësishëm të procesit reformues.

Karakterit teknik i IRGJ-së e dallon këtë lloj të mjetit vlerësues nga vlerësimet tjera të pavarura të karakterit të ngjashëm, siç janë, p.sh., Raporti i Departamentit të Shtetit mbi të drejtat e njeriut dhe praktikat në vendet tjera dhe Vendet në Tranzicion të Freedom House. Ky vlerësim *nuk* jep komente përshkruese mbi gjendjen e përgjithshme të gjyqësisë në vendin e caktuar. Para së gjithash me këtë vlerësim identifikohen kushtet specifike, dispozitat ligjore dhe mekanizmat ekzistues në sistemin gjyqësor të vendit dhe bën analizën e asaj se në çfarë shkalle këto përputhen me kriteret specifike për reforma gjatë kohës kur kryhet vlerësimi. Përveç kësaj, ky proces analitik nuk është anketim shkencor statistikor. IRGJ është para se gjithash një hetim ligjor i cili mbështetet në burime të ndryshme të informatave të cilat e përshkruajnë sistemin ligjor të vendit.

Vlerësimi i angazhimeve reformuese

Vlerësimi i progresit të vendit në reformimin e gjyqësisë është i mbushur plot me sfida. Asnjë kriter i vetëm nuk mund të shërbejë si "hajmali" dhe shumë prej faktorëve të shqyrtuar vështirë se mund të maten. Për shembull, koncepti kyç për një gjyqësi të pavarur orientohet qenësisht kah cilësia dhe nuk mund të matet thjeshtë me njejen e numrit të gjyqtarëve ose sallave të gjykimit në një vend. Është vështirë të gjendet dhe të interpretohet "dëshmia(prova) mbi paanësinë, mendje-ngushtësinë dhe shkallën e autoritetit të gjyqësorit si institucion." Larkins, *Judicial Independence and Democratization: A Theoretical and Conceptual Analysis*, 44 AM. J. COMP. L. 611 (1996). Larkini citon këto defekte nga përpjekjet e mëparshme për matjen e pavarësisë së gjyqësorit:

(1) mbështetja në indikatorët formal mbi pavarësinë e gjyqësorit e të cilët nuk i përgjigjen realitetit, (2) mungesa e informatave të duhura mbi gjykatat, gjë që është e përbashkët për studimet e ngjashme të gjyqësorit, (3) vështirësitë gjatë interpretimit të rëndësishë së rezultateve të gjyqësorit, ose (4) natyra arbitrare e përcaktimit të vlerësimeve (notave) numerike ndaj disa prej attributeve të pavarësisë së gjyqësorit. *Id.* at 615.

Larkins vazhdon më tuje duke kritikuar në mënyrë specifike studimin e vitit 1975 nga autori David S. Clark, i cili mëtonte ta masë numerikisht autonominë e gjykatave supreme Latine-Amerikane. Gjatë zhvillimit të metodës për “shkallën e efektivitetit gjyqësor”, Clark ka përfshirë treguesit siç janë, garancitë e mandatit, mënyra e shkarkimit, mënyra e emërimit dhe garancitë e pagave. Clark, *Judicial Protection of the Constitution in Latin America*, 2 HASTINGS CONST. L. Q. 405 – 442 (1975).

Problemi megjithatë është se këta tregues formalë për pavarësinë e gjyqësisë shpeshherë nuk i përgjigjen realitetit. Për shembull, edhe pse gjyqtarët e Gjykatës Supreme të Argjentinës kishin garanci të mandatit, ajo ishte spastruar së paku pesë herë që nga viti 1940 dhe deri më tani. Duke përfshirë këta faktorë, Clark e ka mbi-vlerësuar pavarësinë e disa gjykatave të disa shteteve, duke i vendosur disa prej gjykatave të disa shteteve sikur ai i Brazilit përpara gjykatave të Kosta Rikës – shtet ky që përgjithësisht shihet se e ka pushtetin gjyqësor më të pavarur në gjithë Amerikën Latine.

Larkins, *supra*, 615.

Mbështetja në kriteret subjektive para atyre objektive në mënyrë të barabartë mund t'i nënshtrohet kritikës. P.sh., Larkins, *supra*, 618 (që e kritikon si pak më shumë se thashetheme metodën e cila ndërthen votimin e 84 sociologëve lidhur me gjykatat e Amerikës Latine). Gjithashtu, nuk mund të nxirren informata domosdoshmërisht të besueshme përmes intervistave me gjyqtarë: “[Gjyqtarët nuk do të pranojnë se kanë ardhur në përfundimin e caktuar për shkak të presionit nga aktori i caktuar; në vend të kësaj, ata më parë do të zgjidhnin që ta fshehin mungesën e autonomisë së tyre].” Larkins, *supra*, 616.

Metodologjia

Në projektimin e metodologjisë për IRGJ-në, Iniciativa për sundimin e ligjit ka mëtuar të adresojë këto çështje dhe kritika duke përfshirë të dy kriteret ato subjektive dhe objektive, si dhe duke i bazuar kriteret e shqyrtuara në disa prej normave ndërkombëtare kryesore, siç janë ato të parapara në *Parimet themelore të Kombeve të Bashkuara mbi pavarësinë e gjyqësisë* dhe *Parimet e Bangalore-s mbi sjelljen gjyqësore*. Përveç kësaj, këto kriteret mund të mbështeten gjithashtu edhe në normat e elaboruara në dokumentet e karakterit rajonal, sikurse është *Rekomandimi i Këshillit të Evropës R(94)12 “mbi pavarësinë, efikasitetin dhe rolin gjyqtarëve”*; Karta evropiane mbi statutin e gjyqtarëve; Deklarata e Pekinit mbi parimet e pavarësisë së gjyqësorit në rajonin *LAWASIA*; Konferencat arabe të drejtësisë në Bejrut dhe Deklarata e Kajros mbi pavarësinë e gjyqësisë; dhe Deklarata e Karakasit nga Samiti ibero-amerikan i kryetarëve të gjykatave dhe tribunaleve supreme. Gjithashtu, është referuar edhe në Koncept dokumentin mbi pavarësinë e gjyqësisë, i përgatitur nga ABA/CEELI dhe kriteret e përdorura nga Shoqata Ndërkombëtare e Gjyqtarëve me rastin e shqyrtimit të kërkesave për anëtarësim.

Mbështetur në këto norma, Iniciativa për sundimin e ligjit ka përmbledhur një seri prej 30 deklaratave me të cilat paraqiten faktorët të cilët e lehtësojnë zhvillimin e një gjyqësori të përgjegjshëm, efektiv dhe të pavarur. Për t'ju ndihmuar ekspertëve vlerësues për evaluimin e këtyre faktorëve, Iniciativa e sundimit të ligjit e ka zhvilluar komentimin korrespondues në të cilin citohen bazat e deklaratës dhe ku diskutohet rëndësia e saj. Angazhim i posaçëm është bërë për t'ju shmangur dhënies së konsideratës më të lartë për konceptet amerikane karshi atyre rajonale lidhur me strukturën dhe funksionin e gjyqësisë. Prandaj, për disa faktorë që janë përfshirë, gjyqtari amerikan ose evropian mund të jenë deri-diku të panjohur dhe kjo duhet kuptuar si intencë për të kapur atë më të mirën që mund ta ofrojnë kulturat gjyqësore udhëheqëse. Për më tepër, Iniciativa e sundimit të ligjit i ka shqyrtuar faktorët veç e veç bazuar në përvojën e vet që kalon një dekadë dhe ka përfunduar se secili faktor mund të ketë ndikim në procesin e reformës gjyqësore. Rrjedhimisht, edhe kur disa prej faktorëve nuk janë të pranuar në mënyrë universale si elemente themelore, Iniciativa e sundimit të ligjit e konsideron vlerësimin e tyre si të dobishëm dhe të justifikuar nga aspekti programor. Kategoritë e përfshira trajtojnë cilësinë, arsimimin dhe llojllojshmërinë e gjyqtarëve; kompetencën dhe autorizimet gjyqësore; masat mbrojtëse financiare dhe strukturore; logaridhënien dhe transparencën; dhe çështjet që ndikojnë në efikasitetin e gjyqësorit.

Pyetja se a duhet zbatuar mekanizmin e “notave” ishte një prej aspekteve më të vështira dhe kundërtëdhënëse të këtij projekti, dhe Iniciativa e sundimit të ligjit e ka diskutuar në mënyrë interne nëse këtë duhet përfshirë apo jo. Gjatë periudhës 1999-2001 Iniciativa për sundimin e ligjit ka testuar mekanizma të ndryshëm të “notimit”. Pas një diskutimi të gjallë me anëtarët e bordeve ekzekutive dhe këshilluese të ABA/CEELI-it, si dhe me ekspertët e jashtëm, Iniciativa e sundimit të ligjit ka vendosur të heqë dorë nga çdo përpjekje për ofrimin e një notimi të përgjithshëm të progresit të reformës të një vendi për ta bërë absolutisht të qartë se IRGJ nuk synon realizimin një vlerësimi të plotë të sistemit gjyqësor.

Përkundër këtij konkluzioni të përgjithshëm, Iniciativa e sundimit të ligjit ka përfunduar se vlerësimet cilësore mund të bëhen përkitazi me faktorët specifikë. Përshtatshëm, secilit faktor ose secilës deklaratë i jepet njëra nga tri vlerat: *pozitive*, *neutrale*, ose *negative*. Këto vlera vetëm e reflektojnë marrëdhënien e asaj deklarate me sistemin gjyqësor të atij vendi. Aty ku deklarata i përgjigjet fuqishëm realitetit të vendit të caktuar, atij vendi i jepet nota “pozitive” për atë deklaratë. Mirëpo, kur deklarata nuk përfaqëson fare kushtet ekzistuese në atë vend, atëherë jepet nota “negative”. Kur kushtet brenda një vendi përgjigjen në njëfarë mënyre kurse në tjerat jo, atëherë do të jepet nota “neutrale”. Cf. Cohen, *The Chinese Communist Party and 'Judicial Independence': 1949-59*, 82 HARV. L. REV. 972 (1969) (ku sugjerohet se shkalla e pavarësisë së gjyqësisë ekziston në vazhdimësi prej “një gjyqësori tërësisht të çliruar në atë tërësisht të nënshtruar (servil)”. Prapë, si u përmend më lart, Iniciativa e sundimit të ligjit ka vendosur mos të bëjë notim të përgjithshëm, sepse bazuar në kritikën e Larkinit, Iniciativa e sundimit të ligjit konsideron se një përpjekje e tillë e notimit të përgjithshëm do të jetë kundër produktiv.

Në vend të kësaj, rezultatet e 30 vlerësimeve të ndara janë mbledhur në një format të standardizuar për secilin vlerësim vendor të IRGJ-së. Pas secilit faktor ekziston korrelacioni i vlerësuar dhe përshkrimi i bazës së konkluzionit. Krahas kësaj, përfshihet analiza e thellë ku paraqiten në hollësi çështjet e ndryshme përkatëse. Paraqitja në katalog e të dhënave në këtë mënyrë lehtëson futjen e shënimeve në bazën e të dhënave dhe i mundëson shfrytëzuesit e fundit që në mënyrë të lehtë ta krahasojnë dhe bëjnë dallimin e performancës në vendet e ndryshme në çështjet specifike dhe – me azhurnimin e IRGJ-ve – në një vend të caktuar gjatë kohës së caktuar.

Përcjellja e zbatimit të vazhdueshëm të IRGJ, do të bëhet duke pasur parasysh disa qëllime. Së pari, do të nxirren raportet më të reja mbi gjyqësinë nëpër vendet në tranzicion dhe të demokracive të reja, duke nënvizuar zhvillimet më të rëndësishme ligjore, gjyqësore, e madje edhe politike dhe si ndikojnë ato në përgjegjshmërinë, efikasitetin dhe pavarësinë e gjyqësisë. Raportet gjithashtu do të identifikojnë se deri në çfarë shkalle pjesëtarët e gjyqësisë dhe të tjerët i kanë trajtuar mangësitë e identifikuar nga vlerësimet e mëhershme të IRGJ-ve. Zbatimi periodik i vlerësimeve IRGJ do të regjistrojë ato fusha ku ka pasur prapavajtje në fushën e pavarësisë së gjyqësisë, do të shënojë fushat ku angazhimet drejt reformimit të gjyqësisë kanë ngecur dhe kanë pasur shumë pak ose fare ndikim, dhe do të dallojnë sukseset dhe përmirësimet në angazhimet reformuese në gjyqësi. Përfundimisht, duke kryer vlerësimet IRGJ në mënyrë të rregullt, Iniciativa për sundimin e ligjit do të vazhdojë të shërbejë si burim i informacionit me kohë dhe analizës së gjendjes së pavarësisë së gjyqësisë dhe reformës në demokracitë e porsalindura dhe shtetet në tranzicion.

Struktura e përgjithshme e raporteve përcjellëse të IRGJ si dhe metodologjia do të mbetet e pandryshuar me qëllim të mundësimin të analizës së saktë historike dhe krahasimeve të besueshme gjatë kalimit të kohës. Mirëpo, mësimet e fituara kanë sjellë ngritje të cilësisë të hulumtimit vlerësues, që ka për qëllim ngritjen e njëtrajtshmërisë dhe hollësive të mbledhjes së të dhënave. Një pjesë e kësaj ngritje të cilësisë përfshinë zhvillimin e më shumë hulumtimeve të hollësishme dhe strukturuar të cilat do të udhëheqin me mbledhjen dhe raportimin e informatave dhe të dhënave.

Raportet përcjellëse të IRGJ-ve do të vlerësojnë të gjithë 30 faktorët e IRGJ-së. Ky proces do të përfshijë ekzaminimin e të gjitha ligjeve, akteve normative dhe dispozitave, dhe burimeve tjera të autorizimeve të cilat i takojnë organizimit dhe veprimtarisë së gjyqësisë, dhe prapë do të shfrytëzojë procesin e intervistave informative kyçe duke u mbështetur në perspektivat e dhjetëra ose më shumë gjyqtarëve, avokatëve, profesorëve të drejtësisë, drejtuesve të OJQ-ve dhe gazetarëve të cilët janë të njohur thellësisht me funksionimin e gjyqësisë. Me rastin e kryerjes së vlerësimeve përcjellëse, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet atyre faktorëve të cilët në vlerësimet e mëparshme kanë marrë vlerësime negative.

Secilit faktor prapë do t'i caktohet vlera gjegjëse pozitive, neutrale ose negative si pjesë e zbatimeve përcjellëse të IRGJ-ve. Krahas kësaj, të gjitha raportet vlerësuese përcjellëse do ta identifikojnë natyrën e ndryshimit të korrelacionit ose trendin e ndryshimit që nga vlerësimi paraprak. Ky trend do të shënohet në Tabelën e korrelacionit të faktorëve që paraqitet në raportet e IRGJ-ve dhe do të shënohet edhe në katrorin e konkluzioneve për secilin faktor në formën uniforme të raporteve të IRGJ-ve. Do të përdoren simbolet si në vijim: ↑ (trend në ngritje; përmirësim); ↓ (trend në ulje; prapavajtje); dhe ↔ (pa ndryshime; pak ose fare ndikim).

Sociologët mund të argumentojnë se disa prej kriterëve vlerësues më së miri do të vërtetoheshin përmes anketave të opinionit publik ose përmes intervistave më intensive të juristëve ose personelit të gjykatave. Duke qenë të ndjeshëm ndaj kostos dhe kufizimeve kohore penguese në këtë drejtim, Iniciativa për sundimin e ligjit ka vendosur t'i organizoj këto çështje ashtu që në ato të mund të jepeshin përgjigjet nga pyetjet e kufizuara që do t'i bëheshin një pjesë të gjyqtarëve, avokatëve, gazetarëve dhe vëzhguesve të jashtëm me njohuri të hollësishme mbi sistemin gjyqësor. Në përgjithësi IRGJ ka për qëllim të zbatohet menjëherë nga një ose më shumë specialistë ligjor të cilët kanë njohuri të përgjithshme mbi vendin dhe rajonin dhe i cili do të mbledhte informata objektive dhe do të realizonte intervistat e nevojshme për vlerësimin e secilit prej këtyre faktorëve.

Një prej qëllimeve të procesit të vlerësimit IRGJ është të ndihmohet Iniciativa për sundimin e ligjit – dhe financuesit e saj dhe organizatave të ngjashme – në përcaktimin e efikasitetit të programeve të tyre për reformimin e gjyqësisë dhe të ndihmohet në caktimin e asistencës në të ardhmen. Sigurisht se shumë prej çështjeve të ngritura (siç janë, pagat e gjyqtarëve dhe ndikimet nga jashtë) nuk mundën domosdoshmërisht të trajtohen në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe efektive nga ana e ofruesve të jashtëm të asistencës teknike. Iniciativa e sundimit të ligjit pranon po ashtu se ato fusha të reformës gjyqësore të cilat mund të trajtohen nga të jashtëm, sikur që është trajnimi gjyqësor, mund të mos jenë ato më të rëndësishmet. Edhe posedimi i kuadrit më të mirë gjyqësor në botë nuk jep garanci për një gjyqësor të përgjegjshëm, efektiv dhe të pavarur; por në anën tjetër çdo gjyqësor ka nevojë të jetë i trajnuar mirë. Gjithashtu, lidhja midis ndihmës nga jashtë dhe gjyqësorit të një vendi mund të jetë e parëndësishme: ndërtimi i një gjyqësori vërtetë kompetent kërkon vullnetin real politik dhe dedikimin nga vendi që ndjekë reformën. Sido që të jetë, është e rëndësishme të ekzaminohen fushat kyçe me kriteret të cilat janë të matshme në mënyrë që elementet progresive të fokusohen më mirë në angazhimet për reforma. Iniciativa për sundimin e ligjit e ofron këtë produkt si një hap konstruktiv në këtë drejtim dhe mirëpret përgjigjen po ashtu konstruktive.

Mirënjohjet

Lisa Dickieson, drejtoreshë e Programeve për reforma gjyqësore nga Shoqata e avokatëve amerikanë – Iniciativa ligjore për Evropën Qendrore dhe Lindore (prej v. 1995 deri në v. 2000), dhe Mark Dietrich, anëtar i Odës së avokatëve të shtetit të Nju Jorkut dhe këshilltar i ABA/CEELI-it, e kanë krijuar konceptin origjinal dhe projektin e IRGJ-së. Scott Carlson, drejtor i Programeve për reforma gjyqësore pranë ABA/CEELI (2000-2003) ka drejtuar finalizimin e IRGJ-së. Ndihmën në hulumtime dhe në përpilimin e IRGJ-së e ka dhënë Jenner Bryce Edelman, bashkëpunëtor profesional i programit pranë ABA/CEELI-it, dhe James McConkie, student praktikant në ABA/CEELI.

Gjatë zhvillimit të IRGJ-së, Iniciativa për sundimin e ligjit ka përfituar qenësisht nga dy grupe këshilluese ekspertësh. Iniciativa për sundimin e ligjit dëshiron të falënderojë anëtarët e Bordit të parë këshillues gjyqësor të ABA/CEELI-it 's, duke përfshirë këtu Tony Fisser, Marcel Lemonde, Ernst Markel, Joseph Nadeau, Mary Noel Pepys, dhe Larry Stone, të cilët i kanë shqyrtuar versionet e para të këtij indeksi. Krahas kësaj, Iniciativa për sundimin e ligjit dëshiron të falënderojë anëtarët e Bordit të dytë këshillues gjyqësor, duke përfshirë këtu Luke Bierman, Macarena Calabrese, Elizabeth Dahl, Elizabeth Lacy, Paul Magnuson, Nicholas Mansfield, Aimee Skrzekut-Torres, Roy T. Stuckey, Robert Utter, dhe Russell Wheeler, të cilët janë kujdesur për përfundimin e tij. Në fund, Iniciativa për sundimin e ligjit gjithashtu dëshiron të shpreh vlerësimin për ekspertët të cilët kanë kontribuar në hartimin e Dokumentit koncept të ABA/CEELI-it për pavarësinë gjyqësore: James Apple, Dorothy Beasley, Nicholas Georgakopolous, George Katrougalos, Giovanni Longo, Kenneth Lysyk, Roy Schotland, Terry Shupe, Patricia Wald, dhe Markus Zimmer.

Ekipi vlerësues

IRGJ i vitit 2007 për Kosovën – ekipi vlerësues ishte udhëhequr nga i nderuari Evelyn B. Lance, gjyqtar i pensionuar i shtetit të Havait dhe vullnetar i kamotshëm i programeve ndërkombëtare të sundimit të ligjit të ABA-s me ndihmën e asistentit ligjor Arianit Osmani. Ekipi ka përfituar nga një përkrahje e fuqishme e stafit të Inicativës për sundimin e ligjit në Prishtinë dhe Uashington, D. C., duke përfshirë këtu drejtorin e zyrës për Kosovë - David Sip, specialisten ligjore Kathy Ladun, drejtorin rajonal Robert Lochary, drejtorin për hulumtime dhe programe Simon Conté, zyrtarët e programeve Melissa Zelikoff dhe Laura Berger, si dhe Judith Goeke. Olga Ruda, koordinatore e hulumtimit dhe analisti ligjor Brenner Allen kanë dhënë udhëzime gjatë tërë procesit të vlerësimit, kanë shërbyer si recensentë, dhe kanë përgatitur publikimin e raportit. Konkluzionet dhe analizat janë bazuar në intervistat e kryera në Kosovë gjatë muajit korrik 2007 dhe dokumentet relevante të cilat janë shqyrtuar gjatë asaj kohe. Shënimet mbi autoritetet relevante dhe lista fshehtë e individëve të intervistuar janë pjesë e dosjes që gjendet në zyrën e Inicativës për sundimin e ligjit në Uashington, D. C. Ekipi vlerësues është jashtëzakonisht mirënjohës për kohën dhe ndihmesën e dhënë nga ata që janë pajtuar intervistohen për qëllimet e këtij projekti.

Përmbledhje ekzekutive

Pasqyrë e shkurtër e rezultateve

Indeksi i reformës gjyqësore 2007 (IRGJ) për Kosovë, demonstroi se ka përparim të përgjithshëm në reformën gjyqësore, përkundër disa sprovave dhe shqetësimeve në rritje e sipër lidhur me disa prej kushteve. Prej 30 faktorëve të analizuar në këtë vlerësim, korrelacionet e caktuara për 7 faktorë kanë shënuar përparim që prej vitit 2004 e këndeje, ndërsa 3 faktorë (ata që kanë të bëjnë me objektet e gjyqësorit; procesin dhe kriteret për avancim në punë; dhe pozitën për gjyqtarë) kanë demonstruar rënie. Përparimet më të mëdha dhe të dukshme janë kanë ndodhur në fushën e përgatitjes dhe arsimimit të gjyqtarëve, si para emërimit ashtu edhe gjatë mandatit të funksionit gjyqësor. Krahas kësaj, faktorët që kanë të bëjnë me procedurën e apelit si dhe të kodit të etikës janë përmirësuar prej korrelacionit neutral në atë pozitiv dhe faktorët që kanë të bëjnë me mbrojtjen gjyqësore të lirive qytetare dhe me procesin e buxhetit, janë përmirësuar prej korrelacionit negativ në atë neutral. Në përgjithësi, 6 faktorë kanë marrë korrelacion pozitiv në vitin 2007, krahasuar me vetëm një faktor pozitiv (që ka të bëjë me qasjen e publikut në procedurë gjyqësore) në vitin 2004. Gjithsejtë 12 faktorëve u është dhënë korrelacioni neutral që është më pak se krahasuar me 18 faktorë të tillë nga IRGJ-ja e vitit 2004 për Kosovë. Numri i faktorëve me korrelacion negativ është shtuar prej 11 në 12 syresh.

Shumë prej përmirësimeve të demonstruara midis viteve prej 2004 deri në 2007, janë rezultat i miratimit të legjislacionit të nevojshëm për një gjyqësor funksional dhe të pavarur, siç është rasti i miratimit të Kodit të etikës gjyqësore – 2006, si dhe rezultat i përmirësimit të përgjithshëm të funksionimit të institucioneve të Kosovës. Shumë prej sfidave që ende burojnë nga dy prej shqetësimeve më të mëdha me të cilat ballafaqohen të gjitha institucionet qeveritare të Kosovës: shqetësimet dhe paqartësia politike lidhur me statusin e ardhshëm të Kosovës, të cilat e kanë ulur moralin dhe motivet për jetësimin e reformave dhe i kanë kufizuar resurset financiare përkatëse. Ashtu si janë ilustruar në këtë analizë të IRGJ-së, këto dy realitete ndikojnë në funksionimin e gjyqësorit në shumë drejtime.

Aspektet pozitive të identifikuara në IRGJ-në e Kosovës për vitin 2007

- Si zhvillim i rëndësishëm dhe më i fundit është **bartja e përgjegjësive të administrimit të gjykatave në Këshillin gjyqësor të Kosovës (KGJK)**, si organ i pavarur në kuadër të gjyqësisë dhe i cili pranon trajnime dhe mbështetje ndërkombëtare për ndërtimin e kapaciteteve të veta në shumë drejtime. Në mesin e përgjegjësive tjera KGJK është i ngarkuar me detyrën e përcaktimit të politikave administrative për gjyqësinë, përgatitjen dhe menaxhimin e buxheteve gjyqësore, dhe mbikëqyrjen e gjyqtarëve dhe gjykatave. Krahas kësaj, **KGJK-ja tani e mbikëqyrë veçanërisht procesin e përzgjedhjes së gjyqtarëve**, i cili zhvillohet në mënyrë transparente dhe bazohet në kriteret objektive si dhe ofron **mbrojtje të veçantë ligjore për kandidatët nga pakicat**. Gjithashtu ky Këshill luan një rol të rëndësishëm edhe në **shkarkimin dhe masat disiplinore për gjyqtarët**, një proces i cili zhvillohet **në mënyrë të drejtë, të rregullt dhe transparente**.
- Në vitet e fundit, është parë një **rritje e shkallës pavarësisë dhe efikasitetit të institucioneve gjyqësore**. Prandaj, edhe **Instituti gjyqësor i Kosovës** është shndërruar në institucion vendor dhe e ka **zgjerruar plan-programin mësimor** si për programin para emërimit gjyqësor ashtu edhe për kurset e arsimimit të vazhdueshëm ligjor për gjyqtarët, edhe pse këto programe ende nuk e kanë marrë karakterin detyrues. Edhe **Shoqata e gjyqtarëve të Kosovës i ka shtuar aktivitetet programore**, megjithëse deri më tani nuk ka pasur sukses të ndikojë në ndryshimet në gjyqësor.
- **Kodi i ri i etikës për gjyqtarë, i miratuar në vitin 2006**, është kryesisht gjithëpërfshirës dhe në shumë aspekte është i përafër me tekstin e Parimeve mbi sjelljen gjyqësore të Bangallores. **Të gjithë gjyqtarët janë trajnuar lidhur me Kodin e ri**, megjithëse këto trajnime ende nuk kanë marrë karakterin detyrues.

Shqetësimet lidhur me mungesën e financimit të mjaftueshëm

- Mungesa mbizotëruese e resurseve ekonomike ka ndikim në shumë aspekte të ndryshme të funksionimit të gjyqësisë. **Pagat e gjyqësorit nuk janë rritur që nga rritja e fundit për 5% në vitin 2002 dhe mbeten të ulëta** në krahasim me zyrtarët e lartë nga pushteti ligjvënës dhe ekzekutiv, si dhe në krahasim me avokatët me avokatura private. Kjo gjendje e bën të vështirë tërheqjen dhe ruajtjen e kandidatëve të kualifikuar gjyqësor, duke përfshirë këtu edhe kandidatët të përkatësisë etnike serbe të cilët siç raportohet marrin pozita të paguara më mirë nëpër gjykatat paralele ose në ato në Serbi. Mungesa e mjeteve rezultojnë gjithashtu edhe në **mungesë të personelit gjyqësor**. Të anketuarit kanë raportuar veçanërisht për mungesën e asistentëve juridikë (praktikantëve).
- Mjetet e pamjaftueshme së bashku me tensionet e vazhdueshme etnike, **krijojnë probleme që ndërlidhen me sigurinë e objekteve gjyqësore dhe të gjyqtarëve**. Përderisa gjyqtarët rrallë herë brengosen për sigurinë e tyre brenda objekteve të gjykatës, **shumë prej gjyqtarëve kanë pranuar kërcënime personale, ndërsa disa prej tyre kanë qenë objekt i dhunës fizike ose veprave penale ndaj pasurisë së tyre**. Nga gjendja në enklavat e serbëve etnikë, siç është rasti me veriun e Mitrovicës, burojnë shqetësime të jashtëzakonshme lidhur me sigurinë e gjyqësorit dhe këto probleme duhet tani të adresohen nga autoritetet gjyqësore.
- Gjithashtu, cilësia e infrastrukturës gjyqësore vuan si rezultat i resurseve të kufizuara financiare. Përkundër legjisllacionit i cili garanton gjykimin publik, **mungesa e hapësirës adekuate dhe stërmbushja me njerëz nëpër objektet e gjykatave ndikon negativisht në qasjen e publikut në seancat gjyqësore**. Procedura shpeshherë zhvillohet nëpër hapësirat e vogla siç janë zyrat e gjyqtarëve ku ka shumë pak vend për pjesëmarrjen e publikut dhe mediave. Kushtet e rënda nëpër objektet gjyqësore gjithashtu kanë **penguar vënien në përdorim të sistemeve teknologjike të avancuara** siç është rasti i përdorimit të audio incizimeve të sistemit “verbatim” të procesverbaleve. Mirëpo si aspekt pozitiv duhet përmendur se **gjykimet në përgjithësi janë të hapura** për publikun dhe **janë bërë përpjekje për ngritjen e vetëdijesimit të publikut dhe mediave** lidhur me të drejtat e tyre për të marrë pjesë në seancat gjyqësore.
- Përkundër shtimit të numrit të lëndëve të pazgjidhura dhe atyre në punë, **numri i pozitivave në sistemin gjyqësor ka shënuar rënie gjatë viteve të fundit**. Gjersa KGJK-ja ka paraparë nevojën për zhvillimin e sistemit për krijimin e pozitivave të reja gjyqësore, deri më tani një sistem i tillë ende nuk është krijuar. KGJK-ja gjithashtu ka kërkuar një rritje të bugjetit gjyqësor që do të mundësonte rritjen e numrit të gjyqtarëve për 25% në 2008; megjithatë, nuk është e sigurtë nëse kjo kërkesë do të përmbushet.
- **Ekzistojnë mangësi të theksuara tek stafi mbështetës në gjyqësor**. Këto mangësi në veçanti janë **mungesa asistencës ligjore për gjyqtarët**, shumica e gjyqtarëve janë të mbështetur në një numër të vogël praktikantësh. Edhe pse KGJK-ja së fundi ka aprovuar krijimin e programit një-vjeçar për praktikant në gjykata, ende nuk ka fonde të alokuara për praktikantët.

Shqetësimet lidhur me përzgjedhjen dhe mandatin e gjyqtarëve

- Problemet në vazhdimësi burojnë nga tensionet etnike në Kosovë, duke përfshirë **problemet që ndërlidhen me tërheqjen e kandidatëve nga pakicat etnike për pozitën në kuadër të sistemit gjyqësor**. Gjersa janë bërë përpjekje të cilat kanë hapur rrugë për zgjidhjen e këtyre problemeve, kanë mbetur ende shqetësime lidhur me **hezitimin e serbëve etnikë që të kërkojnë emërime për pozitën në gjyqësor**, dhe të cilat burojnë para së gjithash nga presioni të cilin e ushtrojnë familjet dhe komuniteti, si dhe nga frika prej rrezikut fizik. Krahas kësaj, **femrat vazhdojnë të jenë të nën-përfaqësuara** në gjyqësor dhe përderisa në një anë ekziston legjisllacioni i cili e promovon barazinë gjinore në gjyqësi, në anën tjetër shumë pak është bërë që kjo barazi të promovohet në praktikë.

- Ekziston një ***pasiguri e konsiderueshme përkitazi me mandatin e gjyqtarëve të Kosovës***, i cili për momentin është i ***ndërlidhur me kohëzgjatjen e administrimit të Misionit të KB-ve në Kosovë (UNMIK-ut)***. Në atë kohë, mandati i gjyqtarëve do të skadojë dhe pritet që të gjithë gjyqtarët t'i nënshtrohen një vlerësimi të caktuar mbi përshtatshmërinë e tyre për emërim. Në këtë kohë ***nuk ekziston ndonjë procedurë e caktuar për rizgjedhje dhe riemërim***. Mirëpo, parashikohet të themelohet Komisioni i pavarur gjyqësor dhe prokurorial (KPGJP) i cili do ta mbikëqyrë procesin e vlerësimit dhe të riemërimit. Themelimi i KPGJP-së pritet të fillojë në maj të vitit 2007; mirëpo, nënshkrimi i memorandumit të mirëkuptimit është shtyrë deri në pafund.
- ***Kriteret për avancim në gjyqësi nuk janë të parapara në mënyrë të veçantë me asnjë ligj***, dhe ***procesi i avancimit vetvetiu nuk është transparent***, gjë që rezulton në një kuptuar të përgjithshëm se avancimi në gjyqësi më parë lidhet ngushtë me lidhjet dhe miqësitë se sa me përvojën dhe zotësitë. Përderisa më parë ka ekzistuar një proces vlerësues i elaboruar të cilin e ka zhvilluar Këshilli gjyqësor dhe prokurorial i Kosovës, tani raportohet se ky këshill ka pushuar prej se KGJK-ja i ka marrë përsipër përgjegjësitë për avancimin e gjyqtarëve.

Shqetësimet tjera të identifikuara në IRGJ-në e Kosovës për vitin 2007

- ***Gjyqësorit edhe më tutje i mungojnë autorizimet për rishqyrtimin e kushtetutshmërisë së ligjeve*** që i miraton Kuvendi i Kosovës, ose për dhënien e komenteve mbi legjislacionin e tanishëm. Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme a ka pasur këtë detyrë në vitin 2001 por ky organ nuk është themeluar deri më tani. Në mënyrë të ngjashme, ***rregulloret e UNMIK-ut*** dhe aktet nënligjore përkatëse ***kanë mbetur jashtë mundësisë së rishqyrtimit*** si për gjyqësinë vendëse ashtu edhe për atë ndërkombëtare të Kosovës.
- Paqartësia lidhur me statusin e ardhshëm të Kosovës ka rezultuar në evolimin e shpejtë të ligjeve dhe institucioneve të Kosovës, dhe në ***karakter kundërtihënës dhe konfuz të miratimit të disa prej ligjeve të reja***, duke përfshirë edhe ligjet të cilat ndikojnë në funksionimin e gjyqësisë. Përkundër këtyre mangësive, tani për tani ekziston vetëm një ***sistem i kufizuar i shpërndarjes së ligjeve të reja***, dhe kjo shpërndarje nuk bëhet gjithherë në kohën e duhur.
- Ekzistojnë ***disa të meta përkitazi me menaxhimin e lëndëve*** nga gjyqësori. Këto përfshijnë: mungesën e procesit objektiv të caktimit të lëndëve; numrin e konsiderueshëm të lëndëve të pazgjidhura, veçanërisht të lëndëve për ekzekutimin e aktgjykimeve gjyqësore; përpilimi i dobët me shkrim i vendimeve gjyqësore; dhe mekanizma të kufizuar për të siguruar se vendimet gjyqësore shpallen me kohë ose për krijimin dhe mirëmbajtjen e procesverbaleve të sakta gjyqësore.

Historia e shkurtër e Kosovës

Konteksti juridik

Kosova ka qenë regjion administrativ në kuadër të Jugosllavisë për shumicën e kohës gjatë shekullit të njëzetë, çoftë si pjesë e “Serbisë Jugore” në kuadër të Mbretërisë së Jugosllavisë, gjatë periudhës ndërmjet dy luftërave botërore, ose si krahinë e Serbisë, brenda Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ-së), të krijuar më 1944. Me kushtetutën e RSFJ-së të vitit 1974 Kosova ka gëzuar statusin e “Krahinës Autonome” brenda Republikës së Serbisë, me pushtet mbi policinë, gjykatat dhe mbrojtjen civile, si dhe mbi politikën ekonomike, sociale dhe arsimore të cilat i janë marrë nga Serbia. Në vitin 1989, autonomia e Kosovës ishte kufizuar rëndë nga kryetari i Serbisë, Slobodan Millosheviqi. Gjatë asaj kohe më shumë se 80% shumicës shqiptare etnike ishin vendosur nën kushtet e gjendjes së luftës.

Në vitet 1997-1998 shpërtheu lufta në Kosovën e kontrolluar nga Serbia, kur Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK-ja) e filloi luftën politike dhe ushtarake për një Kosovë autonome, gjersa ushtria serbe dhe policia paraushtarake reagueshan duke u përpjekur ta thyejnë lëvizjen separatiste të UÇK-së. Pas një periudhe të konfliktit të ashpër lokal në vitin 1998, dhe periudhave të negociatave ndërkombëtare, në mars të vitit 1999, NATO-ja filloi luftën ajrore kundër Jugosllavisë. Pas luftës 78 ditëshe, forcat jugosllave u tërhoqën nga Kosova

Që nga ndërprerja e armiqësive të mëdha në qershor të vitit 1999, si protektorat i Kombeve të Bashkuara, Kosova është administruar nga administrata civile ndërkombëtare dhe prania ushtarake në pajtim me autorizimet e dhëna nga Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244 (10 qershor 1999) (më tutje në tekst Rezoluta 1244). Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), e udhëheqë administratën civile ndërkombëtare – Misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Janë tri organizata ndërkombëtare që bashkëpunojnë në udhëheqjen e 4 shtyllave të strukturës së UNMIK-ut: shtyllën I për “Policinë dhe Drejtësinë” (KB); shtyllën II “Administratën Civile” (KB); shtyllën III për “Demokratizim dhe Ngritje Institucionale” (Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE)); dhe shtylla IV për “Rindërtim Ekonomik” (Unioni Evropian (UE)). UNMIK ngarkohet me administrimin e Kosovës dhe deri në zgjidhjen përfundimtare të statusit të Kosovës, UNMIK-u do të vazhdojë të mbajë edhe më tutje, disa kompetenca, siç janë funksionet e policisë, mbrojtjes, punëve të huaja dhe disa çështje të drejtësisë. *Shih* Rezolutën 1244; *Shih gjithashtu* RREGULLOREN E UNMIK-UT NR. 2001/9 MBI KORNIZËN KUSHTETUESE PËR VETËQEVERISJE TË PËRKOHSHME NË KOSOVË, e ndryshuar me RREGULLOREN NR. 2002/9 [të dyja këtyre rregulloreve bashkërisht u referohemi si KORNIZË KUSHTETUESE]. Deri më sot, prania ndërkombëtare e sigurisë ka qenë e udhëhequr nga Forca e Kosovës – NATO [më tutje në tekst KFOR-], e ndarë nga UNMIK-u. Trupat e KFOR-it dhe personeli ndërkombëtar nuk i nënshtrohen autoritetit të UNMIK-ut, dhe gëzojnë imunitet nga sistemi gjyqësor i Kosovës. *Shih* MARRËVESHJEN TEKNIKE MIDIS FORCËS NDËRKOMBËTARE TË SIGURISË (KFOR) DHE QEVERIVE TË REPUBLIKËS FEDERALE TË JUGOSLLAVISË DHE REPUBLIKËS SË SERBISË (9 qershor 1999); dhe RREGULLOREN E UNMIK-UT NR. 2000/47 MBI STATUSIN, PRIVILEGJET DHE IMUNITETIN E KFOR-IT DHE UNMIK-UT DHE PERSONELIT TË TYRE NË KOSOVË neni 2.

Si një hap tjetër drejt zgjidhjes së statusit të Kosovës është ndërmarr më 26 mars 2007, me publikimin e Raportit të dërguarit special Martti Ahtisaari dhe aneksin mbi statusin e Kosovës.¹

¹ Propozimi i Ahtisaarit i është dorëzuar Këshillit të Sigurimit të KB-ve, por deri në përpilimin e këtij vlerësimi nuk është ndërmarrë asnjë veprim nga ky organ dhe asnjë datë nuk është caktuar për t’u shqyrtuar propozimi. Në vend të kësaj, në fund të shtatorit 2007, një grup prej 6 shteteve (Franca, Gjermania, Italia, Rusia, Mbretëria e Bashkuar dhe SHBA-të) e ka filluar një raund të ri të bisedimeve lidhur me statusin e Kosovës. Prandaj, ky

Shih në përgjithësi RAPORTIN E TË DËRGUARIT SPECIAL TË SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM PËR STATUSIN E KOSOVËS (26 mars 2007), në aneksin e tij, PROPOZIMI GJITHËPËRFSHIRËS PËR ZGJIDHJEN E STATUSIT TË KOSOVËS (2 shkurt 2007) [më tutje të dyja dokumenteve bashkërisht i referohemi si PROPOZIMI I AHTISAARIT]. Në Propozimin e Ahtisaarit fjala "*pavarësi*" nuk përmendet në mënyrë specifike, por në vend të kësaj parashikon se "Kosova do të jetë shoqëri shumëtnike me respektim të plotë të sundimit të ligjit përmes institucioneve të veta të pushtetit ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor," dhe parashikon autorizimet e Kosovës për nxjerrjen e kushtetutës së vet. Nëse Propozimi i Ahtisaarit eventualisht hyn në fuqi, atëherë do të ketë një periudhë tranzitore prej 120 ditësh gjatë së cilës duhet të miratohet kushtetuta e re. Pastaj, UNMIK-u do të largohet dhe zgjedhjet e reja do të mbaheshin brenda 9 muajsh pas ditës kur marrëveshja përfundimtare hyn në fuqi. Sipas Propozimit të Ahtisaarit, Kosova do të drejtohet nga qeveria e vet por e mbikëqyruar dhe përkrahur për një periudhë të përkohshme dhe të caktuar kohore nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar [më tutje në tekst PCN] i cili do të veprojë në emër të BE-së, dhe të Grupit Drejtues Ndërkombëtar [më tutje GDN], i cili do të ketë pushtet të sigurimit të zbatimit të suksesshëm të zgjidhjes përfundimtare. Këto autorizime do të përfshinin mundësinë e anulimit të ligjeve dhe vendimeve të organeve të Kosovës, dhe autorizime për të ndëshkuar ose shkarkuar zyrtarët publik. Siguria do të ofrohet nga prania ushtarake e udhëhequr nga NATO, duke mbështetur forcën e re shumëtnike të Kosovës, deri në atë kohë kur vlerësohet se institucionet e Kosovës konsiderohen të afta për marrjen e përgjegjësisë mbi të gjithë spektrin e sigurisë.

Ligji në fuqi i Kosovës, për momentin përbëhet nga rregulloret e UNMIK-ut (përfshirë këtu edhe Kornizën Kushtetuese) dhe aktet nënligjore; ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës; dhe ligjit në fuqi në Kosovë deri me 22 mars 1989 – deri në ditën e fundit kur Kosova e kishte statusin e autonomisë në kuadër të ish RSFJ-së. Grupi i fundit i ligjeve përfshinë dispozitat e ligjeve federative të ish SFRJ-së, ish ligjet krahinore të Kosovës; sikurse edhe disa ligje të ish Republikës Socialiste të Serbisë. Rregulloret dhe aktet nënligjore të UNMIK-ut kanë përparësi zbatimi karshi ligjeve të mëparshme dhe të cilat janë në kundërshtim me to. *Shih* RREGULLOREN E UNMIK-UT NR. 1999/24 MBI LIGJIN NË FUQI NË KOSOVË, neni 1, e ndryshuar me RREGULLOREN E UNMIK-UT NR. 2000/59. Përveç kësaj, Korniza Kushtetuese i ka inkorporuar duke i bërë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë edhe disa instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përfshirë këtu Deklaratën universale për të drejtat e njeriut; Konventën evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (së bashku me protokollet e saj); Paktin ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike (së bashku me protokollet) (më tutje në tekst PNDKP); Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor; Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas (më tutje në tekst KEDG), Konventën mbi të drejtat e fëmijës; Kartën evropiane për gjuhët regjionale ose të pakicave, dhe Konventën kuadër të Këshillit të Evropës për mbrojtjen e pakicave kombëtare. Korniza Kushtetuese, nenet 3.1, 3.2. Shumë prej të anketuarve të intervistuar për këtë vlerësim, kanë raportuar se ky bollëk i ligjeve krijon huti, dhe gjyqtarët nganjëherë zbatojnë dispozita të ndryshme ligjore për gjendjet e njëjta ose të ngjashme faktike.

Historiku i gjyqësisë

Si pjesë e ish RSFJ-së, Kosova kishte të njëjtën traditë juridike, duke përfshirë këtu ndikimin që e kishte lënë prapa Perandoria e Austro-Hungarisë. Që nga viti 1974, Kosova si "Krahinë Autonome" ka pasur kushtetutën e vet, kuvendin, gjykatën supreme dhe gjykatën kushtetuese. Kosova i kishte të përbashkëta ligjet federative të procedurës penale dhe kontestimore sikurse edhe pjesët tjera të RSFJ-së, por e kishte ligjin e vet penal, të plotësuar me disa dispozita penale nga ligji federativ dhe Serbisë. Sikurse edhe në sistemet tjera socialiste, ndikimi i pushtetit ekzekutiv dhe strukturave partiake ka qenë mjaft i shprehur në gjyqësi.

Pas luftës së viteve 1997-98 dhe marrjes së pushtetit nga Millosheviqi, thuhet se të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët shqiptar ishin shkarkuar nga pozita. Në vitin 1992, pushteti serb e kishte ndërprerë

raport nuk do ta shtjellojë thellësisht propozimin e Ahtisaarit ngase rëndësia e tij për gjyqësinë e Kosovës ende është a pasigurt.

organizimin e provimit të jurisprudencës, duke kufizuar kështu dhe më shumë qasjen e shqiptarëve etnikë në profesionin ligjor. Gjatë asaj dekade shumë prej profesionistëve të cilët kishin shërbyer në gjyqësi, ishin larguar nga krahina. Atyre profesionistëve të gjyqësisë që kishin mbetur në Kosovë, ju mungonte përvoja më e re gjyqësore dhe shumë prej tyre nuk kishin punuar në profesion më se një dekadë. Për më tepër, përvoja nga sistemi i mëparshëm socialist nuk përbente përgatitje adekuate për punën në sistemin e ri demokratik. Shumë pak prej tyre kishin njohuri të drejtpërdrejta mbi standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të inkuorpuara në ligjin vendor përmes Kornizës Kushtetuese.

Prandaj, pas ndërprerjes së armiqësive në vitin 1999 dhe fillimit të administrimit nga UNMIK-u ka pasur mungesë të madhe të gjyqtarëve kompetent dhe profesionistëve tjerë ligjor. Gjithashtu, shumë objekte të gjykatave ishin gjysmë të rrënuara dhe në gjendje të pariparueshme. Si rezultat i angazhimeve të UNMIK-ut, OSBE-së dhe disa OJQ-ve ndërkombëtare, ka rifilluar organizimi i provimit të jurisprudencës në Kosovë në dhjetor të v. 2001 dhe që nga atëherë organizohet çdo 3 muaj. Shoqata e Gjyqtarëve të Kosovës [më tutje SHGJK] dhe Oda e Avokatëve të Kosovës [më tutje OAK] ishin riaktivizuar dhe ndihmuar nga angazhimet e donatorëve për ndërtimin e institucioneve. Mirëpo, me gjithë këta hapa, sistemi është ende në proces të përpjekjeve për të plotësuar mangësitë e resurseve njerëzore si nga aspekti kualitativ ashtu edhe kuantitativ.

UNMIK-u gradualisht i ka bartur shumë prej kompetencave tek organet vendëse. Me Kornizë Kushtetuese dhe me aktet tjera nënligjore janë themeluar Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes [më tutje IPVQ], duke përfshirë këtu Kuvendin, Kryeministrin dhe Kryetarin e Kosovës si dhe 9 ministri qendrore dhe agjenci të ndryshme ekzekutive. RREGULLORJA E UNMIK-UT NR. 2001/19 MBI DEGËN E PUSHTETIT EKZEKUTIV TË IPVQ-VE PËR KOSOVËN, e ndryshuar me RREGULLOREN E UNMIK-UT NR. 2006/34 [më tutje RREGULLORJA MBI DEGËN EKZEKUTIVE]. Në nëntor të vitit 2001 është zgjedhur së pari Kuvendi me 120 deputetë, ndërsa Qeveria u formua në mars 2002. Që atëherë, UNMIK-u ka bartur përgjegjësitë për ministrinë e reja si dhe ka krijuar pozita dhe agjenci tjera në kuadër të degës së ekzekutivit të Kosovës. Korniza Kushtetuese në mes tjerash i ka bartur vetëm disa kompetenca të kufizuara nga fusha e drejtësisë tek IPVQ-të, konkretisht, pjesëmarrjen e tyre në emërimin dhe trajnimin, organizimin e provimeve kualifikuese për gjyqësi, sigurimin e mjeteve materiale për gjyqësorin, si dhe çështjet e punësimit, procedurës disiplinore dhe largimin nga puna të personelit mbështetës të gjykatave. Detyrat e zakonshme të ministrisë së drejtësisë janë ndarë ndërmjet Departamentit të drejtësisë (DD), i udhëhequr nga ndërkombëtarët, dhe Departamentit për administratë gjyqësore (DAGJ) të Ministrisë së Shërbimeve Publike të udhëhequr nga vendorët. Krahas kësaj, ishte edhe Këshilli gjyqësor dhe prokurorial i Kosovës (KGJPK), i emëruar nga PSSP-ja, dhe i përbërë prej anëtarëve vendës dhe ndërkombëtar. KGJPK shërbente si organ këshillues për PSSP-në lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me emërimet në gjyqësor, shkarkimet dhe çështjet disiplinore. *Shih* RREGULLOREN E UNMIK-UT NR. 2001/8 MBI THEMELIMIN E KËSHILLIT GJYQËSOR DHE PROKURORIAL TË KOSOVËS [më tutje RREGULLORJA MBI KGJPK-NË].

Në fund të vitit 2005 është themeluar Ministria e Drejtësisë e Kosovës [më tutje MD] me disa kompetenca të kufizuara. *Shih* RREGULLOREN E UNMIK-UT NR. 2005/53, për ndryshimin e RREGULLORES PËR DEGËN E EKZEKUTIVIT. Krahas kësaj, dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës [më tutje KGJK] ishte themeluar si zëvendësim i KGJPK-së si një organ i pavarur dhe nën autoritetin e PSSP-së; *shih* RREGULLOREN E UNMIK-UT NR. 2005/52 MBI THEMELIMIN E KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS (RREGULLOREN MBI KGJK-NË)². Këshilli përbëhet prej 11 anëtarëve, 7 prej të cilëve janë gjyqtarë. Kryetari i Gjykatës Supreme shërben edhe si kryetar i KGJK-së. Katër anëtarët jo-gjyqtarë janë: ministri i Drejtësisë; kryesuesi i Komisionit Parlamentar për çështje legjislativë, gjyqësore dhe Kornizë Kushtetuese; kryetari i OAK-së dhe një profesor i drejtësisë. KGJK-ja përcakton politikat administrative për gjyqësinë, përgatitë dhe menaxhon buxhetin për gjyqësinë, dhe mbikëqyrë

² Deri në themelimin e këshillit të veçantë prokurorial, rregullorja e KGJK-së do të zbatohet edhe ndaj prokurorëve. Kështu vazhdon të jetë rasti, përveç se tani pagat e prokurorëve dhe stafit të tyre paguhen nga buxheti i Ministrisë së Drejtësisë.

gjyqtarët dhe gjykatat. Është përgjegjës për trajnimin, rekrutimin, emërimin, vlerësimin, avancimin në punë dhe disiplinimin e gjyqtarëve dhe personelit gjyqësor, si dhe funksionon si zyrë administrative për gjykatat. Gjithashtu është i ngarkuar me detyrën e mbajtjes e të dhënave statistikore lidhur me gjyqtarët dhe administratën gjyqësore.

Në kohën e fundit, rritja e shkallës së bartjes së përgjegjësive në organet e drejtësisë të Kosovës, e manifeston dëshirën e UNMIK-ut për transferimin në etapa në mënyrë që institucionet të kenë kapacitet të funksionojnë të pavarura kur të ndryshon statusi në rrafshin ndërkombëtar. Për shembull, në kohën e përpilimit të këtij vlerësimi, është duke u shqyrtuar propozim ligji mbi gjyqësinë [më tutje "propozim ligji"], i cili ka qenë në proces të hartimit për më shumë se dy vite. *Shih* Raportin e 7-të të OMBUDSPERSONIT F. 20 (2006-2007). Në rast se miratohet, ky ligj do ta shfuqizojë ligjin ekzistues mbi gjykatat e rregullta. PROPOZIM LIGJI neni 29. Miratimi i propozim ligjit nga ana e Kuvendit dhe shpallja e tij në fuqi nga PSSP-ja pas miratimit të Planit të Ahtisaarit, do ta përfundonte tranzicionin e plotë ligjor drejt administrimit të pavarur të gjykatave nga gjyqësori dhe jo nga një ministri e pushtetit ekzekutiv.

Organizimi i gjykatave

Sistemi i gjykatave të rregullta të Kosovës, përbëhet nga 26 gjykata komunale, 5 gjykata të qarkut, Gjykata Ekonomike e Kosovës dhe nga Gjykata Supreme. Sistemi i gjykatave për kundërvajtje përfshinë 26 gjykata komunale për kundërvajtje dhe Gjykatën e lartë për kundërvajtje. Sipas të dhënave statistikore të KGJK-së për muajin korrik 2007, në gjyqësi ishin 322 pozita gjyqësore me 301 gjyqtarë në detyrë, duke përfshirë 13 gjyqtarë që shërbejnë në Gjykatën Supreme, 4 gjyqtarë në Gjykatën Ekonomike, 5 gjyqtarë në Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje, 49 gjyqtarë në gjykatat e qarkut, 141 gjyqtarë në gjykatat komunale dhe 89 gjyqtarë në gjykatat për kundërvajtje.

Gjykatat komunale veprojnë në secilën prej komunave të Kosovës dhe shërbejnë si gjykata të shkallës së parë për veprat penale për të cilat parashikohet dënim me burgim deri në 5 vjet; për kontestet pasurore juridike dhe të punës; çështjet e trashëgimisë dhe çështjet tjera civile juridike. Gjykatat komunale zakonisht gjykojnë në trupe gjyqësore të përbëra prej një gjyqtari profesionist dhe 2 gjyqtarë porotë. Veprat penale për të cilat parashikohet dënim me gjobë ose me burgim për më pak se 3 vite gjykohen nga gjyqtari i vetëm.

Gjykatat e qarkut, janë të vendosura nëpër secilën nga 5 qytetet më të mëdha regjionale të Kosovës (Prishtinë, Gjiilan, Pejë, Prizren dhe Mitrovicë). Ato i shqyrtojnë ankesat kundër vendimeve të gjykatave komunale. Gjithashtu ato shërbejnë si gjykata të shkallës së parë për veprat penale për të cilat parashikohet dënim me burg për më gjatë se 5 vjet, kontestet e mëdha pasurore juridike, kontestet nga të drejtat e pronës intelektuale dhe çështjet tjera. Trupat gjyqësore në shkallë të parë zakonisht përbëhen nga një profesionist dhe 2 gjyqtarë porotë. Kolegjet gjyqësore prej 2 gjyqtarëve profesionistë dhe 3 gjyqtarëve porotë shqyrtojnë lëndët të cilat bartin dënimin prej më shumë se 15 vjet si dhe ankesat që vijnë nga gjykatat komunale.

Gjykata Ekonomike është e vendosur në Prishtinë, dhe ka juridiksion të plotë për territorin e Kosovës për shqyrtimin e kontesteve midis bizneseve private; procedurës së falimentimit dhe delikte të caktuara ekonomike.

Gjykata Supreme e Kosovës është gjykata e shkallës më të lartë në kuadër të sistemit të gjykatave të rregullta në Kosovë. Ajo vepron si gjykatë e shkallës së tretë për një numër të kufizuar të veprave penale, p.sh., ajo dëgjon ankesat nga vendimet e gjykatave të qarkut mbi ankesat nga gjykatat komunale; dëgjon drejtpërdrejt ankesat kundër vendimeve të gjykatave të qarkut, dhe shërben si gjykatë e shkallës së parë për disa çështje të konfliktit administrativ. Në kuadër të Gjykatës Supreme është themeluar Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme e përbërë nga 2 gjyqtarë të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe 3 gjyqtarë ndërkombëtarë, për shqyrtimin e ankesave ndaj vendimeve për privatizim të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM). *Shih*

RREGULLOREN E UNMIK-UT 2002/13 PËR THEMELIMIN E DHOMËS SË VEÇANTË TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJET E AKM-SË (RREGULLORJA E DHOMËS SË VEÇANTË PËR AKM-NË). Parashikohet edhe themelimi i një dhome të veçantë të Gjykatës Supreme për shqyrtimin e konfliktit ndërmjet ligjeve të miratuara nga Kuvendi dhe Kornizës Kushtetuese, por ende nuk është themeluar. *Shih* KORNIZA KUSHTETUESE § 9.4.11. Gjithashtu Gjykata Supreme është përgjegjëse për sigurim e zbatimit të njëjtë të ligjit nga të gjitha gjykatat dhe gjykatave më të ulëta mund t'ju jep udhëzime

Gjykata Supreme zakonisht gjykon në kolegje të përbërë prej 3 gjyqtarëve profesionistë; mirëpo kolegjet prej 5 gjyqtarëve shqyrtojnë rastet në të cilat dënimi me burg mund të tejkalojë 15 vjet dhe kur gjykata gjykon si shkallë e tretë.

Gjykatat për kundërvajtje janë të vendosura nëpër çdo komunë dhe janë kompetente për kundërvajtjet në trafik të dënueshme me gjobë ose me më së shumti 60 ditë burgim. Ankesa kundër vendimeve të gjykatave për kundërvajtje i paraqitet **Gjykatës së lartë për kundërvajtje**, kompetenca e së cilës shtrihet në tërë territorin e Kosovës.

Gjyqtarët porotë, shërbejnë bashkë me gjyqtarët profesionistë nëpër trupat gjyquese të gjykatave komunale dhe të qarkut. Gjyqtarët porotë nuk kanë përgatitje juridike të veçantë dhe kanë të drejtë të barabartë të votës me gjyqtarët profesionistë. Momentalisht janë 610 gjyqtarë porotë. Gjyqtarët porotë do të shërbejnë gjithashtu edhe në trupat gjyqesues 3 anëtarësh të Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme për çështjet e AKM-së, edhe pse këta gjyqtarë ende nuk janë emëruar.

Gjyqtarët ndërkombëtarë, emërohen dhe caktohen për shërbim në përputhje me rregulloret e UNMIK-ut. *Shih* RREGULLOREN E UNMIK-UT 2000/6 MBI EMËRIMIN E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NDËRKOMBËTARË DHE NDËRRIMIN E VENDIT TË GJYKIMIT [më tutje RREGULLORJA PËR GJYQTARËT NDËRKOMBËTARË]; *shih gjithashtu* RREGULLOREN E UNMIK-UT NR. 2000/64 MBI CAKTIMIN E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NDËRKOMBËTAR [më tutje RREGULLORJA MBI CAKTIMIN E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NDËRKOMBËTARË]. Që nga 30 qershori 2006 ishin 11 gjyqtarë ndërkombëtarë që u ishujn caktuar gjykatave të Kosovës. Gjyqtarët ndërkombëtarë mund të gjykojnë në trupat gjyquese së bashku me gjyqtarët vendor në secilën gjykatë, dhe shqyrtojnë rastet e krimeve të luftës, krimeve ndëretnike, korrupsionin, trafikimin me qenie njerëzore dhe praktikatat tjera të cilat kërcënojnë krijimin e sundimit të ligjit.

Gjykatat paralele, të drejtuara nga serbët etnikë dhe të përkrahur nga qeveria e Serbisë, vazhdojnë të funksionojnë nëpër enklavat serbe pa autorizimin e UNMIK-ut. Gjykatat e UNMIK-ut në Kosovë nuk i njohin ose ekzekutojnë vendimet e këtyre gjykatave. Vendimet e gjykatave paralele mund të kundërshtohen me ankesë vetëm në gjykatat e larta të Serbisë. Në mënyrë të ngjashme, dihet se gjykatat e Serbisë kanë shqyrtuar rastet të cilat janë kompetencë territoriale e Kosovës dhe përfshijnë serbët e Kosovës.

Kushtet e shërbimit

Kualifikimet

Së fundi kanë ndryshuar kualifikimet për emërim në gjyqësi. *Shih* RREGULLOREN E KGJK-SË § 6.1. Për t'u emëruar si gjyqtar profesionist në Kosovë, tani kandidatët duhet: (1) të jenë banorë të përhershëm të Kosovës; (2) të kenë integritet të lartë moral; (3) të jenë të aftë për kryerjen e detyrave dhe punës me orar të plotë; (4) të kenë diplomën e fakultetit juridik në përputhje me ligjet e Kosovës; (5) ta kenë të dhënë provimin e jurisprudencës ose të jenë anëtar i odës së avokatëve; (6) ta kenë të dhënë provimin e ri pranues për gjyqtarë; (7) të kenë të përfunduar programin e trajnimit gjyqësor të ofruar nga Instituti Gjyqësor i Kosovës dhe (8) të kenë së paku 3 vite përvojë ligjore. Rregullorja mbi KGJK-në § 6.1.

Për të shërbyer si gjyqtarë porotë, personi duhet: (1) të jetë banorë i përhershëm i Kosovës për së paku 5 vjet; (2) të jetë së paku 25 vjeçar; (3) të integritetit të lartë moral dhe (4) "mos të kenë qenë

të angazhuar në praktika diskriminuose ashtu siç përcaktohet me rregullat ligjor dhe procedurë gjyqësore.” Rregullorja mbi KGJK-në § 6.2.

Gjyqtarët ndërkombëtarë duhet të kenë: (1) diplomën e fakultetit juridik, (2) 5 vite shërbim si gjyqtarë ose prokurorë në vendin e tyre (3) integritet të lartë moral dhe (4) pa dosje penale. *Shih* RREGULLOREN PËR GJYQTARËT NDËRKOMBËTAR § 2.

Emërimi dhe mandati

PSSP e bën emërimin e gjyqtarëve nga lista e kandidatëve të propozuar nga KGJK-ja dhe e miratuar nga Kuvendi. Mandati i gjyqtarëve të tanishëm lidhet ngushtë me kohëzgjatjen e mandatit të UNMIK-ut, që varet nga sjellja e mirë dhe pensionimi i obliguar në moshën 65 vjeçare. Gjendja e tanishme lidhur me mandatin e gjyqtarëve është veçanërisht e paqartë. Janë dy dokumente të UNMIK-ut të cilat parashikojnë krijimin e Komisionit të pavarur gjyqësor dhe të prokurorisë [më tutje KPGJP], si një organ autonom i KGJK-së. *Shih* RREGULLOREN E UNMIK-UT NR. 2006/25 MBI KORNIZËN RREGULLATIVE PËR SISTEMIN E DREJTËSISË NË KOSOVË [më tutje RREGULLORJA MBI KORNIZËN E SISTEMIT TË DREJTËSISË]; *shih po ashtu* URDHËRESËN ADMINISTRATIVE NR. 2006/18, për zbatimin e RREGULLORES SË UNMIK-UT NR. 2006/25. KPGJP parashikohet të përbëhet nga 5 anëtarë ndërkombëtarë dhe do të ketë për detyrë vlerësimin e gjyqtarëve për riemërim kur t’ju përfundon mandati me përfundimin e mandatit të UNMIK. KPGJP parashikohet gjithashtu të mbikëqyrë emërimet e gjyqtarëve të ri gjatë asaj kohe. KPGJP ka qenë e parashikuar të krijohet në maj të vitit 2007, me nënshkrimin e memorandumit nga UNMIK-u për krijimin e KPGJP-së, por ky nënshkrim nuk ka ndodhur deri në përpilimin e këtij raporti.

Trajnimi

Rregullorja mbi KGJK-në parashikon për të gjithë kandidatët potencialë për gjyqtarë “të përcjellin dhe përfundojnë programin trajnues të organizuar nga IGJK-ja,” në mënyrë që të konsiderohen për pozitën e gjyqtarit. Ky rregull i nxjerrë në fuqi së fundi paraqet përmirësim duke e krahasuar me rrethanat në të kaluarën për shkak se pas heqjes së autonomisë së Kosovës në vitin 1989 dhe vitet më pas trajnimi ligjor dhe gjyqësor ka qenë jashtëzakonisht i cunguar. Deri më sot IGJK-ja e ka organizuar vetëm një program fillestar për arsimim ligjor (PFAL) për gjyqtarët e ardhshëm në vitin 2005; mirëpo, propozimi për një PFAL më gjithëpërfshirës ishte në pritje të miratimit gjatë kohës kur është përgatitur ky vlerësim.

Për gjyqtarët në shërbim, nuk kërkohet me ligj në mënyrë të shprehur që ata të ndjekin kurset e arsimit të vazhdueshëm ligjor (AVL), edhe pse një dispozitë e tillë mund të gjendet në kodin e ri për gjyqtarë. Sido që të jetë, IGJK ka organizuar programe trajnuese të shumta për gjyqtarë që nga themelimi i institutit më 2005. IGJK-ja fillimisht ishte një subjekt i cili administrohej nga OSBE-ja por, që nga muaji prill i vitit 2006 është shndërruar në një institucion të pavarur, dhe të financuar nga buxheti i konsoliduar i Kosovës. Trajnimet e IGJK-së tani mbulojnë një spektër temash, duke përfshirë këtu të drejtën penale dhe procedurale, ekzekutimin e aktgjykimeve, etikën gjyqësore, dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Analiza e IRGJ-së 2007 për Kosovë

Gjersa korrelacionet e përdorura në këtë ushtrim mund të shërbejnë për t’i dhënë kuptim gjendjes relative të çështjeve të caktuara, Iniciativa e sundimit të ligjit do të nënvizojë se korrelacionet midis faktorëve dhe konkluzionet nga IRGJ e vitit 2007 për Kosovë, dobinë më të madhe e fitojnë kur ato analizohen të ndërlidhura me analizat themelore dhe të krahasuara me IRGJ-në e vitit 2004 për Kosovën. Iniciativa për sundimin e ligjit e ka parasysh rëndësinë relative të korrelacioneve të veçanta të cilat mund të shërbejnë si

temë për studime të mëtutjeshme. Në këtë drejtim, Iniciativa e sundimit të ligjit bën thirrje për komentet dhe informatat të cilat do ta mundësonin zhvillimi më të mirë dhe më të hollësishëm të përgjigjes në vlerësimet e ardhshme të llojit të IRGJ-së. Iniciativa për sundimin e ligjit e shikon procesin e vlerësimit të IRGJ-së si pjesë të angazhimeve të vazhdueshme për monitorim dh vlerësim të angazhimeve reformuese.

Tabela e Korrelacioneve të Faktorëve

Faktori i Indeksit të Reformës Gjyqësore		Korrelacioni 2004	Korrelacioni 2007	Trendi
I. Cilësia, Arsimit dhe Diversiteti				
Faktori 1	Përgatitja dhe Kualifikimet për Gjyqësor	Neutral	Pozitiv	↑
Faktori 2	Përzgjedhja/Procesi i Emërimit	Neutral	Pozitiv	↑
Faktori 3	Arsimimi i Vazhdueshëm Ligjor	Neutral	Pozitiv	↑
Faktori 4	Përfaqësimi Gjinor dhe i Pakicave	Neutral	Neutral	↔
II. Pushteti gjyqësor				
Faktori 5	Rishqyrtimi Gjyqësor i Legjislacionit	Negativ	Negativ	↔
Faktori 6	Mbikëqyrja Gjyqësore e Veprimtarisë Administrative	Negativ	Negativ	↔
Faktori 7	Juridiksioni Gjyqësor ndaj Lirive Qytetare	Negativ	Neutral	↑
Faktori 8	Sistemi i Vendosjes Sipas Ankesës	Neutral	Pozitiv	↑
Faktori 9	Mospërfillja/Thirrja/Ekzekutimi	Negativ	Negativ	↔
III. Resurset financiare				
Faktori 10	Të Hyrat Buxhetore	Negativ	Neutral	↑
Faktori 11	Mjaftueshmëria e Rrogave të Gjyqësorit	Negativ	Negativ	↔
Faktori 12	Ndërtesat (objektet) e Gjykatave	Neutral	Negativ	↓
Faktori 13	Siguria e Gjyqësorit	Neutral	Neutral	↔
IV. Masat mbrojtëse strukturore				
Faktori 14	Mandati i Garantuar	Neutral	Neutral	↔
Faktori 15	Kriteret Objektive për Avancim në Gjyqësi	Neutral	Negativ	↓
Faktori 16	Imuniteti i Gjyqtarëve për Veprimet Zyrtare	Neutral	Neutral	↔
Faktori 17	Shkarkimi dhe Disiplina për Gjyqtarë	Neutral	Neutral	↔
Faktori 18	Caktimi i Lëndëve	Negativ	Negativ	↔
Faktori 19	Shoqatat e Gjyqtarëve	Neutral	Neutral	↔
V. Llogaridhënia dhe transparenca				
Faktori 20	Vendimet Gjyqësore dhe Ndikimi i Pavend	Negativ	Negativ	↔
Faktori 21	Kodi i Etikës	Neutral	Pozitiv	↑
Faktori 22	Procesi Ankimor për Sjellje Gjyqësore	Neutral	Neutral	↔
Faktori 23	Qasja e Publikut dhe Mediave në Procedurë	Pozitiv	Pozitiv	↔
Faktori 24	Publikimi i Vendimeve Gjyqësore	Negativ	Negativ	↔
Faktori 25	Mirëmbajtja e Procesverbalit Gjyqësor	Negativ	Negativ	↔
VI. Efikasiteti				
Faktori 26	Stafi përkrahës i Gjykatave	Negativ	Negativ	↔
Faktori 27	Pozitat Gjyqësore	Neutral	Negativ	↓
Faktori 28	Depozitimi i Lëndëve dhe Sistemi i Përcjelljes	Neutral	Neutral	↔
Faktori 29	Kompjuterët dhe Pajisjet për Zyra	Neutral	Neutral	↔
Faktori 30	Shpërndarja dhe Renditja e Ligjit të Tanishëm	Neutral	Neutral	↔

I. Cilësia, Arsimimi dhe Diversiteti

Faktori 1: Kualifikimi dhe përgatitja e gjyqtarëve

Gjyqtarët e kanë të kryer fakultetin juridik dhe e ushtrojnë detyrën pranë tribunaleve (gjykatave) ose, para se ta marrin detyrën, nga ta kërkohet (pa shpenzime për gjyqtarët) që t'i përcjellin kurset relevante që kanë të bëjnë me të drejtën materiale dhe procedurale të fushave të drejtësisë, pastaj, për rolin e gjyqtarit në shoqëri dhe ndjeshmërinë kulturore.

Konkluzioni	Korrelacioni: Pozitiv	Trendi: ↑
<p>Kandidatët për gjyqësor kërkohet të plotësojnë një numër kualifikimesh, duke përfshirë arsimimin e lartë universitar në drejtësi, dhënien e provimit të jurisprudencës dhe provimin pranues për gjyqtar si dhe të demonstrojnë përshtatshmëri morale. Të gjithë kandidatët për gjyqësi tani kërkohet ta përfundojnë programin trajnues fillestar në IGJK, edhe pse ky program ende nuk është bërë tërësisht funksional. Përmirësimet plotësuese të fundit në fushën e përgatitjes për gjyqësor, përfshijnë krijimin e institucioneve për mbikëqyrjen e trajnimit për gjyqtarë dhe licencimin e fakulteteve juridike.</p>		

Analiza/Sfondi:

Rregullorja mbi KGJK-në e vitit 2005 parashikon kualifikime të reja për shërbim në gjyqësor. Ndryshimi më i dallueshëm i cili rezulton në ligjin e ri është se, tani kandidatët për gjyqtarë kërkohet të marrin pjesë në trajnimet e IGJK-së para se të emërohen si gjyqtarë. RREGULLORJA E KGJK-SË § 6.1. Kandidatët për gjyqtarë gjithashtu duhet: (1) të jenë banorë të përhershëm të Kosovës; (2) të kenë integritet të lartë moral; (3) të jenë të aftë për kryerjen e detyrave dhe punës me orar të plotë; (4) të kenë diplomën e fakultetit juridik në përputhje me ligjet e Kosovës; (5) ta kenë të dhënë provimin e jurisprudencës ose të jenë anëtar i odës së avokatëve; (6) ta kenë të dhënë provimin e ri pranues për gjyqtarë; dhe (7) të kenë së paku 3 vite përvojë ligjore. *Id* § 6.1. Për të shërbyer si gjyqtar porotë personi duhet (1) të jetë banor i përhershëm i Kosovës, për së paku 5 vjet; (2) të jetë së paku 25 vjeçar, (3) të integritetit të lartë moral, dhe (4) "mos të ketë qenë i përfshirë në praktikë diskriminuese të përcaktuara me ligj dhe me rregullat dhe procedurat gjyqësore." *Id* § 6.2. Për të gëzuar të drejtën e emërimit për gjyqtar ndërkombëtar personi duhet ta ketë: (1) diplomën e fakultetit juridik, (2) 5 vite shërbim si gjyqtarë ose prokurorë në vendin e tij/saj (3) integritet të lartë moral dhe (4) pa dosje penale. *Shih* RREGULLOREN PËR GJYQTARËT NDËRKOMBËTAR *Id* 2.

Cilësia e arsimimit të gjyqtarëve të Kosovës ka pësuar për shkak të tensioneve etnike dhe për shkak të mungesës së mbikëqyrjes së sistemit arsimor. Krijimi i Agjencisë së Kosovës për akreditim (AKA) do të mund të ndihmojë standardizimin dhe përmirësimin e cilësisë së arsimimit ligjor. AKA e ka për detyrë monitorimin e fakulteteve juridike dhe këshillimin e qeverisë përkitazi me licencimin e atyre institucioneve. *Shih* LIGJIN MBI ARSIMIN E LARTË NË KOSOVË nenet 4.3, 4.4 (*shpallur në fuqi me* RREGULLOREN E UNMIK-UT NR. 2003/14) [më tutje në tekst LIGJI MBI ARSIMIN E LARTË]. Parashihet që AKA të mbikëqyrret nga një këshill drejtues prej 9 anëtarëve, 3 prej të cilëve janë përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare. *Id* 4.6.

Përkundër përparimeve më të fundit, cilësia e arsimit ligjor në Kosovë vazhdon të ketë cilësi të dobët dhe t'i mungojë trajnimi praktik, dhe i aty-për-atyshëm për gjyqtarët e ardhshëm. Për momentin, kampusi i Universitetit të Prishtinës në qytetin e Prishtinës, kryesisht u shërben studentëve të drejtësisë të përkatësisë etnike shqiptare, ndërsa ai tjetri në Mitrovicë, strehon kryesisht serbët etnikë. Të dyja këto janë subjekte publike dhe financohen nga fondet qeveritare dhe teknikisht janë pjesë e të njëjtit universitet, por në realitet ato punojnë të pavarura nga njëra tjetra. Gjatë viteve të 90-ta, shqiptarët etnikë nuk ishin lejuar të mësonin drejtësinë në fakultetin e

Prishtinë, kështu që fakultetit juridik në Prishtinë përbëhej gati ekskluzivisht nga profesorët dhe studentët të përkatësisë etnike serbe. Gjatë asaj periudhë, profesorët shqiptarë të Kosovës e kanë drejtuar një fakultet ilegal dhe paralel të drejtësisë dhe atë nëpër shtëpitë private në Prishtinë. Pas luftës 1998 – 1999, shqiptarët etnikë u kthyen në Fakultetin Juridik të Prishtinës; mirëpo, serbët etnikë nuk kanë mundur ta ndjekin fakultetin që nga ajo kohë, për shkak të barrierave gjuhësore dhe mungesës së sigurisë. Në vend të kësaj, studentët serbë e kanë ndjekur fakultetin e Universitetit të Prishtinës të zhvendosur në pjesën veriore të Mitrovicës, ku mësohet plan-programi mësimor i miratuar nga Universiteti i Beogradit duke rezultuar në gjendjen e tanishme të *de facto* segregacionit. Krahas kësaj, ekzistojnë edhe 5 fakultete juridike private të njohura nga Ministria e Arsimit. Për shkak se AKA ende nuk ka filluar të funksionojë për momentin ekziston një kontroll i kualitetit të dobët mbi këto fakultete.

Si rezultat i gjendjes së paqëndrueshme në vitet e 90-ta, shumica e përgatitjes të cilën e kanë fituar gjyqtarët e sotshëm ka qenë e rëndomtë. Është e njohur se arsimimi i ofruar nga shtëpitë gjatë viteve 90-ta për studentët shqiptarë ka qenë inferior. Gjersa në Fakultetin Juridik të Prishtinës kanë filluar reformat pas luftës së vitit 1999, është arritur pak përparim në përgatitjen e studentëve për të hyrë në profesionin ligjor ose për përgatitjen e tyre për karrierën e gjyqtarit. Fakulteti Juridik i Prishtinës kërkon nga studentët e rinj t'i dorëzojnë dëftesat e shkollës së mesme dhe ta kalojnë provimin pranues; mirëpo, edhe më tej pranohen çdo vit nga 1,000 studentë ku 500 prej tyre janë studentë "të rregullt", ndërsa të tjerët janë "me korrespondencë" (të cilët paguajnë tarifa më të larta por që nuk kërkohet nga ta t'i ndjekin mësimet). Janë gjithsejtë 42 anëtarë të fakultetit (profesorë). Numri i madh i studentëve e bën të pamundur mësimin e shumicës prej lëndëve në ndonjë mënyrë tjetër përveç asaj të ligjërimit dhe për pjesën më të madhe lënda që mësohet është e kufizuar në aspektin "tradicional" teorik. Një i porsa-diplomuar në drejtësi, ka theksuar se ai asnjëherë nuk e ka lexuar asnjë ligj ose lëndë gjatë gjithë shkollimit të tij. Mungesa e përgatitjes relevante në fakultetin juridik pasqyrohet edhe në faktin se shumicës së gjyqtarëve në detyrë ju mungon analiza, arsyetimi ligjor si dhe aftësitë e të shkruarit. Pak studentë kanë mundësi ta shfrytëzojnë rastin dhe të përfitojnë nga mundësitë e fundit të arsimit praktik rishtazi të inkorporuara, e që ofrohen përmes klinikave ligjore civile dhe penale, kursit të metodologjisë juridike, gjykimeve të simuluar të organizuara nga donatorët sikur që është Iniciativa për sundimin e ligjit. Mirëpo, studentët që i përcjellin klinikat janë të ngazëllyer lidhur me këto kurse; disa prej tyre kanë thënë se asnjëherë më parë nuk janë takuar me një avokat apo gjyqtarë para se të kenë marrë pjesë në këto klinika.

Me qëllim të adresimit të këtyre mangësive, IGJK-ja në bashkëpunim me KGJK-në kanë për detyrë të ofrojnë trajnimin përgatitor para emërimit për gjyqtarë dhe përshtatshmërisht pafilluar t'i zhvillojë trajnimet e kësaj natyre. Mirëpo, sasia dhe natyra e trajnimit që kërkohet t'i ndjekin gjyqtarët e ardhshëm nuk është e përcaktuar me Ligjin mbi IGJK-në. *Shih në përgjithësi LIGJIN MBI THEMELIMIN E INSTITUTIT GJYQËSOR TË KOSOVËS, (shpallur në fuqi përmes RREGULLORES SË UNMIK-UT NR. 2006/23 (më tutje Ligji mbi IGJK-në). Krahas kësaj, Rregullorja mbi KGJK-në nuk parashikon në veçanti kushtet ekzakte për trajnimin para emërimit. Ajo kërkon nga kandidatët për gjyqtarë të "kenë ndjekur dhe përfunduar trajnimin e paraparë me ligj dhe me rregullat tjera ligjore."* RREGULLORJA MBI KGJK-NË § 6.1(g)³.

Në vitin 2005, IGJK ka organizuar pilot trajnimin para emërimit tremujor, Programin fillestar të edukimit ligjor [më tutje PFEL]. Programi ishte financuar nga Agjencia Evropiane për Rindërtim (AER-i) dhe bashkë-organizuar me organizata tjera. Për pilot programin PFEL, KGJK-ja kishte zgjedhur 60 kandidatë nga 200 sa kishin paraqitur kërkesë. Kandidatët kanë pranuar 15 module të trajnimit të nivelit të lartë lidhur me profesionin gjyqësor nga profesionistë të shquar ndërkombëtarë dhe vendorë. Trajnimi ishte inter-aktiv dhe përfshinte analizën e rasteve, hulumtimin ligjor, dhe mundësitë për të mësuar dhe zbatuar materialin e ri përmes aplikimit praktik. Pas provimit

³ Nëse miratohet, propozim ligji pritet të kërkojë për të gjithë kandidatët për gjyqtarë kryerjen e trajnimit para emërimit në IGJK. Të interesuarit për gjyqtarë ende duhet ta kenë të dhënë provimin e jurisprudencës dhe t'i plotësojnë kushtet preliminare. Më pas, kandidatët duhet të aplikojnë për programin trajnues të IGJK-së duke iu nënshtruar provimit pranues me shkrim. Të pranuarit e ndjekin trajnimin njëvjeçar dhe më pas KGJK i rekomandon ata për emërim.

përfundimtar me shkrim, 57 kandidatë e kishin dhënë provimin dhe ishin rekomanduar nga ana e KGJPK; 20 nga këta 57 ishin emëruar për pozita në gjyqësor. Ky pilot trajnim para emërimit është i vetmi PFEL i mbajtur deri më tani⁴. Mirëpo, zgjerimi i PFEL është planifikuar për vitin 2008. Ky program pritet të financohet nga buxheti i Kosovës, si dhe nga kontributet e Programit të USAID-së për Mbështetjen e Drejtësisë në Kosovë, dhe UNDP-së.

Faktori 2: Procesi i Përzgjedhjes/Emërimit

Gjyqtarët emërohen bazuar në kriteret objektive, siç janë, provimi i dhënë, sukcesi në fakultet, trajnimet tjera, përvoja, profesionalizmi dhe reputacioni i fituar në komunitetin e juristëve. Gjersa mund të përfshihen elementet politike, sistemi i përgjithshëm duhet të përqafojë sistemin e përzgjedhjes së gjyqtarëve të pavarur dhe të paanshëm(objektiv).

Konkluzioni	Korrelacioni: Pozitiv	Trendi: ↑
<p>Gjyqtarët profesionistë kryesisht emërohen mbi bazën e kriterëve objektive, duke përfshirë kualifikimet e tyre profesionale dhe arsimore, përvojën e kaluar dhe qëndrimet etike. Mirëpo, një numër shqetësimesh ende kanë mbetur lidhur me mungesën e transparencës në procesin përzgjedhjes gjyqësore. Krahas kësaj, pasiguria lidhur me procesin e emërimit gjyqësor buron edhe nga fakti se të gjitha mandatet gjyqësore përfundojnë me largimin e UNMIK-ut.</p>		

Analiza/Sfondi:

Që nga zëvendësimi i KGJPK-së në vitin 2006, KGJK-ja ka qenë institucioni i cili ka qenë përgjegjës për rekomandimin e gjyqtarëve për emërim nga PSSP-ja. *Shih* RREGULLOREN MBI KGJK-NË § 5. KGJK-ja përbëhet nga 7 gjyqtarë, dhe 4 anëtarë jo-gjyqtarë (përfshirë këtu ministrin e Drejtësisë; kryesuesin e Komisionit parlamentar për çështjet legislative, gjyqësore dhe të Kornizës Kushtetuese; kryetari i OAK-së; dhe një profesor të drejtësisë). *Shih id.* § 2.1, 2.3. Kryetari i Gjykatës Supreme shërben si kryetar i KGJK-së *id.* § 2.1. Si pjesë e përgjegjësisë së mbikëqyrjes së përzgjedhjes dhe emërimit të gjyqtarëve, KGJK e ka krijuar Komisionin për emërimet dhe zhvillimin e gjyqësorit. *Shih* RREGULLOREN PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM TË KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS § 10.6. Ky komision është i paraparë t'i shqyrtojë kërkesat për emërimet në gjyqësi dhe të bëjë rekomandimet lidhur me ato kërkesa para KGJK-së si dhe përcaktojë rregullat procedurale lidhur me shqyrtimin e këtyre kërkesave. Mirëpo, KGJK nuk i ka miratuar ende rregullat procedurale të komisionit. Lidhur me këtë komision dhe shqyrtimin nga ana e KGJK-së të kandidatëve për gjyqtarë, udhëzimet e vetme të Rregullores mbi KGJK-në janë ato se anëtarët (e KGJK-së) duhet të udhëhiqen nga nevoja për krijimin e një gjyqësori profesional, të pavarur, të paanshëm dhe shumetnik” RREGULLORJA MBI KGJK-NË § 5.2. Rregullat e brendshme të KGJK-së § 13.1.

Të anketuarit në përgjithësi kanë janë deklaruar në mënyrë të favorshme për aftësinë e Komisionit për emërim gjyqësor dhe zhvillim për përzgjedhjen e kandidatëve për gjyqtarë, ku raportohet se ka pasur shumë pak raste të ndonjë diskriminimi.

KGJK me shpallje publike do të bëjë të njohur vendet e lira dhe do të ftojë për parashtrimin e kërkesave për plotësimin e këtyre vendeve. *Shih* RREGULLORJA E KGJK-SË § 5.1. KGJK-je e përmbushë këtë detyrë duke bërë publikimin e shpalljes nëpër gazetatat lokale. Rregullorja e KGJK-

⁴ Para pilot PFEL, IGJK ka mbajtur një numër kursesh njoftuese për gjyqtarët e ri të emëruar. Mirëpo, në raportin vjetor të IGJK-së për vitin 2006 nuk përmenden këto kurse dhe për këtë arsye është e paqartë nëse këto aktivitete kanë vazhduar pas vitit 2005.

së gjithashtu i lejon këshillit që "të pranojë rekomandimet nga pushteti rajonal dhe komunal apo nga organet gjyqësore a organet e tjera juridike përkitazi me personat që konsiderohen si të përshtatshëm për t'i intervistuar për punën e *gjyqtarit porotë*". *Id.* Përshtatshmërisht, KGJK-ja i pranon rekomandimet nga këto burime. Pas thirrjes për parashtrimin e kërkesave, Sekretariati i KGJK-së i shqyrton kërkesat dhe vendos nëse kandidatët i plotësojnë kriteret minimale për funksionin e gjyqtarit ashtu siç është diskutuar më herët në faktorin 1 si më lart. KGJK-ja i merr një numër hapash gjatë përzgjedhjes së kandidatëve për funksionin e gjyqtarit. Procesi i verifikimit përfshinë edhe verifikimin e të kaluarës nga policia, të pasuar me intervistat përkatëse me Komisionin për emërimet dhe zhvillim të gjyqësorit. Gjatë intervistave të tyre, nga kandidatët kërkohet të diskutojnë kualifikimet profesionale dhe arsimore, përvojën e kaluar si dhe qëndrimet e tyre etike. Ka gjithashtu dispozita të cilat inkurajojnë emërimin në gjyqësi të kandidatëve nga grupet etnike të nën-përfaqësuar. *Shih* faktorin 4, si më poshtë, për hollësi të mëtejshme. Mirëpo, për shkak se Rregullorja e KGJK-së nuk përmban asnjë dispozitë lidhur me shqyrtimin e aplikacioneve për gjyqtarë, shpesh kryetarët e gjykatave nuk pyeten për mendimin e tyre lidhur me kandidatët për gjyqësor. Krahas kësaj Oda e Avokatëve dhe publiku gjithashtu nuk kanë mundësi të kontribuojnë në këtë drejtim. Prandaj, si shqetësim kryesor paraqitet mungesa e transparencës në procesin e vendim-marrjes të komisionit.

Pas intervistave, komisioni rekomandon kandidatët e suksesshëm pra KGJK-së në përbërje të plotë, i cili duhet t'i aprovojë rekomandimet me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm. Rregullat e brendshme të KGJK-së § 13.2 (a). KGJK mund të kërkojë informata shtesë lidhur me kandidatët *Id.* § 13.2 (b). Në rast se KGJK e refuzon rekomandimin e komisionit, duhet ta rekomandojë një kandidat tjetër nga lista e ngushtë e kandidatëve; mirëpo, nëse KGJK refuzon 3 rekomandime radhazi për të njëjtën pozitë, pozita duhet të rishpallet dhe të fillohet me procesin e ri të përzgjedhjes. *Id.* § 13.2 (c)-(d). Pas aprovimit, KGJK i bën rekomandimet për PSSP-në i cili i emëron gjyqtarët nga lista e kandidatëve të propozuar nga KGJK dhe e miratuar nga Kuvendi. KORNIZA KUSHTETUESE neni § 9.4.8. Kuvendi pritet të jep përgjigjen KGJK-së brenda 30 ditësh që nga pranimi i listës. Kuvendi mund të kërkojë informata shtesë nga KGJK-ja por nuk ka të drejtë t'i zëvendësojë emrat; mirëpo KGJK-ja mund ta ndryshojë rekomandimin bazuar në rishikimin e informatave shtesë. Rregullat e brendshme të KGJK-së § 13.3. Disa prej deputetëve të Kuvendit kanë shprehur shqetësimin e tyre lidhur me emërimin e disa gjyqtarëve të caktuar, me të cilët ata nuk ishin të kënaqur, por ishte e paqartë për ekipin vlerësues se çka ishte burimi i kësaj pakënaqësie.

Krahas adresimit të çështjeve tipike që paraqiten gjatë përzgjedhjes dhe procesit të emërimit për gjyqtarë, gjyqësia e Kosovës është në një situatë të veçantë për atë se gjyqtarët e tanishëm në detyrë duhet t'i nënshtrohen vlerësimit për riemërim pas skadimit të mandatit të UNMIK-ut në Kosovë. *Shih* RREGULLORJA MBI KORNIZËN E SISTEMIT TË DREJTËSISË § 7. Për adresimin e kësaj situatë, Rregullorja mbi kornizën rregullative të sistemit të drejtësisë parashikon krijimin e Komisionit të pavarur gjyqësor dhe prokurorial (KPGJP) si një organ autonom i KGJK-së. KPGJP ka për qëllim të mbikëqyrë riemërimin e gjyqtarëve të tanishëm dhe emërimin e gjyqtarëve të rinj deri në përfundimin e mandatit të UNMIK-ut në Kosovë. Modeli i KPGJP-së është shfrytëzuar në mënyrë të suksesshme në Bosnje dhe Hercegovinë në vitin 2001, kryetari i KGJK-së ka marrë pjesë në seminarin e organizuar mbi këtë çështje me përfaqësuesit e Bosnjës. Funksionimi i KPGJP-së në Kosovë është paraparë të fillojë në maj të vitit 2007, para largimit të UNMIK-ut. Mirëpo, nënshkrimi i memorandumit të mirëkuptimit i cili do ta mundësonte këtë funksionim është shtyrë për një kohë të pacaktuar prandaj puna e KPGJP-së për riemërimin e gjyqtarëve ende nuk ka filluar. Në rast se përfundimisht finalizohet puna e KPGJP-së atëherë ky komision do të punojë në 3 faza. Faza e parë do të jetë vlerësimi i aplikacioneve për riemërim në Gjykatën Supreme. Faza e dytë do të jetë zgjedhja e gjyqtarëve për Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje, gjykatat e qarkut dhe për Gjykatën Ekonomike. Përzgjedhja për gjykatat komunale dhe të kundërvajtjes përbën fazën e tretë të procesit. *Shih* Direktivën mbi KPGJP § 2.3. Përkitazi me rekomandimet, KPGJP kërkohet t'i merr parasysh këto kritere: 1. njohuritë profesionale, përvojën e punës dhe rezultatet; 2. aftësinë e arsyetimit ligjor të manifestuar me punën e shkrimit akademik, aktivitete tjera profesionale, si dhe gjatë intervistës; 3. aftësitë profesionale të bazuara në të arriturat e

mëparshme në karrierë duke përfshirë pjesëmarrjen nëpër trajnime; 4 aftësinë e analizës së problemeve ligjore; 5 aftësinë e kryerjes së funksionit gjyqësor në mënyrë të paanshme, të ndërgjegjshme, të zellshme, të vendosur dhe përgjegjshme; 6 aftësitë e komunikimit; 7 raportet me kolegë, sjelljet jashtë zyrës dhe integriteti; dhe 8. përvoja dhe kualifikimet drejtuese (për kandidatët për pozitën për kryetarë të gjykatave). *Id.* § 3.2.

Procesi i ri i përzgjedhjes nga KPGJP-ja bazohet në mbledhjen e informatave dhe materialit mbi të kaluarën si dhe në intervistën e realizuar në një formë të standardizuar. *Shih* Direktivën mbi KPGJP § 2.6.3. Përgjithësisht, nga gjyqtarët në detyrë nuk kërkohet të hyjnë në provim. Mirëpo, disa gjyqtarëve individë mund t'u kërkohet ta bëjnë një gjë të tillë, duke u bazuar në nevojën e kolegjit të KPGJP-së për informata plotësuese lidhur me njohuritë ligjore të kandidatit si dhe aftësitë e tij. *Id.* § 2.6.3. Përkundër karakterit *ad hoc* të KPGJP-së, krijimi i tij manifeston lëvizjen drejtë cilësisë të kapaciteteve ekzistuese në gjyqësi, si dhe në njohjen e nevojës për procedura të standardizuara për procesin e përzgjedhjes së gjyqtarëve. Me shpresë, ky moment do të ruhet nga ana e KGJK-së me përfundimin e procesit ndërkombëtar.

Faktori 3: Arsimimi i Vazhdueshëm Ligjor

Gjyqtarët duhet t'i përcjellin rregullisht, dhe pa shpenzime për ta, dhe të përgatitura profesionalisht kurset për arsimim të vazhdueshëm ligjor, lëndët e të cilave në përgjithësi përcaktohen nga vetë gjyqtarët, dhe me të cilat kurse ata njoftohen për ndryshimet dhe zhvillimet në fushën e drejtësisë.

Konkluzioni	Korrelacioni: Pozitiv	Trendi: ↑
Edhe pse nuk parashikohet me ligj, arsimimi i vazhdueshëm ligjor për gjyqtarët është paraparë si obligim në kuadër të Kodit të ri etikës për gjyqtarë. IGJK-ja punon ngushtë me KGJK-në drejt ofrimit të kurseve për AVL duke marr parasysh nevojat e gjyqtarëve. IGJK-ja e harton programin vjetor trajnues dhe shumica e gjyqtarëve marrin pjesë së paku në një program për një vit.		

Analiza/Sfondi:

Gjersa kurset për arsimim të vazhdueshëm ligjor nuk parashikohen në mënyrë të shprehur si të obligueshme për gjyqtarë me asnjë ligj, Kodi i ri i etikës dhe sjelljes profesionale për gjyqtarë parashikon që "gjyqtari duhet t'i ruaj dhe përmirësojë standardet më të larta të profesionalizmit dhe ekspertizës ligjore dhe për këtë qëllim do të angazhohet në arsimimin e vazhdueshëm ligjor dhe trajnimin e paraparë nga KGJK-ja ..." KODI I ETIKËS PROFESIONALE PËR GJYQTARË § IIIA(3), (miratuar nga KGJK më 25 prill 2006) [më tutje KODI I ETIKËS PËR GJYQTARË - 2006]. IGJK fillimisht ishte themeluar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë në vitin 2000. IGJK ishte themeluar me qëllim të shërbejë si institucion trajnues dhe funksionet e tij përfshinin hartimin e provimeve përgatitore për gjyqtarë dhe krijimin e kurseve të arsimit të vazhdueshëm ligjor për gjyqtarët.⁵

Ligji mbi IGJK-në e krijon atë si një subjekt të pavarur ligjor me Bordin e vet drejtues. *Shih* Ligjin mbi IGJK-në neni 1. Bordi 13 anëtarësh përbëhet nga përfaqësuesit e qeverisë, Gjykatës Supreme, Prokurorisë Publike, SHGJK-së, OAK-së, Shoqatës së prokurorëve të Kosovës, Shoqatës së juristëve të Kosovës, Fakulteti Juridik i Universiteti të Prishtinës, UNMIK-u dhe OSBE, si dhe dy

⁵ Krahas ofrimit të trajnimeve për gjyqtarë, IGJK trajnon edhe prokurorët, personelin e gjykatave dhe oficerët e lartë të policisë.

anëtarë *ex officio* (kryetari i KGJK-së dhe drejtori i DAGJ-së) *Id.* nenet 3.1-3.4. Bordi drejtues e ka përgjegjësinë e miratimit të buxhetit të IGJK-së dhe programit trajnues, dhe të mbikëqyrjes së metodologjisë së zbatuar në trajnimet e IGJK-së. *Id.* neni 3.6. Kohën e fundit edhe kontrolli vendor ndaj IGJK-së është rritur. Në muajin prill të vitit 2006, një gjyqtar kosovar ishte emëruar si drejtor i vetëm i institutit, ndërsa pjesëmarrja administrative e OSBE-së tani është e kufizuar në statusin këshillëdhënës. Tani IGJK-ja financohet nga buxheti i konsoliduar i Kosovës. Për vitin fiskal 2007, IGJK-ja ka kërkuar buxhetin vjetor prej 600,000, euro dhe ka marrë 250,000 euro.

Numri i trajnimeve të ofruara nga IGJK ka shënuar rritje të vazhdueshme gjatë disa viteve të fundit. Midis janarit 2000 dhe dhjetorit 2006, IGJK ka mbajtur 311 seanca trajnuese, ku në vitin 2000 IGJK-ja ka mbajtur 24 trajnime, 20 në v. 2001, 42 në vitin 2002, 55 në v. 2003, 52 në v. 2004, 55 në v. 2005 dhe 63 në v. 2006. *Shih* Buletinin e IGJK-së (2007). Në vitin 2006, 1,179 gjyqtarë i kanë ndjekur seancat (Kosova kishte pak më shumë se 300 gjyqtarë në vitin 2006, dhe shumë gjyqtarë kanë ndjekur mesatarisht nga 2-3 programe). *Shih* raportin vjetor të IGJK-së 2006 në f. 2. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2007 janë mbajtur 46 seanca trajnuese. Të gjithë gjyqtarët e intervistuar nga ekipi i vlerësimit kanë theksuar se ata e kanë ndjekur së paku një seancë, ndërsa të gjithë gjyqtarët e kanë ndjekur trajnimin mbi Kodin e etikës profesionale për gjyqtarë. Pjesëmarrja në trajnime nga pakicat gjithashtu ka shënuar ngritje gjatë viteve të fundit, me 61 serbë dhe 19 pjesëtarë të pakicave tjera vitin 2006. IGJK ka trajnues serbë ndërsa të gjitha programet e institutit përkthehen në mënyrë simultane në shqip, serbisht dhe anglisht si tri gjuhët zyrtare të Kosovës.

IGJK e harton plan-programin gjatë tetorit dhe nëntorit të secilit vit duke u bazuar në kontributin e mbledhur nga disa burime të ndryshme. Këto janë, formularët e vlerësimit mbi sugjerimet që jepen për plotësim pas secilës seancë trajnuese, pyetësi për vlerësimin e nevojave trajnuese që i dërgohet çdo gjyqtari, takimet e rregullta me kryetarët e gjykatave, dhe raportet e Seksionit për monitorim të sistemit ligjor të OSBE-së, që publikohen periodikisht nga Misioni i OSBE-së në Kosovë – Departamenti për të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit. Para hartimit të planit vjetor, IGJK mban takime në secilin prej pesë gjykatave të qarkut, duke ftuar secilin gjyqtarë dhe prokuror për t'i paraqitur sugjerimet e tyre. Pastaj, kalendari trajnues për tërë vitin iu shpërndahet gjithë gjyqtarëve, së bashku me formularët e aplikacionit ku ata mund të zgjedhin programet të cilat dëshirojnë t'i ndjekin. Mirëpo, disa të anketuar janë shprehur se gjyqtarëve të instancave më të larta u jepet më shumë qasje në programe.

IGJK ka mbajtur trajnime lidhur me: ligjet më të reja civile dhe të procedurës penale, ligjet e reja, të drejtat pronësore, eksproprijimin dhe kompensimin, privatizimin, pastrimin e parave, të drejtën e punës, trashëgiminë, të drejtën familjare dhe të drejtën për të mitur. Duhet të theksohet se deri më tani nuk është mbajtur asnjë program i IGJK-së mbi analizën ligjore dhe të shkruarit e vendimeve për gjyqtarë, edhe pse IGJK ka potencuar rëndësinë për trajnime inter-aktive. Për shembull, nga trajnuesit kërkohet të kenë njohuri për përdorimin e programit "power point" dhe metodat inter-aktive të mësimdhënies dhe duhet ta kufizojnë secilin "ligjërimit" në maksimum 20 minuta. IGJK ka mbajtur edhe punëtori mbi të drejtën procedurale, duke përfshirë tryezat e rumbullakëta të diskutimeve njëjavore mbi Kodin e përkohshëm të procedurës penale [PCPC],⁶ si dhe mbi çështjet specifike procedurale siç janë procedura e ngritjes së aktakuzës, të provuarit, (duke përfshirë mjekësinë ligjore, paraburgimin dhe ekzekutimin e sanksioneve penale dhe alternative).

IGJK gjithashtu ka ofruar lëndë mbi teknologjinë informative si dhe mësim praktikë mbi menaxhimin e sallës së gjykimit dhe të lëndëve. IGJK ka organizuar edhe gjykime të simuluar nëpër sallat e gjykimit në të gjitha rajonet e Kosovës dhe këto kanë qenë shumë të popullarizuara. Për shkak se me rregulloren për themelimin e KGJK-së përgjegjësitë e hetimeve janë bartur prej gjyqtarëve tek prokurorët, programet mbi teknikat e hetuesisë i janë drejtuar prokurorëve. Gjatë vitit 2007, IGJK ka ofruar së paku një temë në javë dhe gjatë disa javëve edhe deri në 4 tema janë ofruar. Këto tema janë ofruar në ndërtesën e IGJK-së, e cila në vitin 2006 është bartur nga

⁶ KPPP është në fuqi. Është i përkohshëm ngase është një kod i UNMIK-ut, dhe jo i Kuvendit të Kosovës dhe i shpallur në fuqi nga UNMIK-u, prandaj do të pushoj së vepruari me pushimin e mandatit të UNMIK-ut.

ndërtesa e vjetër pjesë e Universitetit të Prishtinës në një ndërtesë të re dhe mirë të pajisur e cila përmban bibliotekën elektronike si dhe të shkruar, laboratorin kompjuterik dhe pajisjet trajnuese të teknologjisë më të re. Mësimet janë mbajtur dhe në rajonet tjera të Kosovës. Gjyqtarët dhe prokurorët marrin gjithashtu edhe një buletin informativ mujor nga IGJK-ja, ku paraqitet përmbledhja e programeve trajnuese për atë muaj.

Momentalisht, pjesëmarrja e huaj në dhënien e AVL-së përbëhet nga programe të përbashkëta të donatorëve siç janë: dy nga Aktiviteti për Reformimin e Sistemit të Drejtësisë në Kosovë i USAID-së; AER (për çështje të edukimit mbi ligjin evropian kundër korrupsionit dhe trafikimit); Këshilli i Evropës (në formën e temave mbi Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të ligjruara nga ekspertët e Këshillit të Evropës); Programi zhvillimor i Kombeve të Bashkuara [UNDP] (UNDP së fundi është marrë vesh me një grup gjyqtarësh kosovar për ta vizituar Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg); Ekipi planifikues e Bashkimit Evropian; dhe Fondi për fëmijë i Kombeve të Bashkuara [UNICEF] (lidhur me dispozitat e programeve për të mitur). Shumë prej këtyre programeve kanë shërbyer për të arritur përparim të konsiderueshëm në vetëdijesimin gjyqësor mbi të drejtat e njeriut përballë procedurës penale. Gjersa ekspertët e huaj vazhdojnë të ndihmojnë programet e IGJK-së, përqindja trajnuesve lokal në IGJK vetëm sa është ngritur që nga themelimi i institutit. Momentalisht, janë dy trajnues të Institutit me orar të plotë dhe një numër i gjyqtarëve, prokurorëve, profesorëve të drejtësisë dhe avokatëve si trajnues bashkëpunëtorë. Së fundi janë mbajtur një numër programesh “trajnimesh për trajnerë” duke përfshirë një program ku një gjyqtar ndërkombëtar ka trajnuar katër gjyqtarë që të bëhen trajnues, duke i mbikëqyrur ata gjatë trajnimit të gjyqtarëve tjerë “si të bëhen gjyqtarë” duke shfrytëzuar rastet konkrete për studim.

Kur të hyjë tërësisht në funksion IGJK-ja pritet të ofrojë trajnim para-gjyqësor përmes programit PFEL (shih diskutimin në Faktorin 2), si dhe programin për arsimim të vazhdueshëm ligjor (PAVL). PAVL do të përfshijë trajnimet themelore për të gjithë gjyqtarët, si dhe trajnim të specializuar për gjyqtarët e gjykatave më të larta. Gjersa programet e IGJK-së janë zgjeruar jashtëzakonisht që nga viti 2004, qëndrueshmëria afatgjate e IGJK-së si një institucion i pavarur dhe aftësia për çuarjen përpara të synimeve ambicioze, do të varet nga resurset që do t'i ndahen nga buxheti i konsoliduar i Kosovës.

Faktori 4: Përfaqësimi Gjinor dhe i Pakicave

Në grupin e të propozuarve si dhe në gjyqësi, pakicat etnike dhe fetare, si dhe të dyja gjinitë, përgjithësisht janë të përfaqësuara

Konkluzioni	Korrelacioni: Neutral	Trendi: ↔
<p>Gjyqësia gëzon <i>de jure</i> një kornizë të fuqishme për mbrojtjen e të drejtave të pakicave dhe barazisë gjinore. Përfaqësimi i pakicave etnike dhe fetare në radhët e të emëruarve për funksionin e gjyqtarit në përgjithësi është në përpjesëtim me përfaqësimin e tyre në popullsinë e Kosovës përkundër disa raporteve mbi hezitimin e pakicave për të shërbyer në sistemin gjyqësor të Kosovës. Mirëpo, femra ende është e nën-përfaqësuar, veçanërisht në nivelet më të larta të gjyqësisë.</p>		

Analiza/Sfondi:

Kosova ka një kornizë mjaft të fuqishme *de jure* për barazinë e pakicave. Me ligj gjyqësia duhet të reflektojë natyrën e shumëllojshmërisë të popullit të Kosovës. *Shih* KORNIZËN KUSHTETUESE § 9.4.7. KORNIZA RREGULLATIVE E SISTEMIT TË DREJTËSISË gjithashtu ripërtëritë kushtin e shumëllojshmërisë duke kërkuar kështu nga KGJK dhe Kuvendi “të sigurojnë se gjyqësori i Kosovës dhe prokuroria të reflektojnë karakterin shumetnik të Kosovës dhe nevojën për përfaqësim të barabartë të të gjitha bashkësive të Kosovës.” KORNIZA RREGULLATIVE PËR SISTEMIN E DREJTËSISË § 2.1. KGJK dhe Kuvendi duhet gjithashtu t’i njohin “parimet ndërkombëtare mbi barazinë gjinore”, ashtu si parashikohet me instrumentet e parapara me Kornizën Kushtetuese. *Id.* § 2.2.

Mbrojtja përmes Ligjit kundër diskriminimit të “parimit të trajtimit të barabartë” dhe “parimit të përfaqësimit të drejtë” pa marr parasysh përkatësinë gjinore ose etnike zbatohet në gjyqësi si dhe organizatat profesionale ku gjyqtarët janë anëtarë. LIGJI KUNDËR DISKRIMINIMIT neni 2. (*shpallur në fuqi* me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/32). Ligji ndalon diskriminimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë, ngacmimin dhe segregacionin dhe të gjitha këto janë të definuara me ligj. *Shih Id.* neni 2, 3. Këto parime duhet të zbatohen gjatë përzgjedhjes, rekrutimit, avancimit në punë, shkarkimit, pagesës, anëtarësimit në organizatat profesionale dhe qasjen në trajnime. *Id.* neni 4. Masat e veprimit pozitiv të llojit të veprimeve që kanë për qëllim parandalimin ose kompensimin për pozitën e pafavorshme që mund të ndërlihet me njërën ose më shumë prej bazave të diskriminimit janë të lejueshme për aq sa këto masa janë në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. *Id.* neni 6.

Në harmoni me këto dispozita, Korniza rregullative ka një numër më të madh udhëzimesh lidhur me përfshirjen pakicave etnike në sistemin gjyqësor. Në veçanti parashikohet që aplikacionet për pozitat e lira gjyqësore të thirren për plotësim nga komunitetet e nën-përfaqësuara duke i dhënë përparësi pjesëtarëve të këtyre komuniteteve midis kandidatëve me kualifikime të barabarta, dhe të rezervohet një numër i pozitave për këta kandidatë. KORNIZA RREGULLATIVE PËR SISTEMIN E DREJTËSISË § 2.3. KGJK-ja duhet të ndërmerr “hapa të menjëhershëm” për përmbushjen e kësaj kërkesë për aq sa të mbetet përçindja e gjyqtarëve dhe prokurorëve nga komunitetet jo-shqiptare të Kosovës nën 15 % dhe/ose nën 8% nga komuniteti serb i Kosovës. *Id.* § 2.4. Përveç kësaj, ka dispozita edhe për krijimin e Komisionit këshillëdhënës mbi pakicat i përbërë nga një shumicë e gjyqtarëve dhe prokurorëve nga komunitetet e nën-përfaqësuara, me qëllim të këshillimit të KGJK-së mbi këto çështje. *Id.* § 2.5; *shih gjithashtu* Rregullat e brendshme të KGJK-së *Id.* § 10.11.

Ashtu si tregohet në tabelën si më poshtë, gjersa numri i gjyqtarëve nga pakicat është rritur vetëm pak që nga viti 2005, kjo nuk paraqet shpërputhje tepër të madhe krahasuar me përbërjen e përgjithshme etnike të popullsisë të Kosovës. Që nga dhjetori i vitit 2006, shqiptarët etnikë përbënin përafërsisht 92% të popullsisë së Kosovës prej 2,100,000. “Grupet tjera etnike” (përfshirë serbët, boshnjakët, turqit, romët, garantë, shkalitë dhe egjiptasit) përbënin përafërsisht 8%. Serbët përbënin shumicën në radhët e këtyre të fundit. *Shih* Enti Statistikor i Kosovës [ESK], *Kosova në numra 2006*, që gjinden në <http://www.ks.gov.net/ESK/>.

PËRFAQËSIMI I PAKICAVE NË GJYQËSI

	2005		2006		2007	
	Gjithsejtë	%	Gjithsejtë	%	Gjithsejtë	%
Gjithsejtë numri i gjyqtarëve	307	100	313	100	309	100
Gjyqtarët shqiptarë	278	91	279	89	274	88.7
Gjyqtarët serbë	13	4	15	5	15	4.9
Gjyqtarët tjerë etnikë	16	5	19	6	19	6.5

Përderisa thuhet se serbët përbëjnë shumicën prej 8% të “grupeve tjera etnike”, duket se shifra prej 4.9% e gjyqtarëve serbë mund të mos jetë përfaqësuese e përqindjes së vërtetë të serbëve në popullatën e përgjithshme. Edhe pse nuk duket të ketë diskriminim të hapur ndaj pakicave në procesin e përzgjedhjes gjyqësore dhe të emërimit, prapë ka arsye përse pakicat, veçanërisht serbët, hezitojnë të aplikojnë për pozitat për gjyqtarë. Në të vërtetë, të anketuarit kanë raportuar se një gjyqtarë i pakicës serbe së fundi e ka refuzuar postin në sistemin gjyqësor të Kosovës. Ato me çka ballafaqohen gjyqtarët që zgjedhin të punojnë në sistemin gjyqësor të Kosovës janë, presioni nga familja, miqtë dhe komuniteti si dhe frika nga rreziku fizik. Serbët që punojnë nëpër gjykatat e Kosovës me shumicë shqiptare shpesh shihen si tradhtarë nga ana e familjes dhe miqve dhe mund të kërcënohen me ndëshkime. Ka disa kufizime në lëvizjen e gjyqtarëve nga pakicat brenda komuniteteve të tyre dhe të anketuarit kanë raportuar një numër shqetësimesh lidhur me sigurinë e tyre personale. Tani ekziston procedura me të cilën gjyqtarët mund t’i paraqesin kërkesë me shkrim policisë për ofrimin e sigurisë, por kërkesat e tyre mund të aprovohen ose refuzohen, varësisht nga vlerësimi i gjendjes të cilin e bën policia.

Një pengesë tjetër e rëndësishme ndaj rekrutimit të gjyqtarëve serbë është ekzistimi i gjykatave “paralele”, të cilat gjenden nëpër enklavat serbe të Kosovës, si dhe mbështetja e serbëve të Kosovës në sistemin gjyqësor të Serbisë. Vendimet e gjykatave paralele nuk i pranon UNMIK-u dhe nuk janë të zbatueshme në gjykatat e Kosovës. Mirëpo, gjyqtarët nga pakicat janë më shumë të stimuluar financiarisht të punojnë në sistemin paralel të gjykatave serbe se sa në sistemin gjyqësor të Kosovës. Gjyqtarët e pakicave të cilët punojnë nëpër gjykatat legjitime në Serbi në përgjithësi i kanë rrogat më të mëdha se sa homologët e tyre në gjyqësinë e Kosovës dhe përfitojnë nga një pension të arsyeshëm pas pensionimit. *Shih* Faktorin 11 si më poshtë për më shumë hollësi lidhur me mjaftueshmërinë e pagave të gjyqtarëve në Kosovë.

Tërheqja e gjyqtarëve nga pakicat do ta rriste legjitimitetin e gjyqësisë. Në të kaluarën, pakicat kanë ngurruar t’u drejtohen gjykatave të Kosovës, nga se kishin shumë pak besim se ato do të trajtoheshin në mënyrë të drejtë. Ky qëndrim ka qenë mbizotërues veçanërisht në komunitetet më të vogla. Mirëpo, duket se situata është duke u ndryshuar për të mirë. Siç raportohet, qytetarët nga pakicat tani më shumë janë të gatshëm që kontestet e tyre t’i zgjidhin në gjykatat e Kosovës më parë se në gjykatat paralele. Një faktor i cili ka kontribuar në ngritjen e pjesëmarrjes së pakicave, ka qenë hapja e degëve të gjykatave nëpër enklavat sikur ajo e Graçanicës. Krahas kësaj, të anketuarit e të dyja komuniteteve – të shumicës dhe pakicës – janë shprehur të pajtuar se sistemi gjyqësor i tanishëm i trajton palët procedurale të pakicave në mënyrë të barabartë dhe të drejtë dhe se gjyqtarët tani janë të vetëdijshëm për standardet ndërkombëtare mbi të drejtat e barabarta të cilat janë inkorporuar në ligjin vendor përmes Kornizës Kushtetuese. *Shih* KORNIZA KUSHTETUESE § 3.2. OSBE-ja nuk ka raportuar për asnjë rast të animit mbi baza etnike në 81 rastet e monitoruara gjatë vitit 2005. SEKSIONI PËR MONITORIMIN E SISTEMIT LIGJOR, OSBE, SHQYRTIMI I SISTEMIT TË DREJTËSISË PENALE 1999-2005 (2006) f. 29 [më tutje RAPORTI MONITORUES I OSBE-SË 2006.

Kosova ka gjithashtu një kornizë të fuqishme *de jure* lidhur me barazinë gjinore. Ligji mbi barazinë gjinore në Kosovë ka disa dispozita të cilat promovojnë të drejtat e gruas, duke përfshirë këtu edhe garantitë për të drejtat e barabarta në gjyqësi. Ligji bën thirrje qeverisë që të ndërmerr hapa pozitiv për krijimin e pjesëmarrjes së barabartë të gruas në “organet gjyqësore të të gjitha niveleve”. *Shih* LIGJIN MBI BARAZINË GJINORE § 3.1 (*i shpallur në fuqi* përmes RREGULLORES SË UNMIK-UT NR. 2004/18 [më tutje LIGJI MBI BARAZINË GJINORE]. Me ligj përcaktohet “pjesëmarrja e barabartë gjinore” si “pjesëmarrje e gjinisë së caktuar me . . . 40%.” *Id.* § 3.2. Shkalla prej 40% është e paraparë me ligj për emërimet në organet qeveritare, duke përfshirë gjyqësinë. *Id.* § 3.3. Ashtu si është diskutuar më herët në këtë faktor, Ligji kundër diskriminimit gjithashtu ofron mbrojtje nga ngacmimi, si dhe nga të gjitha format e diskriminimit të bazuar në gjini ose çështje gjinore. *Shih* LIGIN KUNDËR DISKRIMINIMIT neni 2, 3.

Barazia gjinore *de facto* ka qenë më vështirë të realizohet. Përfaqësimi i tanishëm i gjyqtareve femra në gjyqësi është i paraqitur në tabelën si më poshtë:

PËRFAQËSIMI I GRUAS NË GJYQËSI

Viti	Numri i gjyqtarëve në gjyqësi	Nuri i gjyqtareve femra në gjyqësi	Përqindja e gjyqtareve femra në gjyqësi
2005	307	84	26%
2006	313	84	26%
2007	309	82	26.5%

Nuk ka p.sh., kryetare të gjykatës së qarkut; mirëpo, është një femër serbe anëtare e 11-të e KGJK-së. Siç duket nga tabela më lart, ka pasur shumë pak ndryshime në përfaqësimin e gruas në gjyqësi, dhe përqindja e tanishme e gjyqtareve femra nuk është në përputhje në bilancin gjinor të popullsisë së përgjithshme. Disa të anketuar këtë situatë ia veshin pjesëmarrjes së përgjithshme të ultë të gruas në profesionin ligjor, dhe perceptimit tradicional nga studentet lidhur me rolin e tyre duke i bërë femrat më hezituese që të aplikojnë për gjyqtare, prokurore ose avokate. Që nga prilli 2007, vetëm 48 avokatë ose 10% e të gjithë avokatëve ishin gra, që paraqet një përmirësim të vogël që nga viti 2004, kur 7.1% të gjithë avokatëve ishin femra. ABA/Iniciativa për sundimin e ligjit, Indeksi i reformës së profesionit ligjor në Kosovë, Vëllimi II 38 (2007). Përqindja e studenteve femra në Fakultetin Juridik të Prishtinës ishte 44.3% për vitin akademik 2005-2006, por femrat përbënin vetëm 35% të studenteve të diplomuara në shtator të vitit 2005. *Shih* MISIONI I OSBE-SË NË KOSOVË, PËRFAQËSIMI GJINOR DHE I BASHKËSIVE TË PAKICAVE NË ODËN E AVOKATËVE TË KOSOVËS 10 (2006).

Është e paqartë se cilat përpjekje specifike duhet t'i ndërmerr KGJK-ja për të sjellë gratë në pozitë për gjyqtarë ose për avancim në punë. Mirëpo, OAK ka ndërmarrë disa hapa *de facto* për rritjen e shkallës së përfaqësimit të gruas në profesionin ligjor të Kosovës. Në vitin 2004, OAK ka themeluar Komitetin për gruan dhe pakicat [më tutje Komiteti i OAK-së] për nxitjen e pjesëmarrjes së të dyja grupeve në profesionin ligjor. *Shih* VENDIMIN E KËSHILLIT DREJTUES TË OAK-SË NR. 169-1/05. Me ndihmën e Inicativës për sundimin e ligjit, në mars të vitit 2007 Komiteti i OAK-së ka filluar me takimet mujore si dhe ka organizuar dy tryeza të rumbullakëta të diskutimit. Tryeza e parë është mbajtur në qershor 2007 ishte fokusuar në hyrjen në profesionin ligjor në Kosovë dhe ka mbajtur diskutime në panel mbi çështjet se si mund të bëhet anëtarësimi në OAK, si bëhet regjistrimi si *praktikantë* (p.sh., referent), dhe si është e organizuar gjyqësia e Kosovës. Kjo ngjarje është përcjellë nga një numër studentësh serbë të diplomuar në drejtësi dhe ishte ngjarja e parë të cilën e kishte organizuar OAK posaçërisht për serbët e Kosovës. Tryeza e dytë e diskutimit është mbajtur në tetor 2007 dhe ka pasur tiparet e dhënies së udhëzimeve lidhur me ligjet e Kosovës dhe strukturën e gjyqësisë. Mirëpo, asnjë nga gjyqtarët serbë nuk ka marrë pjesë në këtë tryezë.

II. Pushteti Gjyqësor

Faktori 5: Rishqyrtimi Gjyqësor i Legjislacionit

Organi gjyqësor është i autorizuar të vendosë për kushtetutshmërinë e ligjeve dhe akteve tjera zyrtare dhe ky vendim është i ekzekutueshëm.

Konkluzioni	Korrelacioni: Negativ	Trendi: ↔
<p>Asnjë organ gjyqësor nuk i ka autorizimet për shqyrtimin e kushtetutshmërisë të ligjeve dhe akteve juridike. Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme për çështjet e Kornizës Kushtetuese, e cila është paraparë të themelohet dhe ta kishte detyrën e shqyrtimit të kushtetutshmërisë së ligjeve të Kuvendit, ende nuk është themeluar.</p>		

Analiza/Sfondi:

Momentalisht nuk ka ndonjë organ gjyqësor i cili është i autorizuar për rishqyrtimin e kushtetutshmërisë së legjislacionit ose të ofrojë komentet ose interpretimin e legjislacionit ekzistues. Para shpërbërjes së RSFJ-së, ka ekzistuar Gjykata Kushtetuese e cila i kishte 7 anëtarë. Në vitin 2001 Korniza Kushtetuese parashikon krijimin e Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme mbi çështjet e Kornizës Kushtetuese⁷. Shih KORNIZA KUSHTETUESE § 9.4.11. Mirëpo, një dhomë e tillë asnjëherë nuk është krijuar deri në përpilimin e këtij raporti. Të anketuarit kanë raportuar se dhoma nuk mund krijohej për shkak se Gjykata Supreme nuk ka ditur se sa gjyqtarë do të duhej t'i kishte kjo dhomë, ose si do të funksiononte, ose cili organ do ta kishte përgjegjësinë e ekzekutimit të vendimeve të dhomës. Gjykata Supreme ka kërkuar nga zyra e këshilltarit juridik të PSSP-së (ZKJ) udhëzime lidhur me paqartësitë e lartshënuara, por kjo zyre nuk ka dalë me udhëzimet përkatëse. Kur është diskutuar çështja e dhomës së veçantë për gjatë një tryeze të organizuar në dhjetor 2006 nga ana e Iniciativës për sundimin e ligjit, pjesëmarrësit kishin fituar përshtypjen se përgjigjja e ZKJ-së mund t'i atribuohet mungesës së interesit për krijimin e kësaj dhome. *Shih ABA/Iniciativa për sundimin e ligjit: RISITË NË REFORMIMIN E GJYQËSISË NË KOSOVË: DISKUTIMI NË TRYEZË I TRI ÇËSHTJEVE TË ZGJEDHURA MBI SISTEMIN GJYQËSOR (RAPORTI MBI TRYEZËN E RRUMBULLAKËT) 3 (2006).* (më tutje "raporti i tryezës).

Në rast të krijimit të dhomës së veçantë për çështje të Kornizës Kushtetuese, kjo e fundit përcakton se kush mund të paraqesë kërkesë të veçantë para dhomës: Kryetari i Kosovës, çdo anëtar i Kryesisë së Kuvendit, çdo Komision i Kuvendit, jo më pak se 5 deputetë të Kuvendit me kërkesë të përbashkët, ose Qeveria (p.sh., kabineti). KORNIZA KUSHTETUESE § 9.4.11. Personi privat nuk gëzon legjitimitetin aktiv të paraqitjes së kërkesës për shqyrtim nga dhoma e veçantë. Mirëpo, si duket nuk ka edhe ndalim të drejtpërdrejtë për personin privat që ta kundërshtojë kushtetutshmërinë e ligjit para gjykatës, në një situatë kur me atë ligj supozohet se shkelen të drejtat e atij individit të mbrojtura me Kornizë Kushtetuese ose me dispozitat e ligjit vendor mbi të drejtat e njeriut. Në mënyrë të ngjashme nuk ka asnjë ndalesë për gjyqtarin gjykues që mos të vendosë mbi çështjen e tillë. Në mesin e përgjegjësive tjera, Dhoma e veçantë për çështjet e Kornizës Kushtetuese do ta kishte fuqinë e vendosjes "nëse ligjet e miratuara nga Kuvendi, janë në pajtim me Kornizën Kushtetuese, ose me instrumentet juridike mbi të drejtat e njeriut, Id. § 9.4.11(a). Krahas kësaj, dhoma e veçantë për Kornizë Kushtetuese është kompetente edhe për zgjidhjen e konfliktit midis IPVQ-ve, ose midis deputetëve të Kuvendit, ose anëtarëve të Kryesisë, lidhur "mbi shtrirjen e të drejtave dhe detyrimeve të tyre". *Id.* § 9.4.11(b). Gjithashtu parashikohet të

⁷ Nëse miratohet propozimi i Ahtisaarit, do të mundësonte krijimin e Gjykatës Kushtetuese; mirëpo roli i këtij organi ende është i paqartë.

vendosë nëse vendimet e IPVQ-ve shkelin pavarësinë dhe përgjegjësitë e Ombudspersonit, ose ndonjë nga organet e pavarura të themeluara me Kornizë Kushtetuese. *Id.* § 9.4.11(c).

Gjithashtu është vërejtur në mënyrë të vazhdueshme se as gjyqtarët kosovarë e as gjyqtarët ndërkombëtarë nuk kanë autorizime për rishqyrtimin e rregulloreve të UNMIK-ut dhe akteve nënligjore. Kjo do të vazhdojë edhe me krijimin e dhomës së veçantë për Kornizë Kushtetuese. Gjyqtarët mund të kërkojnë qartësimin e ligjeve nga ZKJ edhe pse në praktikë ata këtë e bëjnë mjaft rrallë.

Faktori 6: Mbikëqyrja Gjyqësore e Veprimtarisë Administrative

Gjyqësia është kompetente t'i rishqyrtojë aktet administrative dhe t'i detyrojë organet qeveritare të vepronë kur ekziston obligimi ligjor për të vepruar.

<i>Konkluzioni</i>	<i>Korrelacioni: Negativ</i>	<i>Trendi: ↔</i>
<p>Gjykatat janë kompetente për rishqyrtimin e akteve administrative të qeverisë së Kosovës. Mirëpo, ekziston një huti lidhur me çështjet e kompetencës, ligjit në fuqi, dhe procedurës lidhur me këtë rishqyrtim. Kjo huti e kufizon shfrytëzimin efektiv të pushtetit gjyqësor. Përveç kësaj, gjykata nuk ka kompetenca për rishqyrtimin e akteve të administratës ndërkombëtare.</p>		

Analiza/Sfondi:

Çdo person që pohon se është në mënyrë të dëmshme nga një vendim i Qeverisë ose i një organizmi ekzekutiv, ka të drejtën e rishqyrtimit gjyqësor të atij vendimi pasi të jenë shterur të gjitha rrugët e rishqyrtimit administrativ. KORNIZA KUSHTETUESE § 9.4.2. Në kohën e shpalljes së Kornizës Kushtetuese, kanë ekzistuar dy ligje me të cilat rregullohej procedura administrative. *Shih* LIGJIN MBI KONFLIKTIN ADMINISTRATIV [më tutje LKA], Gazeta Zyrtare e RSFJ-së nr. 4/77; *shih gjithashtu* LIGJIN MBI PROCEDURËN E PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE [më tutje LPPA], GZ e RSFJ-së 585/86. Kuvendi i Kosovës që nga ajo kohë e ka miratuar Ligjin e ri mbi procedurën administrative. *Shih* LIGJI MBI PROCEDURËN ADMINISTRATIVE [më tutje LPA], (*shpallur në fuqi* përmes RREGULLORES SË UNMIK-UT NR. 2006/33. LPA kontrollon procedurën pranë organeve administrative, ndërsa ligji i vjetër LKA ende zbatohet për rishqyrtimin gjyqësor dhe rithekson të drejtën e rishqyrtimit pas shterjes së të gjitha mjeteve juridike administrative. LKA neni 7. Ligji i ri i procedurës administrative nuk e zëvendëson plotësisht Ligjin e vjetër mbi procedurën e përgjithshme administrative; por, LPA vetëm i shfuqizon ato dispozita të ligjit në fuqi të cilat janë në kundërshtim me të. LPA neni 142. Prandaj, LPA nuk e pakëson hutinë ekzistuese lidhur me konfliktin e ligjeve, nga se secili shqyrtim administrativ duhet të fillojë me vendimin se cila dispozitë ligjore duhet të aplikohet për secilin rast konkret. Në përgjithësi, LPA nuk ka bërë dallim të rëndësishëm në aspektin e rishqyrtimit gjyqësor të vendimeve administrative.

Individi mund të ankohet ndaj vendimit administrativ vetëm pasi t'i ketë shterur të gjitha mjetet juridike administrative në dispozicion. *Id* neni 127. *Shih gjithashtu* Ligjin mbi gjykatat e rregullta neni 29, GZ e Kosovës 21/78. Individët mund të ankohen në gjykatë kundër vendimit të shkallës së dytë të organit administrativ ose kundër vendimit të shkallës së parë, nëse nuk është paraparë mundësia e ankesës me vendimin administrativ. LKA neni 7.

Bazat për kundërshtimin e aktit (vendimit) administrativ përfshijnë: (a) kur ligjet mbi të cilat është mbështetur vendimi nuk janë zbatuar si duhet; (b) nëse ka qenë jo kompetent organi administrativ që e ka marrë vendimin; ose (c) nëse nuk është respektuar procedura administrative, ose nëse faktet nuk janë vërtetuar si duhet. *Id* neni 10. Çdo individ me interes personal në vendimin administrativ mund të paraqesë ankesë. *Id* neni 13. Pasi të vendosë gjykata lidhur me ankesën

ndaj aktit administrativ, ajo ka fuqi ta detyrojë organin administrativ të veprojë atëherë kur ekziston detyrimi ligjor për të vepruar. *Id neni 42, 62-65.*

Ligji mbi gjykatat e rregullta autorizon gjykatat e qarkut që në trup gjykues prej 3 gjyqtarësh të shqyrtojë ankesat lidhur me "veprimet e kundërligjshme të organeve qeveritare." Ligji mbi gjykatat e rregullta neni 29. Gjithashtu parashikon që kolegji administrativ i Gjykatës Supreme të vendosë lidhur me ligjshmërinë e vendimit të formës së prerë mbi konfliktin administrativ të organit administrativ. *Id neni 31.* Mirëpo, për shkak se Gjykata Supreme i ka vetëm 16 gjyqtar, dy prej të cilëve janë të caktuar t'i shqyrtojnë rastet e AKM-së, i ka caktuar vetëm dy gjyqtarë të punojnë në kolegjin administrativ (para vitit 1989, kanë qenë 5 gjyqtarë të Gjykatës Supreme të caktuar të punojnë lëndët administrative). RAPORTI I Seksionit për monitorimin e sistemit juridik i OSBE-së MBI SISTEMIN E DREJTËSISË ADMINISTRATIVE NË KOSOVË F. 16 (2007). Përshtatshmërisht, më 31 dhjetor 2006 kanë qenë 2.164 lëndë administrative të pazgjidhura. Nuk ka dispozita për mjetet e përkohshme siç janë masat e përkohshme.

Ombudspersoni ka hetuar një numër rastesh kur ka ndodhur një grumbullim i tillë i lëndëve të pazgjidhura dhe ka lëshuar raport ku konstatohen shkelje e të drejtës për ankesë (rishqyrtim gjyqësor). *Shih p.sh.,* Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë, RAPORTI I GJASHTË VJETOR F. 77 (2006) (ku përmendet shtyrja e shqyrtimit të ankesës administrative për shkak të vdekjes së një gjyqtari të Gjykatës Supreme, dhe dështimi rezultues i Gjykatës Supreme që t'i gjejë zgjidhje lëndëve të gjyqarit të ndjerë deri në zëvendësimin e tij. OSBE-së gjithashtu i ka identifikuar problemet me LKA dhe LPPA të cilat vetëm se i shtojnë vonesat në shqyrtimin gjyqësor. *Shih RAPORTI MBI SISTEMIN E DREJTËSISË ADMINISTRATIVE NË KOSOVË 8-12.* Për shembull, nuk ka gjykata të specializuara për rishqyrtimin e ankesave administrative, përveç kolegjit administrativ të Gjykatës Supreme. Si e tillë, pra Gjykata Supreme është e vetmja gjykatë e cila rishqyrton aktet administrative dhe është e stërmbyshur me lëndë, shumë prej të cilave ishin dashur të shqyrtohen nga gjykatat më të ulëta (p.sh., kontestet lidhur me shumën e pensionit, ose vendimet mbi besimin e fëmijës etj).

Çështja nëse gjykatat e ulëta mundën gjithashtu të rishqyrtojnë vendimet administrative ende nuk është zgjidhur. Nëse organi administrativ nuk vepron mbi ankesën, parashtruesi i ankesës mundet t'i drejtohet gjykatës "në pajtim me ligjin në fuqi mbi procedurën kontestimore." LPA neni 131.2. OSBE ka përfunduar se ligji mbi procedurën kontestimore dhe ndryshimet e mëvonshme të tij, sugjerojnë se gjykatat e qarkut dhe ato komunale duhet t'i shqyrtojnë këto kërkesa. *Shih RAPORTIN MBI SISTEMIN E DREJTËSISË ADMINISTRATIVE 18; shih edhe LIGJIN MBI PROCEDURËN KONTESTIMORE, amendamentet 36/80, 69/82, 58/84, 74/87, 57/89, 20/90 dhe 35/91.*

Përkritazi me pamundësinë e gjykatave për rishqyrtimin e akteve administrative të UNMIK-ut dhe KFOR-it, nuk ka pasur zhvillime të reja legjislative që nga viti 2004. *Shih RAPORTIN MBI TRYEZËN E RRUMBULLAKËT 4; shih edhe RREGULLOREN E UNMIK-UT NR. 2000/47 MBI STATUSIN, PRIVILEGJET DHE IMUNITETIN E KFOR-IT DHE UNMIK-UT DHE PERSONELIT TË TYRE NË KOSOVË § 3.1.* Mirëpo, është raportuar se viteve të fundit është reduktuar dukshëm shkalla e raportimit të shkeljeve të të drejtave nga ana e UNMIK-ut dhe KFOR-it. Disa raste kur autoritetet ndërkombëtare e kanë revokuar imunitetin e tyre kanë qenë rastet e aktakuzave për vepra të rënda penale..

Faktori 7: Juridiksioni Gjyqësor ndaj Lirive Qytetare

Gjykata ka kompetencë (juridiksion) ekskluzive dhe përfundimtare ndaj të gjitha rasteve që kanë të bëjnë me të drejtat dhe liritë qytetare.

Konkluzioni	Korrelacioni: Neutral	Trendi: ↑
<p>Gjykatat janë kompetente të shqyrtojnë rastet e të drejtave të njeriut përveç për veprimet e KFOR-it dhe UNMIK-ut. Kohëve të fundit është ngritur shkalla e angazhimeve dhe përpjekjeve për trajnim në çështjet e të drejtave të njeriut duke rezultuar në vetëdijesimin gjyqësor të shtuar mbi të standardet e të drejtave të njeriut dhe përmirësimeve në praktikë nga ana e shumë gjyqtarëve; mirëpo shumë gjyqtarë ende vazhdojnë të shfaqin mungesë të njohurive të punës në zbatimin e standardeve relevante.</p>		

Analiza/Sfondi:

Të gjithë personat në Kosovë gëzojnë, “pa diskriminim të asnjë lloji dhe në barazi të plotë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut” *Shih* KORNIZËN KUSHTETUESE § 3.1. IPVQ-të janë të obliguara të sigurojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të parapara në këto dokumente: Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut; Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e Saj; Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike të Njeriut dhe Protokollet e Saj; Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial; Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas; Konventën për të Drejtat e Fëmijëve; Kartën Evropiane të Gjuhëve Rajonale dhe Minoritare dhe Kornizën e Konventës së Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare. *Shih id. neni 3.1, 3.2.* Dispozitat për të drejtat dhe liritë e parashtruara në këto instrumente aplikohen në Kosovë drejtpërsëdrejti si pjesë e kësaj Kornize Kushtetuese” *Id. §t. 3.3.*

Disa ligje vendore në mënyrë të drejtpërdrejtë e adresojnë rolin e gjyqësisë në mbrojtjen e lirive qytetare. Në përgjithësi, gjykatat janë kompetente të rishqyrtojnë rastet e shkeljeve të supozuara të të drejtave të njeriut, dhe të sigurojnë zbatimin e standardeve të paraburgimit, gjyqimit të shpejtë, publik dhe se të njëjtat respektohen në procedurën penale dhe civile. Kjo kompetencë ka qenë e qartë që nga fillimi i mandatit të UNMIK-ut. Prandaj, KPPP përmban disa mbrojtje të të drejtave të njeriut që ndërlidhen me procedurën penale. Gjyqtarëve u jep kompetencë që gjatë procedurës paraprake “të vendosin lidhur me masat të cilat i kufizojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore individuale.” KPPP neni 9.3. Personat e burgosur gëzojnë të drejtën e rishqyrtimit gjyqësor të ligjshmërisë së paraburgimit të tyre dhe gëzojnë të drejtën e paraqitjes tek gjyqtari brenda 72 orësh prej arrestimit. *Id. neni 13(2), 14(2), 211, 212.* KPPP gjithashtu ka dispozitë e cila është analoge me *habeas corpus*: në çdo kohë gjatë paraburgimit, i paraburgosuri mund t’i ankohet gjyqtarit për vendosur për ligjshmërinë e paraburgimit të tij/saj. *Id. neni 286(3).* Krahas kësaj, Ligji kundër diskriminimit e bën gjykatën kompetente për të dëgjuar rastet e ndërlidhura me diskriminimin, dhe ankesat nga rastet e paraqitura para organeve administrative me kusht që mjetet juridike administrative të jenë shterur më parë. *Shih* LIGJIN KUNDËR DISKRIMINIMIT neni 3, 7;

Përkundër këtyre dispozitave, UNMIK-u dhe KFOR-i vazhdojnë të kenë imunitetin penal dhe civil. Edhe pse UNMIK-u i lejon Ombudspersonit që të hyjë në marrëveshje bilaterale me PSSP-në për rastet që kanë të bëjnë me UNMIK-un, ekipi vlerësues nuk mundur të dijë nëse është bërë një marrëveshje e tillë. *Shih* RREGULLOREN E UNMIK-UT NR. 2006/6 MBI INSTITUCIONIN E OMBUDSPERSONIT NË KOSOVË § 3.4 [më tutje RREGULLORJA MBI OMBUDSPERSONIN]. Në janar të vitit 2005, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës ka rekomanduar që UNMIK-u dhe KFOR-i në bashkëpunim me

Këshillin e Evropës ta krijojnë Gjykatën për të drejtat e njeriut për Kosovë me kompetencë që të shqyrtojë shkeljet e supozuara të të drejtave të garantuara me KEDNJ (duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në shkeljet e kryera nga UNMIK-u dhe KFOR-i). Rezoluta e Këshillit të Evropës, 1417: Mbrojtja e të drejtave të njeriut në Kosovë – CoE (2005). Mirëpo, deri sa është shkruar ky vlerësim nuk është themeluar ndonjë gjykatë e tillë. Komisioni i Venecias i Këshillit të Evropës gjithashtu ka rekomanduar krijimin e Kolegjit këshillues për të drejtat e njeriut deri në krijimin e gjykatës së këtillë. *Shih* MENDIMI I KOMISIONIT TË VENECIAS NR. 280/2004; *shih gjithashtu* RREGULLOREN E UNMIK-UT 2006/12 MBI THEMELIMIN E KOLEGJIT KËSHILLUES PËR TË DREJTAT E NJERIUT; Kolegji është krijuar dhe anëtarët janë caktuar por ende nuk ka filluar të funksionojë. *Shih gjithashtu* RAPORTIN E 7-TË TË OMBUDSPERSONIT 2006-2007, që i drejtohet Kuvendit të Kosovës, 14.

Numri i shtuar i trajnimeve dhe pjesëmarrja e gjyqtarëve në këto trajnime e ka ngritur vetëdijen gjyqësore mbi standardet për të drejtat e njeriut të inkuorpuara në ligjin e Kosovës dhe kanë përmirësuar praktikën e shumicës prej gjyqtarëve. Për shembull, IGJK-ja në bashkëpunim me Këshillin e Evropës ka prezantuar trajnime mbi KEDNJ-në dhe Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2007, IGJK-ja ka organizuar një numër seminaresh mbi procedurën penale duke përfshirë këtu punëtoritë lidhur me marrëdhëniet midis prokurorëve, policisë dhe gjyqtarëve (por jo avokatëve), si dhe një punëtori treditore mbi KPPP-në dhe një seminar dyditësh mbi legjislacionin penal të BE-së.

Përkundër progresit të shënuar më lart, zbatimi efektiv i të drejtave qytetare nga gjyqësia është dobësuar si rezultat i shumë faktorëve. Disa dispozita mbrojtëse të inkuorpuara në ligje kanë mbetur ende të pa aprovuara. Një mbrojtje e tillë është barazia e armëve midis të mbrojtjes dhe akuzës në procedurë penale. *Shih* KPPP neni 10. Gjersa disa avokatë mbrojtës kanë shtuar në mënyrë progresive njohuritë dhe janë bërë më të ashpër në përfaqësimin e klientëve, prapë, shumë prej tyre ende nuk e kanë përqafuar rolin aktiv në procedurën penale. Gjithashtu, shumë prej tyre hezitojnë t'i shfrytëzojnë konceptet juridike dhe argumentet të cilat gjyqtarët ende mund të mos i pranojnë.

Një dobësi tjetër e raportuar nga të anketuarit është mungesa e vazhdueshme e njohurisë punuese dhe interesit që shfaqet nga shumë gjyqtarë lidhur me zbatimin e standardeve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, përkundër bollëkut trajnues pjesëmarrjes së shtuar në trajnime. Ashtu siç konfirmohet nga ankesat që i dërgohen Ombudspersonit nga qytetarët, kjo mangësi pasqyrohet me mungesën e konstatimit të gjendjes faktike specifike dhe konstatimet ligjore që jepen në aktgjykime. Vendimet gjyqësore të cilave u mungojnë konstatimet specifike ngritin shqetësimet se gjyqtarët nuk i shqyrtojnë si duhet faktet ose ligjin (ndoshta për shkak të diskriminimit ose korrupsionit). Kjo bartë pasoja edhe në çështjen e paraburgimit dhe rezulton nga ankesat jo të plota.

Faktori 8: Sistemi i Vendosjes Sipas Ankesës

Vendimet gjyqësore mund të prishen vetëm në procedurë gjyqësore të vendosjes sipas ankesës.

<i>Konkluzioni</i>	<i>Korrelacioni: Pozitiv</i>	<i>Trendi: ↑</i>
Gjersa procesi i ankimit shpesh është i ngadaltë vetvetiu dhe i nënshtrohet disa defekteve, vendimet gjyqësore mund të kthehen për rigjykim vetëm përmes procedurës së ankimit. As UNMIK-u e as KFOR-i nuk i kanë anuluar (zmbropsur) vendimet e Gjykatës Supreme që nga viti 2001.		

Analiza/Sfondi:

Me ligjet e Kosovës, palës në procedurë ose përfaqësuesit ligjor të saj i garantohet e drejta e ankimit ndaj aktgjykimit të lëshuar nga gjykata e shkallës së parë. *Shih* KPPP neni 398; LIGJI MBI PROCEDURËN KONTESTIMORE neni 348. Gjykatat për kundërvajtje janë gjykata të shkallës së parë për veprat penale të dënueshme deri në 60 ditë burgim. Këto lëndë gjykohen nga gjyqtari i vetëm. Gjykata e lartë për kundërvajtje, e cila gjykon në trup gjykues prej tre gjyqtarëve, është kompetente dhe është instanca e fundit ankimore për këto vepra. Të gjitha ankesat ndaj vendimeve të gjykatave komunale – të cilat gjykojnë veprat penale të dënueshme me gjobë dhe me burgim deri në pesë vite, si dhe shumicën e rasteve civile – shqyrtohen në shkallë të dytë nga gjykatat e qarkut, të cilat edhe këto shërbejnë si gjykata të shkallës së parë për veprat penale të dënimi për të cilat tejkalon pesë vite burgim, si dhe disa konteste civile juridike⁸. Gjykatat e qarkut mund të rishqyrtojnë *de novo* si faktet ashtu edhe arsyetimin ligjor të aktgjykimit. *Shih* LIGJIN MBI GJYKATAT E RREGULLTA neni 29; KPPP neni 23(2). Si gjykatë më e lartë e apelit, Gjykata Supreme shqyrton ankesat kundër vendimeve të shkallës së parë që vijnë nga gjykatat e qarkut dhe nga Gjykata Ekonomike. Në raste të rralla, ekziston edhe mundësia e ankimit në shkallë të dytë para Gjykatës Supreme për disa aktgjykime penale (p.sh., e drejta e ankesës para Gjykatës Supreme kundër aktgjykimeve të gjykatave të qarkut ndaj vendimeve të gjykatave komunale). LIGJIN MBI GJYKATAT E RREGULLTA neni 31; KPPP, nenet 25(1), 398-414.

Këto raste përfshijnë situatat kur gjykatat e qarkut shqiptojnë “burgimin afatgjatë,”⁹ ose vërtetojnë ato dënime të shqiptuara nga gjykatat komunale, ose kur gjykata e qarkut e kthen aktgjykimin lirues të gjykatës komunale dhe e zëvendëson me dënim, ose kur gjykata e qarkut e ka bazuar vendimin e vet duke vendosur në ankesë mbi gjendjen tjetër faktike se atë që e ka konstatuar gjykata komunale në aktgjykimin e parë. *Shih* KPPP neni 430. Varësisht nga lloji i kompetencës që e ushtron Gjykata Supreme për rastin konkret, ajo vendosë në kolegji prej 3 Ose 5 gjyqtarëve profesionistë ndërsa në mbledhjen e përgjithshme Gjykata Supreme vendosë mbi mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike. *Id.* neni 26; *shih gjithashtu* LIGJIN MBI PROCEDURËN KONTESTIMORE. nenet 44, 45.

Ligji i Kosovës në mënyrë specifike e adreson ankesën e bazuar në diskriminimin etnik. Korniza rregullative e sistemit të drejtësisë i trajton ankesat kundër vendimeve të gjykatave, që lëshohen si rezultat i “diskriminimit mbi bazën e përkatësisë së komunitetit” *Shih* KORNIZA RREGULLATIVE E SISTEMIT TË DREJTËSISË § 6. Personi që supozohet se ka qenë objekt vendimit diskriminues mund t'i bëjë kërkesë PSSP-së, që ta caktojë një trup gjykues (duke përfshirë një ose më shumë gjyqtarë ndërkombëtarë) për rishqyrtimin e atij vendimi. PSSP-ja do ta aprovojë kërkesën dhe caktojë trupin gjykues nëse gjen se ka “baza të arsyeshme për të besuar se vendimi është mbështetur në diskriminim”. *Shih* *Id.* Është e paqartë nëse këto dispozita kanë pasur sukses në ngritjen e besimit në sistemin gjyqësor nga pakicat etnike. Zyra e PSSP-së nuk ka pranuar asnjë kërkesë të këtij lloji dhe të anketuarit e intervistuar për këtë vlerësim, në përgjithësi nuk dinin për ekzistimin e kësaj dispozite. Asnjë fushatë informative për publikun nuk është organizuar me qëllim të informimit të popullatës për ekzistimin e këtij mjeti juridik.

Në praktikë, që nga viti 2001, vendimet gjyqësore janë ndryshuar vetëm përmes procedurës gjyqësore të ankimit. Në vitin 2006, ishin 2,882 aktgjykime civile (përafërsisht 26.11% e numrit të lëndëve) dhe 1,777 aktgjykime penale (18.4% e numrit të lëndëve), që ishin kundërshtuar me ankesë përmes gjykatave komunale tek gjykatat e qarkut. Nuk ka të dhëna se sa është përqindja e

⁸ Nëse miratohet, propozim ligji do ta riorganizojë procedurën e ankimit për gjyqësinë. Ligji parashikon krijimin e Gjykatës së Apelit ndaj të gjitha gjykatave të shkallës së parë. Një kolegji prej 3 gjyqtarësh i Gjykatës së Apelit do t'i shqyrtojë të gjitha këto raste, dhe vendimet e saj mund të rishqyrtohen nga Gjykata Supreme.

⁹ Burgimi afatgjatë përkufizohet si heqje lirie prej 21 -40 vjet, dhe mund të shqiptohet vetëm për veprat më të rënda penale të kryera me dashje, në rrethana veçanërisht rënduese, ose që shkaktojnë pasoja veçanërisht të rënda. *Shih* Kodin e përkohshëm penal neni 37 (*shpallur në fuqi* me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/25) (KPP).

ankesave pranë Gjykatës Supreme, ose nga gjykatat e kundërvajtjes tek Gjykata e lartë për kundërvajtje. Gjithashtu nuk dihet se cili është përpjesëtimi i lëndëve të gjykatave të qarkut në shkallë të dytë; e as mbi mesataren e kohëzgjatjes së zgjidhjes së ankesave në Gjykatën Supreme.

Të intervistuarit kanë raportuar për lëndë të grumbulluara në procedurën e ankimit veçanërisht në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë. Siç raportohet, vonesat janë shumë më të vogla në gjykatat e qarkut të Prizrenit dhe Gjilanit. Në fillimin e vitit 2007, ishin 224 lëndë penale me ankesë të papërfunduara në Gjykatën Supreme. Që nga fillimi i vitit 2007 dhe fundi i qershorit 2007, Gjykata Supreme ka pranuar 321 lëndë tjera penale me ankesë; dhe zgjidhur gjithsej 337 ankesa, duke e lënë numrin prej 208 ankesave të papërfunduara. Në mënyrë të ngjashme, Gjykata Supreme ka filluar vitin 2007 me 25 lëndë civile me ankesë, dhe deri më 30 qershor 2007 kishin mbetur vetëm 22 syresh pa u përfunduar.

Faktori 9: Mospërfilljet/Thirrjet/Ekzekutimet

Gjyqtarët kanë autorizime adekuate për thirrje, qortim për mospërfillje, ose për ekzekutim. Këto autorizime respektohen ose përkrahen nga degët tjera të pushtetit.

Konkluzioni	Korrelacioni: Negativ	Trendi: ↔
<p>Gjyqësia ka kompetenca adekuate për të thirrur një person të paraqitet në gjykatë apo edhe të konsiderojë një person për mospërfillje të gjykatës mirëpo gjyqtarët nuk i shfrytëzojnë gjithmonë këto kompetenca në mënyrë efektive. Gjithashtu, gjykatat janë të vetmet të autorizuara për ekzekutimin e aktgjykimeve; megjithatë vazhdojnë të ekzistojnë probleme serioze përkritazi me dështimin e zbatimit të aktgjykimeve gjyqësore civile dhe në një masë më të vogël edhe përkritazi me numrin e grumbulluar të lëndëve të ekzekutimit të sanksioneve penale. Pilot projektet e fundit janë duke përcaktuar modelet për ekzekutimin më efikas të aktgjykimeve civile.</p>		

Analiza/Sfondi:

Gjyqësia në Kosovë ka kompetenca për të thirrur në gjykatë dëshmitarë dhe të deklarojë palët e ndryshme se janë duke e mos përfillur gjykatën. Çdo person i thirrur si dëshmitar është i obliguar që të paraqitet në gjykatë dhe të jep dëshminë e tij në gjykatë me disa përjashtime të bazuara në dispozitat mbi dëshmitë (p.sh. vetë-inkriminimi). *Shih* KPPP nenet 158(3), 159-162. Kryetari i trupit gjykues përcakton nëse një dëshmitar mundet të refuzojë dëshminë e tij. LIGJI MBI PROCEDURËN KONTESTIMORE. nenet. 235, 238. Një dëshmitar i cili nuk paraqitet në gjykatë apo i cili dështon që të dëshmojë pas paraqitjes në gjykatë mund të detyrohet që të paraqitet në gjykatë, por dhe mund të gjobitet apo edhe të burgoset nëse nuk e bën këtë. *Shih. Id* nenet. 248, KPPK neni. 167. Ekspertët në cilësinë e dëshmitarit të cilët dështojnë që të paraqiten në gjykatë mund të detyrohen që ta bëjnë këtë nën rrethana të caktuara dhe kundër tyre mund të shqiptohet edhe gjoba për mosparaqitje në gjykatë. *Shih* KPPK neni 177; LIGJI MBI PROCEDURËN KONTESTIMORE neni 255. KPPP parashikon gjobat deri në 250 euro për mos paraqitjen e dëshmitarit. KPPP nenet 167, 177. Në procedurë civile gjykata mundet gjithashtu të urdhërojë që një palë në procedurë apo ndonjë palë e tretë të prezantojë një dokument që është në posedim të tij/saj brenda periudhës së specifikuar kohore. *Shih* LIGJIN MBI PROCEDURËN KONTESTIMORE neni 233. Gjykata mundet ta nxjerr aktgjykimin në mungesë nëse pala përgjegjëse në kontestin civil nuk paraqitet në seancë për të mohuar pretendimet në padi apo për të parashtruar kundërpërgjigje në padi. *Id* neni 332.

Dështimi i të pandehurve, avokatëve, dëshmitarëve, madje edhe prokurorët për tu paraqitur në seancë vazhdon të jetë një shkaktar kyç në vonesat e papranueshme në procedurat penale.

Shumë shpesh është i akuzuari i cili nuk është i pranishëm. Shumë prej këtyre individëve nuk jetojnë më Kosovë apo nuk jetojnë më në adresat e tyre të para luftës apo emrat e adresave kanë ndryshuar. Në një rast, të vëzhguar nga ekipi vlerësues, gjykata ka caktuar orarin e seancave të konfirmimit për muajin korrik duke pritur që shumë punëtorë që punojnë jashtë vendit të kthehen në Kosovë për pushime verore gjatë këtij muaji. Përkundër këtij fakti asnjëri nga të akuzuarit nuk është paraqitur. Një problem shtesë është edhe vështirësia në thirrjen e të pandehurve dhe dëshmitarëve nga enklavat etnike veçanërisht në Mitrovicën veriore. Problemet e sigurisë për personat që dorëzojnë fletëthirrjet në gjykatë, mungesa e bashkëpunimit nga policia dhe shërbimi postar dhe kërcënimet apo presionet mbi dëshmitarët apo familjet janë ende një pengesë e rëndësishme edhe pse në ulje e sipër. Palët e paditura kanë raportuar që gjyqtarët janë duke u mësuar që të përfitojnë nga pushteti që e kanë për të detyruar me forcë të pandehurit dhe dëshmitarët që të paraqiten në gjykatë mirëpo vetëm pas mosparaqitjes së dytë. Megjithatë, gjyqtarët siç raportohet hezitojnë të sanksionojnë dëshmitarët ekspertë për shkak se siç e kuptojnë ata këta të fundit shpeshherë dështojnë që të paraqiten në gjykatë për shkak se nuk paguhën nga gjykata.

Mosardhja e prokurorëve në gjykatë gjithashtu shkakton vonesa në gjykatat komunale. Një arsye për këtë mund të jetë mungesa e përshtatshmërisë gjeografike: prokurorëve publik caktohen kompetenca territoriale për gjykatat të qarkut dhe jo komunale, kështu që një prokuror mund të caktohet të punojë për territorin e disa gjykatave komunale. Norma e punës së prokurorëve është rritur kohëve të fundit duke e keqësuar problemin e prokurorëve në mungesë. Para nxjerrjes së KPPK-së në vitin 2003, prokurorët nuk kërkojnë që të jenë të pranishëm në të gjitha seancat e paraburgimit dhe të fazës së procedurës paraprake dhe kështu me nxjerrjen e KPPK-së është rritur norma e tyre e punës. KPPK-së gjithashtu ka transferuar përgjegjësinë për hetime nga gjyqtarët hetues tek prokurorët. *Shih* neni 46.1, 51 KPPK-së.

Avokatët gjithashtu kontribuojnë në vonesa qoftë me në mënyrë të qëllimshme ose duke dështuar në menaxhimin e kujdesshëm dhe vijimin e kalendarëve të caktuar të seancave. Vonimi i qëllimshëm i procedurave është i ndëshkueshëm me gjobë. *Shih* *Id* neni 146. Megjithatë, gjyqtarët shumë rrallë përdorin kompetencat për të sanksionuar avokatët. Të anketuarit kanë sugjeruar se shqiptimi i gjobave apo referimit të lëndëve në komitetin disiplinor të OAK-së për veprim të duhur kundër tyre jo vetëm që do të zhvendoste rastet mirëpo gjithashtu do të kishte edhe më shumë dobi në paralajmërimin e odës së avokatëve se vonesat nuk do të falen.

Prishja e rrjedhës së gjykimeve nëpërmjet të sjelljes së padisiplinuar mundet gjithashtu të jetë objekt i akuzave të drejtpërdrejta për mospërfillje të gjykatës nga ana e kryetarit të trupit gjykoës. *Shih* *Id* neni 335; *shih gjithashtu* nenin 317 të LIGJIT MBI PROCEDURËN KONTESTIMORE. Në përgjigje të mospërfilljes së gjykatës, gjyqtari mundet të nxjerrë një paralajmërim ose të largojë individin që prish rrjedhën e gjykimit dhe mundet të shqiptojë edhe gjobë kundër tij/saj deri në 1,000 euro KPPP neni 336(1); LIGJI MBI PROCEDURËN KONTESTIMORE neni 318. Gjyqtari mundet gjithashtu t'i mohojë avokatit mbrojtës të drejtën për të përfaqësuar klientin nëse avokati mbrojtës vazhdon të trazojë rrjedhën e gjykimit. Neni 336(3) i KPPK-së. Megjithatë, shkarkimi i avokatit mbrojtës mundet të jetë kundër produktiv, jo vetëm për shkak se ndërpritet procedura, por edhe mund të përfshijë zëvendësimin e tij me një avokat më pak të përgatitur dhe kështu ta vendos të akuzuarin në një pozitë të pafavorshme.

Gjyqësia ka pushtetin e plotë për të zbatuar vendimet civile dhe penale; megjithatë, procesi i zbatimit të vendimeve ka ngecur. Në të vërtetë, USAID ka raportuar se afër 33% të të gjitha lëndëve të papërfunduara në Kosovë ishin lëndë civile për ekzekutim. *Buletini informativ i USAID-it për aktivitetet e reformimit të sistemit të drejtësisë në Kosovë (mars 2007)*. Ekzekutimi i aktgjykimeve civile nuk bëhet në mënyrë automatike. Për ta ekzekutuar një aktgjykim civil, pala që fiton në kontest duhet të parashtrijë kërkesë për ekzekutimin e aktgjykimit gjyqësor pranë gjyqtarit që është përgjegjës për ekzekutimin e aktgjykimit. Gjykatat komunale mbikëqyrin ekzekutimin e aktgjykimeve të nxjerra nga gjykatat e qarkut dhe ato komunale. Gjyqësia gjithashtu mundet të mbikëqyrë ekzekutimin e aktgjykimeve administrative. LIGJI MBI PROCEDURËN PËRMBARIMORE, nenet 3, 16, GZ RSFJ. Nr. 20/1978 (LPP). Vendimet e nxjerra nga gjykatat e shkallës së parë

ekzekutohen nga një gjyqtar i vetëm përderisa vendimet që rezultojnë nga procedurat ankimore ekzekutohen nga kolegji i përbërë nga 3 gjyqtarë. *Id.* neni 7. Në të dyja raste, nëpunësit e gjykatës merren me procesin e ekzekutimit të aktgjykimeve pasi që këto aktgjykime të jenë nxjerrë.

Krahas seancave të ndara të gjykimit, LPP i cili daton mbrapa që para shtyrjes së Jugosllavisë, parashikon mbrojtje të mëtutjeshme gjyqësore për debitorët dhe mundëson shumë rrugë për debitorët që të kundërshtojnë gjatë procedurës gjyqësore. Nuk është për t'u befashuar se ky ligj përdoret dhe keqpërdoret nga debitorët me qëllim të shtyrjes së ekzekutimit. Si rezultat i kësaj, sistemi i ekzekutimit të aktgjykimeve civile vuan nga numri i madh i lëndëve të grumbulluara, ashtu si edhe mund të shihet në tabelën në vijim.

EKZEKUTIMI I AKTGJYKIMEVE CIVILE NGA GJYKATAT KOMUNALE, 2004-2006

Viti	Lëndët e reja të pranuar	Lëndët e zgjidhura	Lëndët në zgjidhje e sipër
2004	22,345	16,228	45,343
2005	11,969	12,615	44,655
2006	19,156	18,903	44,874

Shumë probleme në procesin e ekzekutimit të aktgjykimeve gjyqësore burojnë nga paaftësia e palëve që fitojnë kontestin që të fitojnë dëmshpërblimin nga palët humbëse që janë të varfra. Shpeshherë, debitorët nuk kanë mundësi të paguajnë detyrimet e tyre. Bizneset dhe individët nuk i mbajnë gjithmonë paratë në bankat kosovare duke e bërë kështu ekzekutimin e dëmshpërblimit më të vështirë. Lëndët e grumbulluara të kësaj natyre vetëm se i shtojnë këto probleme edhe më shumë.

Krahas aktgjykimeve të zakonshme civile, gjykatat e Kosovës janë të ngarkuara edhe me ekzekutimin e lëndëve të ashtuquajtura "dokumenti i besueshëm" siç është rasti me faturat e shërbimeve komunale. Lëndët e dokumentit të besueshëm kanë karakteristika thelbësore të qëndrueshmërisë ashtu që ato kanë të njëjtën vlerë si aktgjykim gjyqësor civil me qëllim të provimit të borxhit. Bartësit e dokumenteve të besueshme munden t'i qasen procesit të ekzekutimit pa aktgjykimin përkatës. Këto kategori të lëndëve përbëjnë shumicën e numrit të lëndëve për ekzekutim. Prandaj, 72% e lëndëve të ekzekutimit të aktgjykimeve në katër gjykatat pilot të cilat janë raportuar (ato në Prishtinë, Prizren, Gjiilan dhe Ferizaj) ishin lëndë të dokumenteve të besueshme. 80% e tyre kishin të bënin me faturat telefonike të papaguara dhe vetëm 6% prej tyre kishin vlerën më të vogël se 500 euro. *Buletini informativ i USAID-it për aktivitetet e reformimit të sistemit të drejtësisë 7-8.* Përpjesëtimi i lëndëve të dokumentit të besueshëm është më i lartë në mesin e lëndëve më të vjetra (dhe për këtë arsye të grumbulluara). Nga 28% të lëndëve tjera për ekzekutim, të cilat nuk ishin lëndë të dokumentit të besueshëm, më shumë se gjysma ishin lëndë civile për ekzekutim që kishin për objekt sigurimin e shpenzimeve të procedurës penale nga të dënuarit. Vlerat e këtyre lëndëve zakonisht ishin më pak se 100 euro. Disa gjykata kërkojnë të sigurojnë edhe gjobat nga procedura penale. Pjesa e mbetur e lëndëve përbëhet nga lëndët civile në të cilat pala private kërkon ekzekutimin e aktgjykimit civil.

Gjatë vitit të kaluar, Aktiviteti për Reformimin e Sistemit të Drejtësisë në Kosovë i USAID-së mbështeti një projekt pilot që kishte për qëllim zvogëlimin e lëndëve të grumbulluara në procedurën përmbartimore. Ky pilot program që nga atëherë është zgjeruar që të mbulojë 10 gjykata komunale. Projekti përfshinte identifikimin, klasifikimin dhe mbajtjen e evidencës për lëndët e pazgjidhura të përmbartimit të aktgjykimeve civile për të prodhuar një hartë të detajuar të procedurave ekzistuese gjyqësore dhe një plan të veprimit për zvogëlimin e numrit të lëndëve të grumbulluara. Plan i Aktivitetit për Reformimin e Sistemit të Drejtësisë në Kosovë i USAID-së për zvogëlimin e lëndëve të grumbulluara parashikon që lëndët e dokumenteve të besueshme të ndahen nga lëndët tjera të aktgjykimeve civile dhe disa nga gjykatat pilot kanë themeluar mekanizma nëpërmjet të cilave kreditorët e mëdhenj (shumicën e herëve ndërmarrjet publike shërbyese) të munden të marrin pjesë në mënyrë më aktive në monitorimin dhe përparimin e lëndëve të tyre. Për shembull, Gjykata

Komunale e Prizrenit ka nënshkruar një "memorandum të marrëveshjes me një ndërmarrje për bashkëpunim në mbledhjen e këtyre borxheve. Plani i gjykatës përfshin takimet javore ndërmjet të koordinatorit të gjykatës për ekzekutim dhe anëtarit të ndërmarrjes me qëllim të zgjidhjes së rasteve të vështira.

Sikurse në Prizren, gjykatat tjera kanë caktuar stafin e tyre për ta mbikëqyrur përmbarimin dhe që t'i përcjellin aktivitetet e zyrtarëve të trajnuar në terren. Formularët standard janë duke u hartuar për raportet që vijnë nga punëtorët e terrenit dhe për raportet nga ana e zyrtarëve përmbarimor si dhe formularët për kryetarët e trupit gjykues. Nuk ka pasur kohë të mjaftueshme për të vlerësuar nëse këto reforma shpijnë në zvogëlimin e numrit të grumbulluar të rasteve në tërë sistemin gjyqësor pa përfshirje të mëtutjeshme të donatorëve.

Ekziston gjithashtu legjislacioni që parashikon përmbarimin e aktgjykimeve penale. KPPK parashikon që sanksionet ekzekutohen menjëherë pasi që aktgjykimi gjyqësor të ketë marrë formën e prerë dhe se organi që ka nxjerrë atë aktgjykim duhet ta ekzekutojë aktgjykimin pa pasur nevojë të iniciojë ndonjë procedurë të posaçme të ekzekutimit të aktgjykimit gjyqësor. *Shih* neni 138 të KPPK-së. Nëse ngritën çfarëdo pyetje përkitazi me atë se çfarë duhet të jetë sanksioni i shqiptuar kundër palës e cila është shpallur fajtor dhe nëse pala fajtohet duhet të përfitojë nga vuajtja e periudhës kohore të kaluar në paraburgim, vendimi përfundimtar për këtë çështje merret nga kryetari i gjykatës që e ka shpallur aktgjykimin. *Id.* neni 139. KPPK gjithashtu parashikon nëse gjoba nuk mund të ekzekutohet madje edhe me forcë atëherë dispozitat e neni 39 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës [më tej KPP] (p.sh. pagesa me këste ose shërbimi në dobi të komunitetit) do të jenë të aplikueshme në këtë rast. KPPK neni 136. *Shih gjithashtu neni 39(3) të KPP-së.* Dispozitat për ekzekutimin e sanksioneve penale do të përcaktohen me legjislacion të posaçëm. Neni 135(4) i KPPK-së. *Shih gjithashtu edhe* LIGJIN MBI SANKSIONET PENALE [më tej LESP], shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/46.

Sikurse që është rasti me ekzekutimin e aktgjykimeve civile, ekziston një numër i lëndëve të grumbulluara përkitazi me ekzekutimin e aktgjykimeve penale. Këto zhvillime pasqyrohen në tabelën vijuese.

EKZEKUTIMI I AKTGJYKIMEVE PENALE, 2004-2006

Viti	Lëndët e reja të pranuar	Lëndët zgjidhura	Lëndët në pritje të vendimit
2004	1,782	1,043	1,808
2005	2,194	1,621	2,342
2006	2,726	2,354	2,686

Përderisa numri i lëndëve penale të pa ekzekutuara është shumë më i vogël se numri i lëndëve të pa përmbaruara civile, vonesat në ekzekutim janë duke u rritur dita ditës. Të anketuarit kanë raportuar se sikurse në rastin e lëshimit të fletëhirrjeve për gjyq, pamundësia për të gjetur të pandehurin është shpeshherë një pengesë e rëndësishme në ekzekutimin e aktgjykimeve penale.

III. Resurset Financiare

Faktori 10: Të Hyrat Buxhetore

Gjykatat kanë mundësi të ndikimit në sasinë e të hollave që i ndahen asaj nga dega e legjislativit ose ekzekutivit, dhe njëherë pasi t'i ndahen mjetet, gjyqësia mbanë kontroll mbi buxhetin e vet dhe për mënyrën se si shpenzohen ato.

Konkluzioni**Korrelacioni: Neutral****Trendi: ↑**

Përderisa gjyqësia nuk pranon fonde të mjaftueshme nga buxheti i Kosovës për të menaxhuar me sistemin efektiv të gjykatave, gjyqësisë kohëve të fundit i është dhënë më shumë kontroll në hartimin dhe menaxhimin e buxhetit të vet.

Analiza/Sfondi:

KGJK-ja mbikëqyr përgatitjen, menaxhimin dhe zbatimin e buxhetit të gjyqësisë dhe është përgjegjëse për monitorimin e shpenzimeve të mjeteve të ndara, si dhe për funksionet e kontabilitetit dhe auditimit.¹⁰ Në kryerjen e këtyre funksioneve KGJK-ja është e pavarur. *Shih* Rregulloren e KGJK-së § 9. Në menaxhimin e buxhetit, KGJK-ja bashkëpunon me vetë gjykatat nëpërmjet të kryetarëve të gjykatave; megjithatë, Rregullorja e KGJK-së nuk thotë asgjë përkitazi me atë se si një bashkëpunim i tillë është parashikuar që të ndodh. *Id.* § 9 Secili kryetar i gjykatës është përgjegjës për menaxhimin e buxhetit në gjykatën e tij/saj. LIGJI PËR GJYKATAT E RREGULLTA, neni 57.

Me qëllim të nxjerrjes së rekomandimeve për buxhetin e gjyqësisë dhe për shqyrtimin dhe dhënien e mendimit në buxhetin e propozuar, KGJK-ja e ka formuar "Komisionin për buxhet, financa dhe për burime njerëzore". Komisioni është krijuar që të hartojë rekomandime përkitazi me buxhetin e gjyqësisë dhe të rishikojë dhe ofrojë komente përkitazi me projekt buxhetin e propozuar. RREGULLORJA E BRENDSHME E KGJK, neni 10.10. Ky komision ka 6 anëtarë dhe kryetari i saj është gjyqtar ndërkombëtar. Komisioni në kuadër të stafit ka kontabilistë dhe profesionistë financiar, si dhe një këshilltar të UNMIK-ut dhe një përfaqësues nga Aktiviteti për Reformimin e Sistemit të Drejtësisë në Kosovë i USAID-së i cili kishte ofruar trajnim departamentit të buxhetit dhe financave. Pas mbledhjes, Komisioni duhet t'ia dorëzojë KGJK-së propozim buxhetin për miratim. Gjatë përgatitjes së buxhetit, komisioni e analizon numrin e tanishëm dhe të pritshëm të lëndëve, si dhe shpenzimet e vitit të kaluar. Megjithatë, të anketuarit kanë raportuar se përderisa komisioni ka vizituar të pesë gjykatat e qarkut për të identifikuar nevojat e tyre dhe përderisa kryetarët e gjykatave kanë pasur rast që të parashtrojnë kërkesat e tyre buxhetore, këto kërkesa nuk janë pasqyruar sa duhet në propozimin final të buxhetit aktual të miratuar nga KGJK-ja.

Përkundër bartjes së pushtetit nga KGJK-ja në KGJK, qeveria e Kosovës dhe UNMIK-u vazhdojnë të luajnë një rol aktiv në miratimin e buxhetit të gjyqësisë. Pasi që KGJK-ja ta aprovojë buxhetin e propozuar për gjyqësi, duhet që propozimin t'ia përcjellë Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave (MEF), e cila fillimisht miraton propozimin para se t'ia dërgojë Kuvendit të Kosovës për shqyrtim. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Kosovës, PSSP-ja shpall buxhetin. Me qëllim të mbajtjes së distancës sa më të madhe nga pushteti ekzekutiv, KGJK-ja duhet t'ia dorëzojë një kopje të buxhetit MD-së; megjithatë, buxheti nuk i përcillet drejtpërdrejtë MEF-it përmes MD-së. *Shih* RREGULLOREN E KGJK-SË § 9.5.

Buxheti i gjyqësorit gjatë viteve të fundit gradualisht ka shënuar rënie, për shkak të shkurtimeve të numrit të pozitive në gjyqësi. Sipas KGJK-së, buxheti i gjyqësisë për vitin 2006 euro është përafërsisht 1.5% e buxhetit të përgjithshëm të Kosovës prej 700,000,000 euro.

¹⁰ Kontrolli mbi buxhetin e prokurorisë ka kaluar tani në Ministrinë e Drejtësisë, ndërsa rrogat për gjyqtarët ndërkombëtarë dhe prokurorë kanë mbetur nën përgjegjësinë e DiD.

BUXHETI I GJYQËSISË: FONDET E KËRKUARA DHE FONDET E PRANUARA, 2004-2007 (NË EURO)

Viti	Fondet e kërkuara nga KGJK	Fondet e pranuar
2004	12,000,471	11,436,471
2005	12,390,364	12,182,580
2006	11,582,281	10,693,464
2007	10,196,024	9,126,782

Për momentin, buxheti i gjyqësisë përbëhet nga mjetet për pagat, mallrat dhe shërbimet dhe shpenzimet kapitale. Në bazë të letrës transmetuese nga Sekretariati i KGJK-së për Ministrinë e Financave, buxheti i ndarë për KGJK-në përbëhet nga 5,007,967 euro për të paguar pagat për 1731 pozita. Ekziston një pajtim uniform i të intervistuarve për nevojën e rritjes së pagave të gjyqësisë dhe rritjen e fondeve totale të kërkuara për vitin 2008 pasqyrojnë rritje të rëndësishme të planifikuara të pagës. *Shih* faktorin 11 më poshtë për detaje të mëtutjeshme. Nevoja për renovim dhe ndërtim të ndërtesave të gjykatave gjithashtu njihet si e rëndësishme. *Shih* Faktorin 12 më poshtë për një përshkrim të projekteve për përmirësimin e gjykatave në kërkesën më të fundit të buxhetit të gjyqësisë.

Në prill 2007, KGJK-ja ka nxjerrë "Planin strategjik për gjyqësinë e Kosovës, me 10 caqet e deklaruara për përmirësimin e gjykatave. Caku 3 ishte "të përcaktohen procedura dhe praktika efektive për menaxhimin financiar dhe buxhetor në dhe për gjykata". *Shih* PLANI STRATEGJIK PËR GJYQËSINË E KOSOVËS 2007-2012 (2007), KGJK. Me ndihmën e këshilltarit nga Aktiviteti për Reformimin e Sistemit të Drejtësisë në Kosovë të USAID-së, KGJK-ja kishte filluar që të punojë drejt realizimit të këtij qëllimi.

SHGJK-ja është gjithashtu duke bërë përpjekje që të luajë një rol të rëndësishëm në procesin buxhetor. Plani strategjik i SHGJK-së 2007-2009 numëron si problem që kontribuon në gjendjen e buxhetit të gjyqësisë edhe dështimin e gjykatave për të raportuar nevojat e tyre buxhetore si dhe mungesën e bashkëpunimit ndërmjet KGJK-së dhe gjykatave përkitazi me buxhetin e gjyqësisë. SHGJK, PLANI STRATEGJIK 2007-2009 në 9-10(2007). SHGJK-ja ka raportuar se është duke e përpiluar listën e nevojave të gjyqësisë me qëllim të adresimit të kësaj shkëputje në planifikimin buxhetor. Këto angazhime janë veçanërisht relevante duke marrë parasysh faktin se buxheti i gjyqësisë është zvogëluar gjatë disa viteve të fundit.

Bartja e kompetencave prej KGJK-së në KGJK ka pasur ndikim të mëtutjeshëm në ndryshimin e burimeve të të ardhurave për buxhetin e gjyqësisë. Para themelimit të KGJK-së, të ardhurat e fituara nga gjykatat (gjobat e trafikut, taksat gjyqësore) kanë shkuar në buxhetin e konsoliduar të Kosovës. Një marrëveshje e propozuar ndërmjet KGJK-së dhe MEF-it bën thirrje që KGJK-ja të pranojë 40 % të të hyrave të krijuara nga taksat gjyqësore në vitin 2008, përderisa MEF-it do t'i mbetet pjesa tjetër. Këto të hyra do të shfrytëzohen për pagesën e gjyqtarëve porotë, ekspertëve të gjykatës, dhe kompensimin e personave të dënuar pa bazë ligjore (në rastet kur nga buxheti i KGJK-së këto pagesa dhe kompensime nuk mund të realizohen). Duhet të përmendet se taksat gjyqësore ndryshojnë prej një gjykate në gjykatën tjetër dhe prej një rajoni në tjetrin. Janë bërë disa përpjekje që nga viti 2004 për ta përgatitur një tarifë uniforme të taksave; mirëpo ende nuk zbatuar.

Faktori 11: Mjaftueshmëria e Rrogave të Gjyqësorit

Rrogat e gjyqësisë kryesisht janë të mjaftueshme për të tërhequr dhe mbajtur gjyqtarë të kualifikuar, duke iu mundësuar atyre mbajtjen e familjeve të tyre dhe të jetojnë në një ambient të sigurt dhe pa pasur nevojë t'u drejtohen burimeve tjera të tërthura.

Përfundim	Korrelacioni: Negativ	Trendi: ↔
<p>Pagat e gjyqësisë vazhdojnë të jenë më të ulëta se pagat e zyrtarëve të lartë të degës së legjislativit dhe atij të ekzekutivit. KGJK-ja dhe SHGJK-ja kanë shprehur shqetësimin e tyre përkitazi me nevojën për të rritur pagat me qëllim të tërheqjes dhe mbajtjes së gjyqtarëve të kualifikuar. Përderisa pagat në gjyqësi janë në nivel të njëjtë me ato të prokurorëve të nivelit të njëjtë, puna në sektorin privat është parë si shumë më dobiprurëse se emërimet e tyre në gjyqësi.</p>		

Analiza/Sfondi:

Pagat e gjyqësisë mbeten tejet të ulëta që nga vlerësimi i parë i IRGJ-së i realizuar në vitin 2002. Ato janë të pamjaftueshme që t'i mundësojnë gjyqtarëve që të mbajnë familjet e tyre pa pasur nevojë që t'i drejtohen burimeve të tjera të tërthura. Pagat në gjyqësi nuk janë rritur që nga rritja për 5% në vitin 2002, dhe nuk ekzistojnë dispozita ligjore për t'i mbrojtur pagat në gjyqësi.

PAGAT E TANISHME NË GJYQËSI (NË EURO)

Niveli i gjykatës	Shkalla e pagave në gjyqësi	
	Gjyqtari	Kryetari
Gjykata Supreme	628	667
Gjykatat e qarkut	550	589
Gjykatat për kundërvajtje	393	446

Pas daljes në pension, gjyqtarët kanë të drejtë për pension në vetëm 40 euro në muaj. Pagat e ulëta në gjyqësi dhe pensionet janë veçanërisht problematike për shkak se kostoja e jetesës është rritur në mënyrë të konsiderueshme gjatë 5 viteve të fundit. Të anketuarit kanë raportuar se shumë gjyqtarë e lënë gjyqësinë pas shumë viteve të shërbimit për t'i hyrë avokaturës ku ata mund të fitojnë më shumë.

Pagat e gjyqtarëve janë shumë më të ulëta se ato të zyrtarëve të lartë të degës së ekzekutivit dhe kuvendit. Megjithatë, pagat e gjyqësisë janë shumë më të larta se pagat mesatare të punonjësve të sektorit privat dhe atij publik në Kosovë, të cilët fitojnë mesatarisht ndërmjet 190 dhe 211 euro në muaj. *Shih* KOSOVËN NË SHIFRA, ENTI STATISTIKOR I KOSOVËS, 2006 në 42. Gjyqtarët marrin mesatarisht të njëjtat paga sikurse edhe homologët e tyre në prokurori. Për shembull, prokurorët komunal marrin pagë mujore prej 472-551 euro përderisa prokurorët e qarkut marrin pagë mujore prej 550- 589 euros. Gjithashtu raportohet që gjyqtarët serb që i pranojnë pozitat në gjykatat paralele ose madje edhe në ato në Serbi marrin paga mesatare mujore në gjykatat komunale prej 800-1000 euro, apo 1200-1400 euro në gjykatat e qarkut. Gjyqtarët e Gjykatës Supreme të Serbisë marrin pagë mujore deri në 2000 euro. Si rrjedhojë e pagave të ulëta është vështirë që të tërhiqen studentët më të mirë dhe më të mençur të diplomuar në drejtësi, për ta zgjedhur karrierën në gjyqësi. Gjatë intervistimit të një grupi të studentëve nga ana e ekipit vlerësues për atë se a dëshirojnë të bëhen gjyqtarë, gati shumica janë përgjigjur negativisht. Në mesin e arsyeve të cekura për mosinteresimin e tyre janë edhe pagat e ulëta si dhe shqetësimet e sigurisë.

Plani strategjik i KGJK-së numëron pagat e ulëta të gjyqësisë si shqetësimin parësor i kombinuar me kushtet tjera të dobëta të punës siç janë objektet e vjetruara dhe joadekuate të gjykatave. Plani strategjik i KGJK-së në 9. Kërkesa për buxhet e KGJK-së për v. 2008-2010 spikat që nuk është e mundshme që të gjenden kuadro të duhura për gjyqësinë nëse pagat në gjyqësi nuk janë të njëjtit nivel me pagat në degën e legjislativit dhe ekzekutivit. Më tej, projekt buxheti i propozuar i KGJK-së për 2008-2010 parashikon rritje të rëndësishme të pagave për gjyqtarë. Projekt buxheti i paraqitur në tabelën vijuese, paraqet diagramin hierarkik për ndarjen e pagave për gjyqtarët e niveleve të ndryshme si përqindje e pagës së kryetarit të Gjykatës Supreme.

PAGAT E PROPOZUARA PËR GJYQËSI (NË EURO)

Niveli i gjykatës	Shkalla e propozuar e pagave për gjyqësi	
	Gjyqtari	Kryetari u gjykatës
Gjykata Supreme	1,800	2,000
Gjykatat e qarkut	1,500	1,700
Gjykatat komunale	1,200	1,300
Gjykatat për kundërvajtje	800	900
Gjykata e Lartë për Kundërvajtje	1,000	1,500
Gjykata Ekonomike	1,400	1,500

Plani strategjik i SHGJK-së ngjashëm ka bërë thirrje për ngritjen e pagave të gjyqtarëve. PLANI STRATEGJIK I SHGJK-SË F, 12. Gjyqtarët individual gjithashtu kanë përsëritur këto ankesa; ata i shohin pagat e tyre si pasqyrim i mungesës së respektit për gjyqësi.

Faktori 12: Ndërtesat (objektet) e Gjykatave

Ndërtesat e gjykatave janë të vendosura në vende të volitshme dhe të lehta për tu gjetur, dhe ofrojnë një ambient të respektueshëm për ndarjen e drejtësisë me një infrastrukturë adekuate.

<i>Konkluzioni</i>	<i>Korrelacioni: Negativ</i>	<i>Trendi: ↓</i>
<p>Ndërtesat e gjyqësisë janë të vendosura në vende të përshtatshme dhe janë lehtë për t'u gjetur; megjithatë prishjet e shumta dhe turmat në gjykatë shpeshherë i bëjnë ato joadekuate dhe mund të shprijnë në mungesën e transparencës dhe efikasitetit në procedurat gjyqësore.</p>		

Analiza/Sfondi:

Shumica e ndërtesave të gjyqësorit janë të vendosura në lokacione të përshtatshme dhe janë lehtë për t'u gjetur. Megjithatë, përderisa numri i tanishëm dhe kushtet në ndërtesat e gjykatave dhe vetë gjykatoret nuk janë keqësuar në mënyrë të dukshme që nga IRGJ Kosovë i vitit 2004, kushtet e rënda në objektet e gjykatave kanë penguar implementimin e përmirësimeve sistemore, siç është prezantimi i audio incizimeve për mbajtjen e procesverbalit fjalë për fjalë. Gjer më tani, sistemet e incizimit janë instaluar në disa gjykatore. *Shih* diskutimin në faktorin 25 më poshtë. Ekzistojnë gjithashtu raporte se objekteve të gjykatave në përgjithësi u mungojnë objekte private për avokatë të cilët takohen me klientët e tyre. Gjendja është veçanërisht shqetësuese për një numër të anketuarve të cilët kishin raportuar se mungesa e hapësirës kishte rezultuar që takimet ndërmjet të avokatëve dhe klientëve të mbahen nëpër korridore, nëpër prokurori, apo në zyrat e gjykatësve (ndonjëherë madje edhe në praninë e gjyqtarit apo prokurorit).

Siç është cekur në IRGJ-në për Kosovë 2004, shumica e ndërtesave të gjykatave nuk kanë numër të mjaftueshëm të sallave të gjykimeve. Kjo gjendje nuk ka ndryshuar gjatë viteve të fundit dhe në ndërkohë numri i grumbulluar i lëndëve ka vazhduar të rritet. Kufizimet e hapësirës kanë rezultuar gjithashtu në faktin që gjyqtarët janë detyruar të mbajnë procedurat gjyqësore në zyrat e tyre. Kjo ka efekte negative në qasjen e publikut në procedurat e tilla, siç janë diskutuar në më shumë detaje në faktorin 23 më poshtë. Kushtet në disa qytete kanë posaçërisht nevojë për përmirësime. Për shembull, ndërtesa e gjykatës në veri të Mitrovicës është shtëpi për gjykatën e qarkut, atë komunale dhe atë për kundërvajtje e cila ka vetëm katër salla të gjykimit dhe që shfrytëzohet nga 15 gjyqtarë. Raportohet gjithashtu se ndërtesat e gjykatave të Prishtinës janë të tej-mbushura me njerëz, veçanërisht në gjykatën komunale, të kundërvajtjes dhe në Gjykatën Supreme. Kështu, Gjykata Komunale në Prishtinë ka 28 gjyqtar dhe shërben pjesën më të madhe të popullatës se sa cilado gjykatë tjetër dhe ka vetëm një sallë të gjykimit dhe atë të mirëmbajtur dobët. Në Prishtinë, gjyqtarët duhet nënshkruhen për rezervimin e sallave të gjykimit në një tabelë në zyrën e administratorit; atyre u jepet leja për shfrytëzimin e sallave të gjykimit me metodën kush e rezervon i pari e merr. Përderisa Gjykata e Qarkut në Prizren ka një sallë të gjykimit tejet bashkëkohore me pajisje audio dhe video dhe dy salla tjera adekuate të gjykimit, Gjykata Komunale e Prizrenit nuk ka hapësirë të shfrytëzueshme dhe duhet t'i shfrytëzojë tri salla të gjykimit të gjykatës së qarkut. Ekipi vlerësuar ka pranuar edhe raporte mbi turmat e mëdha të njerëzve në objektet e gjykatës në Gjilan. UNMIK-u ka sugjeruar kohëve të fundit se gjykatat mobile mund të shfrytëzohen për përmirësimin e numrit të madh me njerëz në këto raste.

KGJK-ja pranon nevojën e renovimit dhe ndërtimit të objekteve të reja gjyqësore. Projekt buxheti i KGJK-së 2008-2010 parashikon një numër të projekteve të tilla, të cilat nëse do të jetësoheshin do ta përmirësonin në masë të madhe gjendjen në gjykatat e Kosovës. Këto projekte përfshijnë ndërtimin e objekteve të reja për Gjykatën Komunale në Prishtinë, Gjykatën për Kundërvajtje dhe Gjykatën e Qarkut si dhe ndërtimin e objekteve të reja për Gjykatën Ekonomike dhe KGJK-në¹¹. Kostoja e këtyre projekteve të propozuara do të arrijë shumën e përgjithshme prej 4.6 milion euro ndërmjet vitit 2008 dhe 2010. Projekt buxheti i KGJK-së 2008-2010 gjithashtu ndan mjete shtesë për renovimin e Gjykatës Komunale dhe asaj për Kundërvajtje në Vushtri si dhe Gjykatës së Qarkut dhe asaj Komunale në Pejë dhe në fund Gjykatës Komunale në Istog.

Faktori 13: Siguria e Gjyqësorit

Resurse të mjaftueshme janë ndarë për të mbrojtur gjyqtarët nga kërcënimet, sulmet dhe vrasjet.

Konkluzioni	Korrelacioni: Neutral	Trendi: ↔
Ndërtesat e gjykatave janë të siguruara mirë mirëpo nuk janë ndarë burime për të siguruar sigurinë fizike të gjyqtarëve jashtë gjykatoreve. Përderisa rekomandimet janë bërë për të shtuar sigurinë, këto rekomandime ende nuk janë implementuar ende në mënyrë të plotë.		

¹¹ Toka për ndërtesat e reja të gjykatës në Prishtinë veç i është ndarë Kuvendit Komunal të Prishtinës; megjithatë, mbetet nën kontrollin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit dhe ende nuk dhënë leja për shfrytëzim nga gjyqësia.

Analiza/Sfondi:

Përderisa legjislativi adreson sigurinë në objektet e gjykatës, nuk ekziston ndonjë legjislativ i cili në mënyrë të veçantë adreson ofrimin e sigurisë për gjyqtarët individual qoftë brenda ose jashtë objekteve të gjykatave. Me ligj, komisioni i KGJK-së për administrimin e gjykatave e ka për detyrë të zhvillojë dhe rekomandojë politikën e KGJK-së për sigurinë e gjykatave. *Shih RREGULLAT E BRENDSHME TË KGJK-SË § 10.8.* Krahas kësaj, Ligji për gjykatat e rregullta lejon (mirëpo nuk kërkon) gjykatat që të punësojnë roje të sigurisë për të mbrojtur "lokalet, pasurinë dhe personat" si dhe të mbajë rendin në objektin e gjykatës. *LIGJI MBI GJYKATAT E RREGULLTA neni 104.*

Qasja në ndërtesat e gjykatave është e kufizuar në tërë Kosovën. Disa ndërtesa të gjykatave përdorin detektorët e metaleve dhe në përgjithësi individët që kërkojnë të hyjnë në ndërtesën e gjykatës kërkojnë që të prezantojnë letërnjoftimin dhe të përballen me kontrollim të hollësishëm nga ana e rojeve të sigurisë. Kjo është veçanërisht e vërtetë sa i përket Gjykatës Supreme, ku vizitorët duhet të lënë letërnjoftimin me rojet e sigurisë dhe kërkojnë që t'ju tregojnë rojeve të sigurisë se çfarë kërkojnë në ndërtesën e gjykatës. Përderisa kjo mund të mos jetë në pajtim të plotë me atmosferën e hapur e cila ushqen transparencë, një kujdes i tillë duket të jetë i domosdoshëm së paku derisa gjendja në Kosovë të jetë stabilizuar.

Posa vizitori të ketë hyrë në ndërtesën e gjykatës, ai/ajo në përgjithësi është i lirë të lëviz në ndërtesën e gjykatës pa përcjellje. Shumë të anketuar nuk janë të brengosur për sigurinë e tyre brenda ndërtesës së gjykatës. Megjithatë, gati shumica e gjyqtarëve të intervistuar nga ekipi vlerësues kishin pranuar kërcënime personale dhe disa prej tyre kishin qenë madje edhe objekt i rrahjeve apo krimit kundër pasurisë së tyre. Incidentet munden të ndodhin në objektet e gjykatës, gjatë udhëtimit me autobus, në rrugë, me telefon, dhe mund të vënë në cak gjyqtarin apo anëtarin e familjes së gjyqtarit. Të intervistuarit raportuan se këto kërcënime dhe dhuna kishin qenë në përgjithësi në domenin e Shërbimit Policor të Kosovës. Sidoqoftë, disa gjyqtarë kishin shprehur dëshirën për transportim të sigurt për në dhe nga gjykata dhe disa prej tyre mendonin se do të ishte e këshillueshme për të punësuar trupat e sigurisë.

Në veçanti, gjendja në Mitrovicën veriore kishte krijuar probleme të mëdha përkitazi me sigurinë e gjyqësisë. Problemet e sigurisë janë rritur përderisa paqartësia ishte rritur përkitazi me pavarësinë dhe statusin e ardhshëm të Kosovës. Gjyqtarët dhe stafi i gjykatës të cilët udhëtojnë prej shtëpive të tyre në Mitrovicën jugore transportohen në dhe nga gjykata në veriun e Mitrovicës me autobusin e rezervuar për këtë qëllim. Deri në pranverë të vitit 2007, ekzistonte financim i mjaftueshëm që rojet e sigurisë në gjykatat e Mitrovicës të punojnë dy ndërrime në ditë. Për këtë arsye, ndërtesa mbyllet në baza ditore në orën 3:00 pasdite duke parandaluar përfundimin e ditës së plotë të punës. Në pranverë të vitit 2007, kryetari i gjykatës ishte në gjendje të negociojë financimin për ndërrimin e tretë mirëpo që nga ajo kohë dy roje e kanë lëshuar punën dhe gjykata i është kthyer punës me orar të shkurtuar. DAGj, KGJK-ja dhe MD-ja janë informuar për gjendjen mirëpo nuk ka pasur përgjigje që nga hartimi i këtij vlerësimi. Në gjykatoren e Mitrovicës veriore pas orarit të punës kishte ndodhur deri te disa hyrje me dhunë në këtë ndërtesë. Në një incident të vitit 2004, hyrësit me dhunë u përpoqën që të vjedhin disa kompjuterë nga gjykatorja dhe ndezën një zjarr në gjykatore para se të arrestohen nga policia. Në vitin 2006, roja e gjykatës intervenoi në një tentim hyrje me dhunë në gjykatore. Gjithashtu u raportua edhe një incident tjetër ku një mjet eksploziv u hodh në veturën e gjyqtarit; mirëpo gjyqtari nuk u lëndua. Fatmirësisht asnjë gjyqtar nuk është vrarë në Mitrovicën veriore që nga viti 2000.

Gjyqtarët gjithashtu kanë raportuar shqetësime për sigurinë e dëshmitarëve dhe siguria shpeshherë citohet si arsye për dështimin e dëshmitarëve që t'ju përgjigjen fletëthirrjeve për paraqitje në gjykatë. Gjykata e Qarkut në Prizren ka adresuar këtë problem nëpërmjet të përmirësimeve teknologjike: tani ekziston salla e gjykimit e pajisur me sisteme të video dhe audio incizimit dhe monitorë të rrafshët për shikim të dëshmitarëve së bashku me një zonë në kuadër të sallës së gjykimit të rrethuar me pasqyra që nuk shikohen nga ana e përparme për mbrojtjen e dëshmitarëve të rrezikuar. Dëshmitari në këtë zonë nuk mundet të shihet nga salla e gjykimit,

mirëpo dëshmitari mundet të gjendet në një lokacion tjetër ku zëri i tij apo saj (shpeshherë i ndryshuar në mënyrë digjitale) transmetohet në sallën e gjyqimit.

Këshilltari i sigurisë ka rekomanduar se kamerat e qarkut të mbyllur dhe sistemet radio duhet të instalohen në ndërtesat e gjykatave të Kosovës. Sipas kësaj, financimi për sistemet e tilla është përfshirë në kërkesën për buxhet të vitit 2008. Pritet që në fillim të vitit 2008, KGJK-ja do të instalojë kamerat e qarkut të mbyllur në të gjitha gjykatat e Kosovës duke filluar nga Gjykata Supreme.

IV. Masat Mbrojtëse Strukturore

Faktori 14: Mandati i garantuar

Gjyqtarët e lartë emërohen për kohë të pacaktuar që ofron mandat të garantuar dhe të mbrojtur deri në moshën për pension ose deri në skadim të mandatit afatgjatë.

Konkluzioni	Korrelacioni: Neutral	Trendi: ↔
Mandati gjyqësor për momentin është i lidhur me kohëzgjatjen e administratës së UNMIK-ut. Procedura për rrimërimin e gjyqtarëve pas largimit të UNMIK-ut është miratuar parimisht por ende nuk hyrë në funksion. Për këtë arsye, paqartësia përkitazi me sigurinë e vendit të punës ka gjasë të rritet me afrimin e largimit të UNMIK-ut nga Kosova.		

Analiza/Sfondi:

Ekziston një shkallë e lartë e paqartësisë përkitazi me mandatin e gjyqtarëve kosovar. Fillimisht, UNMIK-u u kishte caktuar mandatin gjyqtarëve për një mandat me mundësi zgjatje prej 3-, 6- apo 9-të muaj e cila gjë ishte në pushtetin diskrecional të PSSP-së. Në dhjetor 2001, pas rekomandimeve të KGJK-së, mandatet gjyqësore ishin zgjatuar deri në përfundim të administratës së UNMIK-ut. Prandaj, mandati i të gjithë gjyqtarëve të tanishëm është i lidhur me kohëzgjatjen e mandatit të UNMIK-ut, me sjelljen e mirë dhe pensionimin e detyrueshëm në moshën 65 vjeçare. Në atë kohë, të gjithë gjyqtarët do t'i nënshtrohen një vlerësimi të caktuar dhe gjithëpërfshirës për rrimërim për mandat të përhershëm, proces ky të cilin parashikohet të kryhet nga KPGJP (organi autonom i KGJK-së). *Shih* RREGULLORJA PËR KORNIZËN E SISTEMIT TË DREJTËSISË § 7; DIREKTIVËN E KPGJP-SË § 1.1. *Shih gjithashtu* faktorin 2 për më shumë hollësi lidhur me procesin e propozuar për rrimërim. Themelimi i KPGJP-së pritët të fillojë në maj të vitit 2007; mirëpo, nënshkrimi i memorandumit të mirëkuptimit është shtyrë deri në pafund.

Kur të përfundojë themelimi i KPGJP-së, fillimisht do të përbëhet nga 5 anëtar ndërkombëtar; mirëpo, përderisa anëtarë të ri nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve të Kosovës shqyrtohen nga KPGJP dhe emërohen nga KGJK, atëherë kontrolli vendor dhe përbërja numerike e KPGJP-së do të rritet gradualisht. *Shih* DIREKTIVËN E KPGJP-SË § 1.4, 7.2-7.4. Procesi i rrimërimin do të organizohet në 3 faza të njëpasnjëshme. Faza e parë do përfshijë të gjitha pozitat për Gjykatën Supreme, faza e dytë do të jetë zgjedhja e gjyqtarëve për Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje, gjykatat e qarkut dhe për Gjykatën Ekonomike, dhe faza e fundit do të shtrihet për gjyqtarët e gjykatave komunale dhe të kundërvajtjes. *Id.* § 2.3. Gjatë secilës fazë, të gjitha pozitat gjyqësore nëpër nivelet e caktuara gjyqësore do të shpallen publikisht, dhe të gjithë gjyqtarët në detyrë, si dhe profesionistët tjerë ligjor të cilët i plotësojnë kushtet minimale për emërim në gjyqësi do ta gëzojnë të drejtën e konkurrimit. *Id.* § 2.1, 2.4. Kandidatët e jashtëm kërkohet ta kenë të dhënë provimin pranues për gjyqësi; mirëpo gjyqtarët në detyrë, me disa përjashtime, në përgjithësi do të

përrjashtohen nga ky kusht. *Id.* § 2.4, 2.6.3, 3.4. Krahas kësaj të gjithë kandidatët, pa përjashtim, do të kërkohet ta kenë të dhënë provimin për kodin e etikës profesionale. *Id.* § 2.6.4. Të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret KPGJP-ja do të shfrytëzojnë kriteret të njëjta dhe pyetje të standardizuara për intervistë. *Id.* § 2.6.1-2.6.2, 3.1. Pas rizgjedhjes, gjyqtarët do të emërohen deri në pensionim e obliguar të moshës 65 vjeçare (dhe varësisht nga dispozitave disiplinore të parashikuara me ligj). *Id.* § 1.1. Kandidatët të cilët nuk janë zgjedhur për emërim, do të kenë mundësi të paraqesin kërkesën për rishqyrtim para KPGJP-së, për të treguar se vendimi i KPGJP-së ka qenë i bazuar në të gabime faktike ose mangësi, ose se ndërkohë është siguruar informata e re, dhe e cila do të kishte pasur ndikim në vendimin e KPGJP-së po të kishte qenë në dispozicion gjatë shqyrtimit të parë. *Id.* § 6. Mandati i gjyqtarëve në detyrë të cilët nuk janë riemëruar do të përfundojë me fillimin e detyrës nga gjyqtarët e rinj të emëruar në pozitat gjegjëse. *Id.* § 2.11.

Edhe pse gjyqtarët janë të shqetësuar për mungesën e qartësisë së mandatit të tyre apo riemërimit të tyre pas përfundimit të mandatit të UNMIK-ut, duhet të ceket se nuk ekzistojnë raporte se rivlerësimi pasues i gjyqtarëve ka ngritur frikë për mundësi të shkarkimeve me motive politike. Në të vërtetë, nuk ekzistojnë dëshmi se skadimi i mandateve gjyqësore që po afrohet ka vendosur kufizime në pavarësinë e vendim-marrjes gjyqësore. Disa të anketuar e shikojnë në mënyrë të favorshme gjasën e procesit të riemërimit për shkak se procesi i verifikimit mundet të largojë nga loja gjyqtarët që për momentin janë në detyrë të cilët kanë aftësi të diskutueshme.

Faktori 15: Kriteret Objektive për Avancim në Gjyqësi

Gjyqtarët avancohen në sistemin gjyqësor bazuar në kriteret objektive siç janë, zotësia, integriteti dhe përvoja.

Konkluzioni	Korrelacioni: Negativ	Trendi: ↓
Kriteret e avancimit gjyqësor nuk janë të parashikuara në mënyrë specifike me ligj apo ndonjë rregullore. Që nga krijimi i KGJK-së, nuk është e qartë nëse vlerësimet gjyqësore të cilat janë kryer më parë nga ana e KGJPK-së kanë pushtet ligjor për të informuar vendimet e PSSP-së përkitazi me avancimet në detyrë.		

Analiza/Sfondi:

Rregullorja e KGJPK-së i jepte pushtet KGJPK-së për t'i ofruar rekomandime PSSP-së për vazhdimin e shërbimit dhe avancimit të gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë të cilët më parë kishin qenë të punësuar në gjyqësi. Këto rekomandime bazoheshin në përmbushjen e vazhdueshme të kushteve të kualifikimit për emërim. *Shih* RREGULLOREN E KGJPK-SË § 5.4, 6.1. Pas shqyrtimit të rekomandimeve të KGJPK-së, PSSP-ja ishte përgjegjës për marrjen e vendimit përfundimtar përkitazi me vazhdimin e shërbimit dhe avancimin e gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë. *Shih në përgjithësi*, UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR. 2001/17, për zbatimin e RREGULLORES PËR KGJPK-NË]. Udhëzimi mbi vlerësimin gjyqësor parashikonte një sistem të detajuar të vlerësimit me dy nivele. Vlerësimet ishin kryer me qëllim të këshillimit të PSSP-së për avancimin në detyrë dhe për zgjatjen e emërimeve. Kryetarët e gjykatave vlerësonin gjyqtarët që shërbenin në gjykatat e tyre, ku kryetarët e gjykatave të shkallës më të lartë vlerësonin kryetarët e gjykatave të shkallës më të ulët. Vlerësimi fillestar përfshin mbajtjen e një interviste dhe një formular në të cilin gjyqtari mundet të bëjë komentet e tij/saj. Vlerësimi dhe komentet dorëzoheshin nga vlerësuesi përfundimtar i cili nën rrethana të caktuara mundet të kërkojë mendimin e palës së tretë e cila ka më shumë njohuri në këtë drejtim. Vlerësuesi përfundimtar vërtetonte apo modifikonte vlerësimin fillestar dhe më pastaj i dorëzonte formularin përfundimtar gjyqtarit dhe KGJPK-së. *Shih në përgjithësi* *Id.* § 1.

Në vitin 2005, KGJK-ja e kishte zëvendësuar KGJPK-në ndërsa Rregullorja e KGJK-së e kishte shfuqizuar Rregulloren për KGJPK-në. Përderisa Rregullorja e KGJK-së i delegon KGJK-së përgjegjësinë për vlerësimin, avancimin në detyrë dhe transferimin e gjyqtarëve, gjyqtarëve porotë dhe personelit gjyqësor, ajo nuk përmban me të cilat specifikohet zhvillimi i cilësdo prej këtyre procedurave. *Shih RREGULLOREN E KGJK-SË § 1.4(c)*. Të anketuarit raportuan se që nga fillimi i mandatit të KGJK-së, disa konkurse për vende të lira pune dhe për mundësi avancimi ishin shpallur publikisht, për të tjerat mund të plotësohen nga KGJK-ja në konsultim me kryetarët e gjykatave dhe gjyqtarët. Kjo rezultoi në një kuptim të përgjithshëm se avancimi në gjyqësi është i ndërlidhur ngushtë me lidhjet dhe miqësinë më shumë se sa me përvojën dhe zotësinë.

Faktori 16: Imuniteti i Gjyqtarëve për Veprimet Zyrtare

Gjyqtarët kanë imunitet për veprimet e kryera me detyrë zyrtare.

Konkluzioni	Korrelacioni: Neutral	Trendi: ↔
<p>Për momentin, imuniteti gjyqësor është shumë i kufizuar dhe as legjislacioni i tanishëm dhe as ai që është në hartim e sipër nuk adreson çështjen se në çfarë raste duhet hequr imuniteti i gjyqtarit. Përkundër mungesës së qartësisë, të anketuarit nuk raportuan raste të ndjekjes penale të gjyqtarëve për aktivitetet e tyre të zhvilluara deri sa kanë qenë në detyrë.</p>		

Analiza/Sfondi:

Ligji ende në fuqi i vitit 1977 për gjykatat e rregullta parashikon një imunitet të kufizuar civil duke theksuar që “një gjyqtar...nuk mundet të thirret në përgjegjësi për shkak të mendimit të dhënë në marrjen e vendimit gjyqësor.” *Shih LIGJIN PËR GJYKATAT E RREGULLTA neni 11*. Ky ligj gjithashtu përcakton se gjykatësit nuk mundin të paraburgosen në procedura që kanë të bëjnë me veprat penale të kryera nga ta gjatë kryerjes së detyrës zyrtare pa miratimin e kuvendit i cili i ka emëruar ata. *Id.* Megjithatë, kuvendi të cilit ligji i referohet nuk ekziston më dhe ligjet e kohëve të fundit ofrojnë pak udhëzime përkitazi me çështjen e imunitetit gjyqësor. Korniza Kushtetuese nuk flet asgjë për këtë çështje dhe nuk ekzistojnë rregullore relevante të UNMIK-ut në këtë temë¹².

Ngjashëm, KPPK-ja nuk përmend në mënyrë specifike imunitetin gjyqësor. Megjithatë, KPP-ja parashikon sanksione kundër gjyqtarëve profesionistë dhe atyre porotë të cilët nxjerrin vendime të paligjshme me qëllim të përfitimit material apo me qëllim të shkakimit të dëmit personit tjetër, duke parashikuar dënime me burgim të cilat sillen prej 6 muaj deri në 5 vjet. *Shih KPP*, neni 346. Gjithashtu, më tutje parashikohen disa vepra penale të kryera nga “personat zyrtar”¹³ siç është shpërdorimi i pozitës zyrtare, mashtrimi apo rryshfeti. *Shih në përgjithësi Id 339-351*. Gjithashtu “kryerja e veprës penale apo kryerja e kundërvajtjes e cila është në mospajtim me detyrën e gjyqtarit apo gjyqtarit porotë për mbajtjen e standardeve të larta të integritetit moral dhe etik”, paraqet shkelje disiplinore. *Shih DIREKTIVËN ADMINISTRATIVE NR. 2006/8, PËR ZBATIMIN E RREGULLORES MBI KGJK-NË § 5 (MË TUTJE DIREKTIVA PËR DISIPLINËN GJYQËSORE)*; Gjyqtari ndaj të cilit është ngritur aktakuza menjëherë duhet ta njoftojë KGJK-në mbi këtë fakt dhe “të ndërpresë dhe pushoj të gjitha funksionet e tij/saj”, kur më pas KGJK-ja do të vendosë nëse aktakuza imponon edhe pezullimin e gjyqtarit deri në përfundimin e procedurës penale dhe gjykimit. *Id.* § 3.1, 3.5. Nëse më pas gjyqtari dënohet, KGJK-ja duhet menjëherë ta vlerësojë dënimin për të përcaktuar nëse duhet t'i

¹² Nëse miratohet, projekt ligji do të parashikojë për gjyqtarët imunitetin civil dhe penal nga përgjegjësia për dëmet ose veprat që rezultojnë nga ushtrimi i ligjshëm i detyrës zyrtare. Megjithatë, gjyqtarët nuk do të gëzojnë imunitet përkitazi me aktivitetet të cilat i kryejnë jashtë fushëveprimit të pozitës së tyre zyrtare. Projekt ligji nuk do të ofrojë ndonjë sqarim se kur apo si duhet hequr imuniteti

¹³ Gjyqtari është “person zyrtar” sipas KPP-së neni 107(1).

rekomandojë PSSP-së shkarkimin e gjyqtarit nga detyra. *Id.* § 3.10. Madje edhe nëse gjyqtari lirohet nga vepra penale, ai/ajo mund t'i nënshtrohet edhe më tej procedurës disiplinore dhe të merr dënimin disiplinor për shkeljen përkatëse. *Id.* § 3.11. *Shih gjithashtu* diskutimin në faktorin 17 për më shumë hollësi lidhur me shkarkimin nga detyra dhe disiplinimin e gjyqtarëve.

Përkundër mungesës së udhëzimit specifik legjislativ përkitazi me imunitetin gjyqësor, ekipit vlerësues nuk i është bërë me dije për rastet kur gjyqtarët janë ndjekur penalisht apo kur kanë qenë objekt i padive civile për shkak të marrjes së vendimeve jo të kënaqshme. Nuk janë dhënë gjithashtu kurrfarë raportime për rastet kur gjyqtarët janë mbajtur përgjegjës për kryerjen e veprave gjatë kryerjes së detyrës së tyre zyrtare. Ngjashëm, asnjëri nga gjyqtarët e intervistuar për këtë vlerësim nuk kishte shprehur shqetësimet për mungesën e tyre të imunitetit.

Faktori 17: Shkarkimi dhe Disiplina për Gjyqtarë

Gjyqtarët mund të shkarkohen nga detyra ose të ndëshkohen vetëm për sjellje të konsideruara si të pahijshme dhe përmes një procesi transparent dhe të udhëhequr nga kriteret objektive

<i>Konkluzioni</i>	<i>Korrelacioni: Neutral</i>	<i>Trendi: ↔</i>
KGJK bën shkarkimin gjyqësor dhe kryen procedurat disiplinore rregullisht dhe sipas një procedure të themeluar mirë dhe transparente. Kriteret për disiplinim të gjyqtarëve janë vendosur me ligj, ndonëse asnjë nga këto kriteret e as masat disiplinore të shqiptuara për shkeljen e këtyre ligjeve nuk janë përshkruar në detaje në asnjë ligj.		

Analiza/Sfondi:

Aktualisht, përgjegjësia disiplinore ndahet në mes të KGJK-së dhe Njësisë për Inspektim Gjyqësor pranë DD-së së UNMIK-ut (NJIGJ). Kjo e fundit mbikëqyrë hetimet dhe bën ndjekjen sipas ankesave kundër gjyqtarëve.¹⁴ *Shih* URDHËRESËN ADMINISTRATIVE NR. 2001/4, për zbatimin e RREGULLORES SË UNMIK-UT NO. 2000/15 MBI THEMELIMIN E DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV TË DREJTËSISË § 2.1(c), 2.2 (në tekstin e mëtuftjeshëm URDHËRESA PËR NJIGJ); *shih gjithashtu* RREGULLOREN E KGJPK-SË § 7.3; DIREKTIVA PËR DISIPLINËN GJYQËSORE § 5.1. KGJK (dhe para KGJK-së – KGJPK-ja) ka përgjegjësinë kryesore për zhvillimin e dëgjimeve disiplinore dhe shqiptimin e sanksioneve, edhe pse rekomandimet për shkarkim duhet të miratohen nga PSSP-ja. *Shih* RREGULLOREN E KGJK-SË § 7.1, 7.4, 7.7. Krahas Rregullores mbi KGJK-në dhe Direktivës për disiplinë gjyqësore, NJIGJ e ka nxjerrë edhe doracakun dhe rregullat e hollësishme procedurale dhe komentaret (doracaku i NJIGJ-së), ku gjyqtarët njoftohen mbi ato që duhet pritur gjatë procesit të hetimeve.

KGJK mbikëqyr procedurën disiplinore të shkallës së parë përmes Komisionit gjyqësor disiplinor (më tutje KGJD). RREGULLORJA E KGJK-SË § 7.1; RREGULLAT E BRENDSHME TË KGJK-SË § 10.4. KGJD përbëhet nga tre anëtarë, përfshirë edhe nënkryetarin e KGJK-së dhe dy anëtarët tjerë të KGJK-së të cilët shërbejnë për mandat njëvjeçar. *Id.* § 7.2. Së paku dy prej anëtarëve të KGJD-së duhet të jenë gjyqtarë, dhe nuk mund të emërohet asnjë prokuror në KGJD. DIREKTIVA PËR DISIPLINËN GJYQËSORE § 1.2. Aktualisht anëtarësia e KGJD-së është në përbërje të, një gjyqtari serb, një gjyqtari shqiptar dhe një gjyqtari ndërkombëtar.

¹⁴ Nëse miratohet Projektligji do të transferojë mbikëqyrjen e NJIGJ-it nga DD-ja në MD. Janë shprehur brengat lidhur me atë se vendosja e NJIGJ-it brenda MD-së do të mund të krijojë rast për ndërhyrje të gjerë të degës së ekzekutivit në veprimtarinë e gjyqësorit.

Procedura disiplinore ndaj gjyqtarit mund të iniciohet me ankesë të paraqitur në NJIGJ nga individit ose organizata, si dhe nga vetë NJIGJ ose KGJK-ja duke vepruar sipas detyrës zyrtare *Id.* § 2.1. Të gjitha ankesat pavarësisht prej burimit të tyre u referohen NJIGJ-it për hetim. NJIGJ heton të gjitha supozimet potenciale duke shqyrtuar gjykatën relevante dhe dosjen e lëndës, mbledhjen e dokumenteve, marrjen në pyetje të dëshmitarëve, dhe marrjen e përgjigjes nga gjyqtari në fjalë. *Shih* DORACAKUN E NJIGJ KREU C.5. Pas hetimeve, NJIGJ-i mund t'i mbyllë ato raste të cilat i konsideron si mendjelehta, abuzive dhe përndryshe të pabazuara, dhe mund të paraqesë akuza formale në KGJD në lidhje me ato raste që i konsideron të merituar për ndjekje. Në rastin e fundit, një kopje e vendimit të NJIGJ, pretendimet dhe dokumentet përcjellës duhet t'i sigurohen gjyqtarit. DIREKTIVA PËR DISIPLINËN GJYQËSORE § 2.3. Krahas kësaj, PSSP mund ta suspendojë përkohësisht gjyqtarin deri në marrjen e vendimit të plotfuqishëm, "nëse konsiderohet se përndryshe do të dëmtohet besimi i publikut në gjyqësi". *Id.* § 4.1. Megjithatë sipas raportimeve suspendime të tilla ndodhin shumë rrallë. Në fakt, të anketuarit kanë raportuar se disa gjyqtarë kanë vazhduar të shërbejnë gjatë vazhimit të hetimeve ndaj tyre për akuza të shumëfishta lidhur me shkelje të rënda, deri atëherë sa çështja është zgjidhur në nivel të KGJK-së.

Pasi ngritjes së akuzave nga NJIGJ-i për një rast në KGJD, NJIGJ-i e paraqet ndjekjen në një dëgjim pranë KGJD-së. *Id.* § 5.1. Direktiva për disiplinë gjyqësore përmban procedurat e detajuara për një dëgjim të tillë. Seanca disiplinore para KGJD-së duhet të mbahet brenda 30 ditëve nga data e njoftimit nga NJIGJ. *Id.* § 2.5. Gjatë paraqitjes së ndjekjes, gjyqtari i akuzuar ka të drejtë në avokat dhe ka qasje të plotë në gjithë dosjen disiplinore. Gjyqtari i akuzuar mund të thërrasë dëshmitarë dhe të japë argumente gjatë procedurave pranë KGJD-së, të njëjtën gjë mund ta bëjë edhe NJIGJ-i. *Id.* § 2.6, 5.1-5.2. Direktiva për disiplinë gjyqësore gjithashtu parasheh edhe bazat e përgjithshme për sjellje të pahijshme, ku përfshihen: kryerja e veprës penale; lërja pas dore e detyrave gjyqësore; dështimi për të vepruar në mënyrë të pavarur dhe të paanshme; mosrespektimi e vendimeve apo urdhrave të KGJK-së; dhënia e informatave të rrejshme ose jo të plota KGJK-së në lidhje me, caktimin, promovimin apo disiplinimin; dhe "çdo shkelje e kodit përkatës të etikës." *Id.* § 5.3. Përveç kësaj liste të shkurtër të bazave për sjellje të pahijshme, nuk ka udhëzime të metutjeshme në asnjë prej ligjeve në fuqi, se si KGJK duhet të përcaktojë saktësisht se cilat veprime përbëjnë sjellje të pahijshme.

Pas argumenteve gojore, KGJD shqyrton rastin në seancë të mbyllur, dhe pastaj duhet ta nxjerrë "vendimin me shkrim të arsyetuar lidhur me akuzat" brenda 30 ditëve nga data e mbajtjes së seancës. *Id.* § 5.5. Kur KGJD gjen se gjyqtari është fajtor për shkelje, mund ta shqiptoj cilindo prej sanksioneve në vijim: qortimin; qortimin me vërejtje; pezullimin pa pagesë nga detyra për deri në 6 muaj; dhe t'i rekomandoj PSSP-së shkarkimin nga detyra. RREGULLORJA E KGJK-së § 7.5. Çdo sanksion i shqiptuar duhet të jetë në përpjesëtim me peshën e shkeljes së vërtetuar. DIREKTIVA PËR DISIPLINËN GJYQËSORE § 6.2(e). Gjyqtari apo NJIGJ-i mund të ankohen ndaj këtij vendimi dhe këtë ta bëjë në KGJK-në, i cili do ta vërtetoj, ndryshoj, anulojë apo kthejë vendimin e KGJD-së. *Shih* RREGULLORJA E KGJK-së § 7.6; DIREKTIVA PËR DISIPLINËN GJYQËSORE § 6.1, 9; RREGULLOREN E BRENDSHME TË KGJK-SË § 12. KGJK do ta marrë vendimin e vet në bazë të shkresave të lëndës përveç nëse njëra nga palët nga kjo lëndë kërkon dëgjim gojor. DIREKTIVA PËR DISIPLINËN GJYQËSORE § 8.5-8.6; RREGULLORJA E BRENDSHME E KGJK-SË § 12.5-12.6. Sikur edhe me rastin e vendimeve të KGJD-së, vendimet e KGJK-së mbi ankesat duhet të bëhen me shkrim dhe vendimi i arsyetuar. DIREKTIVA PËR DISIPLINËN GJYQËSORE § 9.2; RREGULLORJA E BRENDSHME E KGJK-SË § 12.10(b).

KGJK-ja duhet ta mbajë një regjistër publik të vendimeve të KGJD-së dhe KGJK-së, dhe me emrin e gjyqtarit të hequr nëse sanksioni i shqiptuar është tjetër nga rekomandimi për shkarkim. DIREKTIVA PËR DISIPLINËN GJYQËSORE § 11. Edhe NJIGJ i ka siguruar ekipit vlerësues statistika në lidhje me ankesat që i ka hetuar. Këto statistika kanë treguar se që nga fillimi i veprimtarisë së tyre në vitin 2001, NJIGJ-i ka pranuar gjithsej 1,921 ankesa. Nga ky numër, i ka refuzuar 757 ankesa, në 593 ankesa të hetuara nuk është gjetur asnjë shkelje dhe 73 nga 1,921 ankesa i janë përcjellë drejtpërsëdrejti KGJK-së, përderisa 211 tjera janë kompletuar dhe pritjet që t'i referohen KGJK-së. 287 ankesat e mbetura janë ende nën hetime.

Një gjyqtar i intervistuar nga ekipi vlerësues raportoi që publiku kryesisht i sheh procedurat e KGJK-së si transparente dhe të drejta. Sipas tij, gjyqtarët e akuzuar lejohen që të përfaqësohen nga avokati, dhe dëgjimet e tyre janë të hapura dhe publike. Pas dënimit, gjyqtarëve u jepet aktgjykimi me shkrim. Megjithatë, mbetet një numër i madh i shqetësimeve lidhur me procesin e disiplinës gjyqësore. Në KGJPK, dëgjimet disiplinore gjyqësore ishin të hapura për publikun, dhe objekt i autorizimeve të këshillit për të kufizuar pjesëmarrjen e palëve “kur kjo ishte në interes të drejtësisë.” RREGULLORJA E KGJPK-së § 7.9. Mirëpo as Direktiva për disiplinën gjyqësore e as Rregullorja e KGJK-së nuk përmbajnë kufizime të tilla të qasjes në seancat disiplinore. Krahas kësaj, shkarkimi i gjyqtarit nga detyra mund të shndërrohet në proces të gjatë. Në rastet kur është rekomanduar shkarkimi i përhershëm, shqyrtimi nga PSSP mund të merr kohë shumë të gjatë, pasi që vendimet duhet të shqyrtohen edhe nga një zyrtar i Kombeve të Bashkuara në Nju Jork. Brenga tjera janë raportuar edhe lidhur marrëdhëniet midis NJIGJ dhe UNMIK-ut. NJIGJ vepron në pajtim me rregulloren e UNMIK-ut, prandaj është e paqartë se çfarë do të ndodhë pas largimit të UNMIK-ut nga Kosova. Pasi të largohet UNMIK-u, është e paqartë nëse NJIGJ do të veprojë si një organ i pavarur, ose nën mbikëqyrjen e KGJK-së apo MD-së.

Faktori 18: Caktimi i Lëndëve

Gjyqtarëve ju caktohen lëndët përmes metodës objektive siç është shorti apo bazuar në fushën e tyre të ekspertizës dhe mund t’ju merret lënda vetëm për një arsye të fortë, siç është konflikti i interesave apo norma e madhe dhe jo e duhur e punës.

Konkluzioni	Korrelacioni: Negativ	Trendi: ↔
Nuk ekziston metodë objektive e caktimit të rasteve të gjyqtarët vendor dhe ndërkombëtar. Kryetarët e gjykatave kryesisht caktojnë rastet sipas renditjes numerike apo dosjeve, përderisa vazhdojnë të përdorin diskrecionin e tyre në caktimin dhe përzgjedhjen e gjyqtarëve porotë për gjykime.		

Analiza/Sfondi:

Metodat e caktimit të rasteve dallojnë nga gjykata në gjykatë, dhe nuk ka garanci legjislative që rastet do të caktohen në mënyrë objektive. Procedurat lidhur me caktimin e rasteve janë të parapara në “Rregullat e veprimtarisë së brendshme të gjykatave të vitit 1981”, të shpallura në bazë të Ligjit mbi Gjykatat e Rregullta. Rregullat nuk delegojnë në mënyrë specifike mbikëqyrjen caktimit të lëndëve të kryetarët e gjykatave. Në vend të kësaj, ato e caktojnë shefin e zyrës së nëpunësve si personin e ngarkuar për caktimin e dokumenteve të pranuar zyrtare, duke përfshirë lëndët e reja. RREGULLAT PËR VEPRIMTARI TË BRENDSHME TË GJYKATAVE, GZ e Kosovës nr. 7/81. neni 167 (më tutje RREGULLAT E BRENDSHME TË GJYKATAVE). Zyra e nëpunësit pastaj dorëzon rastin të gjyqtari “kompetent” apo kolegji “kompetent” i gjyqtarëve. Rregullat e brendshme të gjykatave nuk përmbajnë asnjë referencë rreth caktimit të lëndëve të gjyqtarët specifik; as Rregullorja e KGJK-së nuk përmban një referencë të tillë. Mirëpo, Kodi i etikës për gjyqtarë përmban një rregull e cila thotë se caktimi i lëndëve nuk duhet të ndikohet nga dëshirat e palëve ose personave tjerë të interesuar; për ta mundësuar këtë, sistemi i caktimit të lëndëve duhet të “bazohet në tërheqjen me short, ndarjen automatike sipas alfabetit, ose me ndonjë sistem të ngjashëm”. KODI I ETIKËS PËR GJYQTARË § III(B)(5).

Rregullat e brendshme të gjykatave janë të qarta në garantimin e autorizimit për kryetarët e gjykatave për të dëgjuar dhe vendosur përkitazi me kërkesat për përjashtimin e gjyqtarëve nga lëndët. *Id* neni 175. Në lëndët penale, kryetarët e gjykatave kanë autorizim për të përjashtuar

gjyqtarët nga rastet me kërkesë të ndonjërës palë, në bazë të konfliktit të interesit, njëanshmërisë, apo pjesëmarrjes në dëgjimin e atij rasti në një fazë të mëhershme. *Shih* RREGULLAT E BRENDSHME TË GJYKATAVE neni 175; *shih gjithashtu KPPPK nenin 40*. Kryetarët e gjykatave gjithashtu mund t'i rindajnë lëndët bazuar në ngarkesën e madhe të punës. Krahas kësaj gjyqtarët janë të obliguar ta përjashtojnë veten nga lënda në të cilën mund të shkelë normat mbi konfliktin e interesave ose dispozitat tjera të Kodit të etikës gjyqësore. *Shih* KODI I ETIKËS PËR GJYQTARË § III(A)(3)(C).

Në praktikë kryetarët në shumicën e gjykatave i ndajnë lëndët të gjyqtarët sipas sistemit të numërimit. Secili rast e merr nga një numër sipas renditjes së regjistrimit, dhe ai numër korrespondon me gjyqtarin. Kur të gjithë gjyqtarëve u caktohen rastet, numri fillon prapë prej fillimit. Në njërin gjykatë të anketuarit raportuan që sistemi i caktimit të rasteve civile përfshinte caktimin e numrit 0-9 për secilin gjyqtar, dhe pastaj rastet caktoheshin për gjyqtarët në bazë të shifrës së fundit të secilit numër të regjistrimit të rastit të ri. Kryetari i një gjykate pranoi se as ai vetë nuk e di se kush është caktuar në cilin rast, ndonëse ai pranojë që ekspertiza e gjyqtarëve të caktuar merren në konsideratë gjatë këtij procesi. Disa të anketuar u ankuan që nëpunësit e regjistrimit dhe kryetarët e gjykatave nuk i caktojnë gjyqtarët në rastet e dorëzuara rishtazi sepse ka shumë raste të vjetra në pritje dhe këto raste të vjetra kanë prioritet. Me sa duket, nuk është pazakonshme që rastet civile të mos i caktohen asnjë gjyqtari për gati një vit. Mirëpo në këto raste nuk përfshihen çështjet e procedurës paraprake dhe seancat e marrëveshjeve.

Disa ndryshime që janë bërë së voni mund të rezultojnë në përmirësim të efikasitetit të procesit të caktimit të rasteve. Që kur KGJK ka shpallur standardet e reja kohore, të cilat bëjnë matjen e zgjidhjes së rasteve që nga koha e regjistrimit të dosjes, rastet penale po caktohen në kohë të duhur, e posaçërisht rastet kur i akuzuari është në paraburgim. QARKORJA E KGJK-SË PËR GJYQËSORIN NR 2006/1 PËR IMPLEMENTIMIN E STANDARDEVE KOSORE NË GJYKATAT E QARKUT DHE ATO KOMUNALE [në tekstin e mëtutjeshëm QARKORJA KGJK-SË PËR STANDARDET KOHORE]. Për shembull, ekzistojnë disa raporte që thonë se në Gjykatën e Qarkut në Prizren janë caktuar të gjitha rastet penale. Një zhvillim tjetër pozitiv ka qenë paraqitja e sistemit informativ për menaxhimin e rasteve, projekt ky i financuar nga AER-i me synim të automatizimit, ne mes tjerash edhe regjistrimin e rasteve. *Shih* diskutimin në faktorin 28 më poshtë për më shumë hollësi.

Rregullorja për Caktimin e Gjyqtarëve Ndërkombëtar, e cila kontrollon caktimin e rasteve gjyqtarëve ndërkombëtar, gjithashtu nuk garanton objektivitet në caktimin e rasteve gjyqtarëve ndërkombëtar. Në cilëndo fazë të procedurës penale, prokurori, i pandehuri apo avokati mund t'i paraqesin kërkesën DD-së për të kërkuar caktimin e gjyqtarëve ndërkombëtar. Edhe DD mund të bëjë edhe vetë një kërkesë të tillë. DD do të caktojë gjyqtarët ndërkombëtar pas miratimit nga PSSP-ja, kur një caktim i tillë "konsiderohet i nevojshëm për të siguruar pavarësinë dhe paanësinë e gjyqësorit apo administrimin e drejtë të drejtësisë." RREGULLORJA PËR ÇAKTIMIN E GJYQTARËVE NDËRKOMBËTAR § 1.1. Në rastet e tilla, lëndët t'i transferohen kolegjit prej tre gjyqtarëve që në përbërje ka dy gjyqtarë ndërkombëtar dhe një gjyqtar vendor kur transferimi është i nevojshëm për të siguruar paanësi. Të anketuarit shprehën brengat e tyre që kjo metodë e caktimit të rasteve të gjyqtarëve ndërkombëtar nuk i plotëson standardet e pranuar të transparencës.

Faktori 19: Shoqatat e Gjyqtarëve

Shoqata, qëllimi i vetëm i së cilës është të mbrohen dhe promovohen interesat e gjyqësisë, ekziston dhe është aktive.

Konkluzioni	Korrelacioni: Neutral	Trendi: ←
Shoqata gjyqësore, SHGJK, ekziston për të mbrojtur dhe promovuar interesat e gjyqësorit dhe gjyqtarëve. SHGJK ka vazhduar të rrisë veprimtarinë e saj; mirëpo, nuk është plotësisht transparente, dhe ende nuk ka qenë e suksesshme posaçërisht të ndikojë në ndryshimet në gjyqësi.		

Analiza/Sfondi:

SHGJK është themeluar në maj të vitit 2001 si organizatë joqeveritare e gjyqtarëve aktivë në Kosovë. Objektivat kryesore të SHGJK-së janë, kontributi drejt zhvillimit të strukturës juridike e cila do ta mbështesë pavarësinë e gjykatave, si dhe të promovojë interesat e gjyqtarëve. Iniciativa për sundimin e ligjit – *Vlerësimi organizativ i Shoqatës së Gjyqtarëve të Kosovës në f. 30 (2007)* (më tutje Vlerësimi organizativ i SHGJK-së). SHGJK e ka një bord drejtues prej 9-të anëtarëve, i cili përbëhet prej gjyqtarëve të cilët përfaqësojnë të gjitha nivelet e gjyqësisë dhe të gjitha rajonet e Kosovës. *Id.* Një pozitë në bordin drejtues të SHGJK-së është e rezervuar për një gjyqtarë të komunitetit serb, dhe një tjetër nga për bashkësinë ndërkombëtare. *Id.* Ekzistojnë pesë degë rajonale të SHGJK-së secila me delegatët e saj të cilët përzgjedhin anëtarët e bordit drejtues për një mandat katërvjeçar. *Id.* Secila degë ka anëtarësinë, takimet dhe kuvendin e vet. Ndonëse anëtarësimi është vullnetar, pothuajse të gjithë gjyqtarët janë anëtarë të SHGJK-së. Ndonëse pagesa e anëtarësisë është 2.5 euro në muaj, të anketuarit raportuan se ata do të paguanin edhe më shumë, posaçërisht nëse SHGJK-ja do të avokonte për ta. Duke pasur para sysh të hyrat e vogla të cilat grumbullohen nga pagesa e anëtarësisë, shumica e veprimtarive të SHGJK-së financohen përmes kontributeve të donatorëve, siç janë, Fondacioni për Shoqëri të Hapur dhe USAID-i.

SHGJK ka themeluar një sërë komisionesh në baza *ad hoc*, të cilat adresojnë çështjet siç është mbledhja e fondeve, burimet njerëzore, komisione për çështje disiplinore dhe arsimim të vazhdueshëm. Ekzistojnë edhe komisione të së drejtës administrative, civile dhe penale me ekspertë të cilët mund të hartojnë ligje dhe të japin komente për to. SHGJK ka organizuar një sërë veprimtarish për zhvillim profesional në bashkëpunim me IGJK-në edhe në mënyrë të mëvetësishme; për shembull në dhjetor të vitit 2006 ka mbajtur një punëtori lidhur me avokimin dhe ndërtimin e koalicioneve. Përmes deklaratave në shtyp në shumicën e gazetave kryesore ditore në Kosovë, ka bërë veprimtari të avokimit lidhur me caktimet (terminët) gjyqësore, trajnimin e personelit gjyqësor, përmirësimin e kushteve të punës, dhe sigurinë e gjyqtarëve. Gjithashtu ka punuar edhe në projekte për të drejtat e njeriut në bashkëpunim me Komitetin e Finlandës për të Drejtat e Njeriut dhe Komitetin e Kryqit të Kuq Ndërkombëtar.

SHGJK ka marrë pjesë në një numër të veprimtarive tjera në mbështetje të gjyqësorit. Përmes një granti nga Fondacioni për Shoqëri të Hapur, SHGJK ka filluar formimin e bibliotekës së sajë profesionale. Ajo gjithashtu ka implementuar Programin për Praktikant Gjyqësorë me mbështetje nga Iniciativa ROL dhe USAID-in (Iniciativa ROL dhe USAID kanë siguruar bursa për praktikantët të cilët punojnë nëpër gjykata). SHGJK publikon një buletin falas çdo tre muaj për të gjithë anëtarët e SHGJK-së dhe partnerët. Në bashkëpunim me OAK-në dhe e ndihmuar nga Iniciativa ROL, SHGJK gjithashtu ka implementuar një sërë tryezash të rrumbullakëta me gjyqtarë dhe avokatë për të diskutuar çështjet që janë shqetësuese si për avokatë ashtu edhe për gjyqtarët. Këto tryeza

janë mbajtur në vitin 2005 në të gjitha pesë rajonet e Kosovës. *Id. f. 13.* SHGJK gjithashtu angazhohet në përpjekjet për luftimin e korrupsionit në emër të gjyqësisë dhe me asistencën e USAID-it, së fundi e ka iniciuar Qendrën e resurseve dhe të trajnimit për avokim, që ka mbajtur tryeza të rrumbullakëta mbi çështjet e luftimit të korrupsionit anekënd Kosovës gjatë vitit 2007.

Pas një punëtorie treditore në fund të vitit 2006, SHGJK ka zhvilluar një plan të ri strategjik trevjeçar. Ky plan përcakton misionin e organizatës, dhe identifikon problemet që kanë të bëjnë me legjislacionin për gjyqësinë, ngarkesën e lëndëve, financat, zhvillimin profesional, sigurinë dhe korrupsionin. Plani i prekë këto probleme, rekomandon zgjidhjet dhe teknikat për zgjidhjen e problemeve.

Përkundër, përparimit të dukshëm të SHGJK-së në dy vitet e fundit, për sa i përket kapaciteteve organizative, shumë të anketuar ndjeheshin që organizata nuk ka qenë transparente sa duhet, dhe prandaj shumica e gjyqtarëve nuk kishin marrë pjesë sepse nuk e kishin ditur se me çka merret kjo organizatë. Të anketuarit gjithashtu raportuan se dëshirojnë që SHGJK-ja të përfshihet më tepër në avokim lidhur me çështjet që i brengosin gjyqtarët, siç janë pagat dhe pensionet e tyre. Është interesante se SHGJK ka qenë e dekurajuar që të angazhohet në diskutimet lidhur me propozim ligjin për gjykatat, dhe përveç faktit se njëri nga anëtarët e SHGJK-së bën pjesë në komisionin për buxhet dhe financa të KGJK-së, SHGJK-ja nuk ka dhënë kontribut në buxhetin e dorëzuar nga KGJK-ja për vitin 2008-2010. Një projekt-vlerësim organizativ i SHGJK-së i cili u bë nga Iniciativa ROL në maj të vitit 2007, gjithashtu vuri në pah ndjenjat e të anketuarve të intervistuar nga ekipi vlerësues: gjyqtarët dëshirojnë të shohin SHGJK-në të jetë më aktive në angazhimet për lobim dhe avokim. *Id. f. 29.*

V. Llogaridhënia dhe Transparenca

Faktori 20: Vendimet Gjyqësore dhe Ndikimi i Pavend

Vendimet gjyqësore bazohen vetëm në fakte dhe ligj pa ndonjë ndikim të pavend nga gjyqtarët më të lartë (p.sh kryetarët e gjykatave), interesat private, apo degët tjera të pushtetit shtetëror.

Konkluzioni	Korrelacioni: Negativ	Trendi: ↔
<p>Gjyqësori nuk i nënshtrohet ndonjë presioni të dukshëm nga jashtë nga interesat politike apo degët tjera të pushtetit. Megjithatë, ai mbetet i objekt i presioneve nga interesat private dhe janë të përhapura raportet mbi korrupsionin dhe aktgjykimet e motivuara etnikisht. Presioni mbi gjyqtarët rëndohet edhe më tepër nga pagat e ulëta në tërë gjyqësorin, siguria e dobët, kushtet e dobëta të punës dhe norma tejet e madhe lëndëve.</p>		

Analiza/Sfondi:

Korniza Kushtetuese e konfirmon pavarësinë dhe paanësinë e gjyqësorit, sikur edhe dokumentet ndërkombëtare të cilat i inkorporon ajo përmes referimit në to. KORNIZA KUSHTETUESE § 9.4, 9.6. Ligji mbi gjykatat e rregullta thotë që gjykatat janë të pavarura dhe duhet të marrin vendime të bazuara në ligj. LIGJI MBI GJYKATAT E RREGULLTA neni 6. *Shih gjithashtu* KPPPK neni 8 LIGJI MBI PROCEDURËN KONTESTIMORE neni 7. Në mënyrë të ngjashme Kodi i etikës gjyqësore kërkon që gjyqtarët të veprojnë në mënyrë të paanshme dhe të pavarur dhe të kryejnë detyrat e tyre “pa ndonjë ndikim nga jashtë.” Gjyqtarë duhet t’i shmangen çdo veprimi që qon në mëdyshje paanësinë ose pavarësinë e tyre. KODI I ETIKËS GJYQËSORE § I(2)(d). Ata kërkohet që të kryejnë detyrat gjyqësore në bazë të fakteve dhe ligjit të aplikueshëm, pa ndonjë kufizim të drejtpërdrejtë

ose tërthortë, ndikim të pavend, nxitje, presion, ose kërcënime për ndërhyrje. *Id.* § II(A)(3)(a). Ky Kod gjithashtu kërkon nga gjyqtarët që t'i shmangen konfliktit të interesave (të bazuara në marrëdhënie familjare, sociale, financiare ose profesionale), dhe ta përjashtojnë veten nga rastet kur pjesëmarrja e tyre mund të jetë në kundërshtim me normat e konfliktit të interesave. *Id.* § II(A)(3)(b)(c).

Gjyqtarët e intervistuar nga ekipi i vlerësimit vazhdimisht kanë mohuar të jenë nën presion nga gjyqtarët më të lartë, politikanët, ministrat, apo përfaqësuesit e Kuvendit, sa i përket vendimarrjes në raste. Në vend të kësaj shumë prej tyre pranuan se janë nën presion nga burimet private. Disa nga të anketuarit, raportuan se presioni i tillë, duke qenë gjithnjë prezent është rritur posaçërisht që nga trazirat në marsit të vitit 2004. Presioni i tillë mund të vijë nga familja dhe shokët, apo nga fqinjët dhe komuniteti, posaçërisht në komunat më të vogla apo enklavat e pakicave. Në fakt, një gjyqtar nga një komunë serbe vërtetoi se ishte më lehtë për të që të jetë më objektiv në gjykimin e rasteve për shkak se nuk jetonte në atë komunitet.

Presioni shtesë nga interesat private vjen nga fakti që gjyqtarët e kanë vështirë të mbështesin familjet e tyre me pagat e tyre të dobëta. Freedom House (Shtëpia e Lirisë) ka raportuar se korrupsioni mbetet shumë i përhapur në qeverinë e Kosovës, duke përfshirë këtu edhe gjyqësinë. *Shih* Freedom House, *Kombet në Tranzicion* (2007); Demokratizimi prej Evropës Qendrore në Euro-Azi, në 352, qershor 2007. Sipas një prokurori të intervistuar për qëllim të raportit të Freedom House-it, korrupsioni në gjyqësi është rezultat i ngarkesës së tepërt të punës së gjyqtarëve dhe personelit të gjykatave, ambientit të pafavorshëm të punës, pagave të ulëta, sigurisë së dobët dhe përpjekjeve të pakta për monitorimin e korrupsionit. *Id.* në 366. Si rezultat i kësaj, ekziston perceptim i gjerë publik se pavarësia e gjyqësorit është komprometuar. Për shembull, një i intervistuar nga ekipi vlerësues, e ka përshkruar një rast të kohës së fundit, të një përdhunimi të supozuar të një gruaje të përkatësisë serbe, ku i akuzuari (një mashkull shqiptar) ishte shfajësuar përkundër dëshmisë së AND-së që e lidhte atë me krimin. Është sugjeruar hapur që konsideratat tjera në vend të fakteve dhe ligjit - siç është njëanshmëria racore - duhet të kenë qar në shfajësimin e bërë në këtë rast.

Presioni i jashtëm në gjyqësi mund të marrë formën e kërcënimeve të drejtpërdrejta apo të tërthorta (p.sh thirrjet telefonike, letrat, prezenca në gjykatore, apo kërcënimi dhe dhuna). Gjasat për një presion të tillë, posaçërisht në rastet e përfshirjes në krime të luftës apo diskriminimit etnik, ishin motivimi kryesor për nxjerrjen e Rregullores për Caktimin e Gjyqtarëve Ndërkombëtar, në lidhje me pjesëmarrjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtar në procedurat e caktuara gjyqësore. Kjo rregullore lejon prokurorin, të akuzuarin dhe avokatin e tij/saj që të bëjë kërkesë për caktimin e një gjyqtari ndërkombëtar kur një gjë e tillë konsiderohet e nevojshme për të siguruar pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit. *Shih* RREGULLOREN PËR CAKTIMIN E GJYQTARËVE NDËRKOMBËTAR § 1.1.

Së fundi, disa organizata kanë filluar të adresojnë çështjen e korrupsionit dhe ndikimin e pavend në gjyqësi. Iniciativa ROL ka lancuar shpalljet e shërbimit publik në vitin 2007, me qëllim të ngritjes së vetëdijes së publikut lidhur me procesin gjyqësor dhe rëndësinë e sjelljes etike nga anëtarët e profesionit ligjor. Plani strategjik i SHGJK-së i hartuar së voni ka vendosur luftimin e korrupsionit si një nga synimet e saj dhe tani SHGJK me ndihmën e USAID-it ka iniciuar krijimin e Qendrës burimore për trajnime dhe avokim. Gjatë vitit 2007, kjo qendër ka mbajtur tryeza të rrumbullakëta kundër korrupsionit në tërë Kosovën. SHGJK-ja dhe OAK-ja gjithashtu kanë bashkë-sponzoruar disa konferenca me tema kundër korrupsionit. Në konferencën e fundit kundër korrupsionit, përfaqësuesi i NJIGJ-it dha mendimin e tij se shumica e ankesave të hetuara nga NJIGJ-i dalin nga ngarkesa e tepërt e jo nga korrupsioni. Megjithatë, ky zyrtar i NJIGJ-it pranoi se mungesa e transparencës në procedurat gjyqësore mbetet një çështje serioze.

Faktori 21: Kodi i Etikës

Kodi i etikës ekziston për të adresuar çështjet kryesore siç është konflikti i interesit, komunikimi ex parte (vetëm me njërën palë) dhe veprimtarinë e papërshtatshme politike. Gjyqtarët kërkohen që të trajtohen në lidhje me këtë kod para fillimit të punës si gjyqtar dhe gjatë punës së tyre.

Konkluzioni	Korrelacioni: Pozitiv	Trendi: ↑
<p>Në vitin 2006 janë shpallur kodet e reja mjaft gjithëpërfshirëse të etikës dhe sjelljes profesionale për gjyqtarë dhe gjyqtarë porotë. Kodi i ri i etikës gjyqësore në një masë të madhe inkorporon në vetë praktikat më të mira ndërkombëtare. Trajnimi për Kodin e etikës gjyqësore ende nuk është i detyrueshëm, mirëpo vitin e kaluar të gjithë gjyqtarët e kanë ndjekur së paku një trajnim për Kodin e ri.</p>		

Analiza/Sfondi:

Në vitin 2001, KGJPK ka miratuar kodet e etikës për gjyqtarë dhe për gjyqtarë porotë. Kur KGJK-ja e zëvendësoi KGJPK-në, UNMIK-u i ka kërkuar KGJK-së që t'i hartojë kodet e reja të etikës. *Shih DIREKTIVA PËR DISIPLINËN GJYQËSORE § 1.1.* Kodi i ri i etikës gjyqësore është miratuar më 25 prill 2006, menjëherë pas fillimit të punës së KGJK-së, dhe ka hyrë në fuqi në shtator të vitit 2006¹⁵. Kodi i ri i etikës gjyqësore 2006 nuk ka ndonjë ndryshim të madh me pararendësin e tij të vitit 2001. Kodi zbatohet për të gjithë gjyqtarët e Kosovës, dhe përcakton standardet etike të cilat gjyqtarët duhet t'i respektojnë. Gjithashtu, llojet e shkeljeve të përcaktuara në kod nuk janë përfundimtare dhe gjyqtari mund dënohet edhe për veprimet të cilat nuk janë të përmendura në mënyrë specifike në kod, por që kanë pasojë të ngjashme. *Shih KODIN I ETIKËS GJYQËSORE, PREAMBULA.*

Në zhvillimin e kodit të ri, KGJK ka marrë parasysh një numër të standardeve ndërkombëtare dhe praktikave më të mira, përfshirë Parimet e Bangalores për Sjelljen Gjyqësore, gjuha e së cilit është përcjellë për së afërmi nga kodin e ri në shumë aspekte. Prandaj Kodi i Etikës Gjyqësore, përmban parimet themelore dhe kërkesat e kërkuara nga instrumentet ndërkombëtare, që siguron që gjyqtarët kërkohen të kryejnë veprimtaritë e tyre gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në atë mënyrë që të promovojnë besimin te popullata në integritetin dhe pavarësinë e gjyqësorit. *Shih Id. § I(1), I(3).* Kodi i etikës gjyqësore gjithashtu parashih që gjyqtarët kanë për detyrë që të "mbrojnë të drejtat dhe liritë individuale të të gjithë personave" përmes aplikimit të pa diskriminim të ligjit. *Id. § II(A)(1)(2).* Gjyqtarët kërkohen që të "veprojnë në mënyrë të paanshme dhe të pavarur në të gjitha rastet dhe të jenë të lirë nga çfarëdo ndikimi nga jashtë dhe të kryejnë detyra gjyqësore në bazë të fakteve dhe ligjit të aplikueshëm në secilin rast, pa ndonjë kufizim, ndikim të gabuar, nxitje, presion, kërcënim për ndërhyrje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë nga çfarëdo qarku." *Id. § II A(3)(a).* Kodi gjithashtu adreson çështjet e konfliktit të interesit si dhe veprimtaritë jashtëgjyqësore në të cilat gjyqtarët mundën ose nuk mundën të përfshihen. *Id. § II(A)(3)(b), II(B).*

Në mënyrë të veçantë gjyqtarët nuk mund të angazhohen në aktivitetet politike ose aktivitete tjera të papërshtatshme për funksionin e gjyqtarit; të jenë anëtarë të partive politike; ose të angazhohen në praktikë ligjore ose privatisht të mbajnë ndonjë funksion gjyqësor. *Id. § II(B)(2)(a)-(b), II(B)(8).* Kodi më tutje ndalon gjyqtarët që ta shfrytëzojnë pozitën e tyre për përfitime personale ose për dikë tjetër, që të marrin pjesë në transaksione financiare ose të biznesit të cilat ndikojnë negativisht në paanësinë e tyre dhe në kryerjen e funksionit gjyqësor, ose të pranojnë dhurata, favore, privilegje ose premtime për ndihmë materiale (ndalesa e fundit shtrihet edhe në anëtarët e familjes së gjyqtarit). *Id. § II(B)(5), II(B)(7), II(B)(9).*

¹⁵ Të njëjtën ditë, KGJK e ka shpallur në fuqi edhe Kodin e etikës për gjyqtarët porotë, i cili me disa përjashtime të vogla përmban rregulla të cilat qenësisht janë të njëjta me ato të Kodit të etikës gjyqësore.

Kodi i Etikës Gjyqësore nuk përmban ndonjë ndalesë gjithëpërfshirëse për gjyqtarët që të fitojnë jashtë suazave të pagës së tyre; por në vend të kësaj, thekson që gjyqtarët nuk mund të pranojnë kompensim për veprimtaritë e jashtme gjatë orarit të punës pa miratimin e KGJK-së. *Id.* § II(B)(2)(c). Gjyqtarët të cilët e marrin lejen e tillë nuk mund të shpërblehen më shumë se 25% të pagës së zakonshme të gjyqtarit; e as të krijojnë dukjen e papërshtatshmërisë. *Id.* § II(B)(3). Gjithashtu, gjyqtarët nuk duhet të angazhohen në aktivitet e jashtme të cilat janë të papërshtatshme për besueshmërinë, paanësinë, ose pavarësinë e gjyqësorit, ose që e pengojnë aftësinë e tyre për punë gjyqësore “në mënyrë të kujdesshme dhe brenda kohës së arsyeshme”. *Id.* § II(B)(1). Këto dispozita korrespondojnë me Rregulloren mbi KGJK-në e cila në përgjithësi i ndalon gjyqtarët të mbajnë detyrë tjetër publike ose administrative ose të angazhohen në ndonjë profesion pa marrë parasysh të paguar apo jo, por i lejon KGJK-në të autorizojë gjyqtarët të angazhohen në disa aktivitete të jashtme, siç janë puna edukative, ligjërimi, aktivitet që ndërlidhen me ligjin, sistemin ligjor, dhe administrimin e drejtësisë, për aq sa këto aktivitete nuk e pengojnë pavarësinë dhe dinjitetin e funksionit të gjyqtarit. RREGULLORJA E KGJK-SË § 5.3; KODI I ETIKËS GJYQËSORE § II(B)(1)(a). Natyra e kufizuar e ndalesës për të fituar jashtë pagave të tyre për gjyqtarët në Kosovë reflekton realitetin e pagave të dobëta gjyqësore.

Edhe pse disa aspekte të Kodit të etikës gjyqësore i adresojnë disa çështje të rëndësishme dhe specifike të etikës, Kodi shpesh nuk arrin t'i siguroj të gjitha detajet e nevojshme për dispozitat e veta. Për shembull, gjyqtarët ndalohen që të përfshihen në komunikime *ex parte* (vetëm më njërën palë), dhe duhet t'i dekurajojnë edhe tjerët për një gjë të tillë. *Shih* KODI I ETIKËS GJYQËSORE § III(A)(7). Mirëpo, komunikimi *ex parte* nuk është i definuar, dhe Kodi i etikës nuk është i shoqëruar nga asnjë koment interpretues për sqarim të mëtejshëm të kësaj çështjeje. Marrëdhënia në mes të kësaj dispozite me konceptin e barazisë së palëve, dhe paraqitjes së pahijshme të krijuar përmes shoqërimeve të tepërta në mes të gjyqtarëve dhe prokurorëve ende nuk është kuptuar si duhet dhe duhet të shtjellohet me tej gjatë sesioneve trajnuese. Në mënyrë të ngjashme Kodi i etikës gjithashtu kërkon paraqitjen në KGJK të raporteve vjetore financiare për vete dhe për anëtarët e familjes së ngushtë në përputhshmëri me ligjin. *Id.* § II B(10). Sidoqoftë, Rregullorja e KGJK-së apo Direktiva për disiplinë gjyqësore nuk përmendin asgjë në lidhje me raportimin financiar. Gjithashtu, Kodi i etikës gjyqësore nuk e njuh tërësisht rëndësinë e paraqitjes së pahijshme; por vetëm thotë që parimet e Kodit nuk vlejnë vetëm për jetën profesionale të gjyqtarit por edhe për atë private, kur veprimet e gjyqtarit mund të dëmtojnë imazhin e vetë gjyqtarit ose të gjyqësisë në tërësi para syve të publikut. *Id.* § I (3).

Kodi i etikës gjyqësore kërkon gjithashtu nga gjyqtarët që të angazhohen në arsimim të vazhdueshëm dhe trajnim “kur të kanë kohë”. *Id.* § III(A)(3). Përderisa kjo nuk obligon në mënyrë specifike trajnimin në lidhje me vetë kodin e ri, IGJK dhe Aktiviteti për Reformimin e Sistemit të Drejtësisë në Kosovë i USAID-së kanë arritur të trajnojnë të gjithë gjyqtarët e Kosovës përkitazi me kodin e ri. Duke filluar nga viti 2005, këto dy subjekte kanë bashkëpunuar në një sërë punëtorish inter-aktive (përfshirë edhe punëtoritë e trajnimit të trajnuesve) për gjyqtarët që tashmë janë në detyrë, të cilët ballafaqohen me çështje specifike etike që dalin nga vendimmarrja individuale dhe në kolegji. Fillimisht, këto punëtori u përqendruan në Kodin e etikës gjyqësore 2006 kur ai ishte ende vetëm draft. Deri më sot të gjithë gjyqtarët kanë marrë pjesë në së paku një trajnim të etikës të organizuar nga IGJK.

Përderisa Kodi i etikës gjyqësore përmend në mënyrë specifike se çka gjyqtarët munden dhe nuk munden të bëjnë, ai gjithashtu ka për qëllim që të njoftojë palët dhe avokatët në lidhje më atë se çka mund të presin nga gjyqtarët. Deri më tani nuk është bërë asnjë përpjekje për të arsimuar publikun në lidhje me kodin e ri; rrjedhimisht, popullata mbetet kryesisht e pa njoftuar me përmbajtjen e tij. Veç kësaj, mbetet të shihet se çfarë efekti praktik do të ketë Kodi i etikës gjyqësore në sjelljen e gjyqtarëve.

Faktori 22: Procesi Ankimor për Sjellje Gjyqësore

Ekziston një proces kuptimplotë në të cilin gjyqtarët tjerë, avokatët dhe publiku mund të sjellin ankesa në lidhje me sjelljen gjyqësore.

Konkluzioni	Korrelacioni: Neutral	Trendi: ↔
Ekziston një proces kuptimplotë në të cilin gjyqtarët tjerë, avokatët dhe publiku mund të sjellin ankesa në lidhje me sjelljen e pahijshme gjyqësore të supozuar. Përkundër përpjekjeve për të informuar publikun në lidhje me këtë proces, siç raportohet procesi i ankimit ka qenë i keqpërdorur në disa raste për të shqetësuar gjyqtarët përmes ankesave të pabazuara.		

Analiza/Sfondi:

Ekziston një proces kuptimplotë në të cilin çdo person apo organizatë, avokat apo gjyqtar mund të ankohet për ndonjë sjellje të pahijshme gjyqësore të supozuar. *Shih* DIREKTIVËN E NJIGJ § 2.1(C); DIREKTIVËN PËR DISIPLINËN GJYQËSORE § 2.1(A). NJIGJ pranon ankesa nga çdo burim, përfshirë ndërgjyqësit individual, pjesëtarët e publikut, avokatët, gjyqtarët tjerë, Ombudspersonit, PSSP-ja dhe organizatat lokale siç janë OJQ-të vendore, KGJK-ja, OSBE-ja etj. NJIGJ pranon ankesa me shkrim përmes postës apo postës elektronike, dhe punëson 12 inspektor të cilët regjistrojnë raporte gojore konfidenciale. Këto raporte duhet të jetë të hartuara në formularë standardë që janë ankas për këtë qëllim. NJIGJ gjithashtu pranon dhe fotokopjon të gjitha dokumentet mbështetëse. Gjithashtu pranon ankesat anonime dhe të panënshkruara, të cilat kanë qenë “produktive” sipas drejtorit të NJIGJ.

Siç është theksuar në Faktorin 17 (më lart), NJIGJ duhet t'i refuzojë ankesat të cilat janë “jashtë mandatit” të NJIGJ-it; apo që janë pa vlera apo ngacmuese; apo të cilat supozojnë fakte të cilat edhe po të ishin të vërteta nuk do të përbënin sjellje të pahijshme. Në raste të tilla, NJIGJ-i personave të cilët kanë paraqitur ankesat duhet t'u dërgoj nga një letër lidhur me refuzimin e ankesës së tyre duke i cekur arsyet e refuzimit. *Shih* DORACAKUN E NJIGJ, KREU C. 2. Pavarësisht se a pranohen apo refuzohen, të gjitha ankesat e pranuar duhet të regjistrohen në bazën e të dhënave të NJIGJ-it. Ato raste që përmbajnë dëshmi për sjellje të pahijshme referohen në KGJD të KGJK-së për shqyrtim disiplinor, siç shpjegohet në faktorin 27 (më lart). Doracaku i NJIGJ-it përcakton afatin kohor të detajuar për hetimin e ankesave. Procedura e pranimit të ankesës, sikur edhe të gjitha veprimet tjera të NJIGJ-it janë konfidenciale. *Id.* KREU B.1.

Prej 1 janarit 2007 deri më 7 nëntor 2007, në NJIGJ janë pranuar gjithsejt 435 ankesa. Në vitin 2006, NJIGJ ka pranuar 446 raste të reja, nga 73 sa kishte në vitin 2001 gjatë vitit të parë të punës së tij. Nga 446 ankesa të pranuar në vitin 2006, 221 janë refuzuar si të pabazuara. Nga numri i mbetur, janë kryer 95 hetime dhe në 89 prej tyre është gjetur se nuk ka sjellje të pahijshme kurse 6 janë referuar në KGJD. Në përgjithësi, NJIGJ ka pranuar gjithsejt 1,921 ankesa që nga viti 2001. I ka refuzuar 757 syresh, hetuar 593 ankesa por nuk ka gjetur shkelje. I ka përcjell KGJD-së 73 ankesa dhe ka përfunduar edhe 221 hetime të cilat presin referimin tek KGJD. 287 ankesat e mbetura janë ende nën hetime.

Ankesat më të shpeshta të pranuar nga NJIGJ-i kanë të bëjnë me vonesat në procedurat gjyqësore. Në shumë raste vonesat nuk janë shkaktuar nga sjellja e pahijshme e gjyqtarit individual ndaj të cilit është ushtruar ankesa por, nga mangësitë sistematike, siç është pamjaftueshmëria e personelit gjyqësor dhe ndërtesave, si dhe çështjeve të mbajtjes së të dhënave dhe menaxhimit të lëndëve. Inspektori gjyqësor duhet të vlerësojë se a përmban rasti fakte nga të cilat do të nxirrej konkluzion se gjyqtari individual është ndikuar nga presioni i jashtëm (siç është kërcënimimi apo oferta për kompensim) për zvarritjen e procedurës, apo zvarritja ishte sistematike. NJIGJ-i ka një divizion të ndarë të auditimit, që është projektuar për të trajtuar çështjet të cilat nuk adresohen nga

sistemi gjyqësor në mënyrë që të sigurojë dhënien e drejtësisë me kohë. Divizioni i auditimit u aktivizua në vitin 2006, dhe ka bërë auditime rreth aplikimit të parashkrimit në rastet penale, kohëzgjatjen e nxjerrjes së vendimeve me shkrim në rastet civile dhe penale, procesit të regjistrimit të dokumenteve dhe futjes së tyre në dosje dhe zinxhirit të ruajtjes së dëshmimeve.

Të anketuarit gjithashtu kanë raportuar se palët shpesh sjellin ankesa thjeshtë për shkak se nuk janë të kënaqur me vendimin e gjyqtarit, duke shfrytëzuar kështu procedurën e ankimit në vend të asaj të apelit. Një gjë më brengose është se palët mund të paraqesin ankesë kundër gjyqtarit me qëllim të shqetësimit, hakmarrjes apo përfitimeve tjera personale. Një i intervistuar nga ekipi i vlerësimit ngriti çështjen se shumica e rasteve të sjella në NJIGJ ishin pa merita, dhe ishin sjellë thjeshtë nga palët e pasuksesshme sa për t'i bezdisur gjyqtarët. Prandaj refuzimi i menjëhershëm i ankesave të pabazuara është i domosdoshëm ngase i lejon NJIGJ të shfrytëzojë resurset e kufizuara për t'u fokusuar në rastet më serioze. Megjithatë, të anketuarit gjithashtu dhanë mendimin se NJIGJ-i nuk i ka pastruar sa duhet ankesat e tilla të pabazuara.

Sektorët e mëdhenj të publikut kanë mbetur të pa njoftuar lidhur me të drejtën e tyre për të ngritur ankesë kur ata mendojnë se ka ndodhur një sjellje e pahijshme gjyqësore, përkundër përpjekjeve për të arsimuar publikun për këtë të drejtë. Mungesa e financimit për fushata të informimit publik në lidhje me ekzistimin e NJIGJ-it dhe procedurën e tij të ankimit kanë penguar shpërndarjen e informative. Së fundi janë bërë disa përpjekje për ta bërë publik ekzistimin e mekanizmit për ankesë ndaj sjelljes së pahijshme gjyqësore. NJIGJ-i shpërndanë edhe fletushka informative të përpiluara mirë, të cilat në një gjuhë të thjeshtë sqarojnë atë se çka bën e çka nuk bën NJIGJ-i, si dhe çfarë lloj sjelljesh të pahijshme heton dhe çfarë sjellje mund të pritet nga gjyqtarët dhe gjyqtarët porotë. Veç kësaj Iniciativa për Sundimin e Ligjit së voni ka ndihmuar në zhvillimin e shpalljeve publike për emetim televiziv në lidhje me procedurën e ankimit ndaj sjelljes së pahijshme gjyqësore. Me sa duket, këto shpallje kanë rezultuar në rritje të dukshme të numrit të kontakteve me NJIGJ-in në javët pas shpalljeve. Përfundimisht, Aktiviteti për Reformimin e Sistemit të Drejtësisë në Kosovë i USAID-së gjithashtu e ka prodhuar një film dokumentar 22 minutësh në lidhje me gjykatat dhe standardet kohore që KGJK-ja i ka në dispozicion për rastet. Ky dokumentar gjithashtu sugjeron publikun që të jenë më aktiv në informimin e vetvetes në lidhje me sistemin gjyqësor.

Faktori 23: Qasja e Publikut dhe Mediave në Procedurë

Procedurat në gjykatë janë të hapura dhe mund të akomodojnë si publikun ashtu edhe mediat.

Konkluzioni	Korrelacioni: Pozitiv	Trendi: ↔
Sipas ligjit, gjykatat janë të hapura për publikun dhe mediat, dhe në praktikë mediat janë kryesisht të lira që të raportojnë lidhur me gjykatat. Mirëpo, vendi i pamjaftueshëm nëpër gjykatore vazhdon të jetë si barrierë. Ngjashëm me këtë ekziston mungesë e njohurive në mesin e gjyqtarëve lidhur me të drejtën për qasje në procedurat gjyqësore.		

Analiza/Sfondi:

Kërkesa për gjykime publike është e përmendur në disa ligje. Sipas Kornizës Kushtetuese, të gjitha procedurat gjyqësore në Kosovë duhet të jenë publike përveç nëse ndryshe parashikohet me ligjin në fuqi. *Shih* KORNIZËN KUSHTETUESE § 9.4.5. Kjo ritheksohet ehe me Ligjin mbi Gjykatat e

Rregullta, i cili thotë se “puna e gjykatave është publike.” Gjykatat duhet të garantojnë qasje publike në secilën prej procedurave të tyre duke shpallur emrat e gjyqtarëve të cilët do të shqyrtojnë rastin, duke informuar publikun për rrjedhën e rastit përmes mediave, dhe duke shpallur publikisht vendimet e gjykatës. *Shih* LIGJI MBU GJYKATAT E RREGULLTA neni 7; *shih gjithashtu* KPPPK nenet 328-331; LIGJIN MBI PROCEDURËN KONTESTIMORE neni 306; nëse gjyqtari dëshiron (me kërkesën e njëres nga palët apo me kërkesën e vetë gjyqtarit) të mbyllë gjykatoren për të tërë apo për një pjesë të gjykimit, gjyqtari së pari duhet t’u lejojë palëve apo publikut (përfshirë përfaqësuesit e mediave) që të deklarohen. KPPPK neni 329. Pastaj gjyqtari mund të mbyllë seancën vetëm nëse një gjë e tillë kërkohet për të mbrojtur sekretet zyrtare, konfidencialitetin e informatave mbrojtjen e interesave të fëmijëve apo mbrojtjen e jetës personale apo familjare të pjesëmarrësve, mbrojtjen e interesave të fëmijës apo mbrojtjen e palëve të dëmtuara apo dëshmitarëve. *Id.* Mirëpo, palët, viktimat, përfaqësuesit e tyre, dhe mbrojtësit mund të mos përjashtohen nga procedura, ndërsa gjykata mund të lejojë pjesëmarrjen e disa zyrtarëve, akademikëve, figurave publike dhe bashkëshortëve ose partnerëve jashtë martesor të të akuzuarit për të marrë pjesë në seancat e mbyllura për publikun. *Id.* 330. Vendimi për çështjen e mbylljes së seancës duhet të mbështetet me arsye dhe të bëhet publik, dhe nuk i nënshtrohet ankesës. *Id.* neni 331. Sa i përket asaj se deri në çfarë mase lejohet qasja e medias gjatë vetë shqyrtimit, KPPPK nuk lejon fotografimin, video apo audion incizimin gjatë seancës për konfirmim dhe shqyrtimit, përveç nëse një gjë e tillë kërkohet nga palët ose kur autorizohet nga kryetari i gjykatës dhe kur autorizohet nga kryetari i Gjykatës Supreme. *Id.* nenet 93(2)-(3).

Për të siguruar që mediat dhe publiku do të jenë të njoftuara për procedurat gjyqësore, legjislati përkatës kërkon që lista e rasteve të vendoset në një vend të qasshëm për publikun në të gjitha gjykatat. *Shih* RREGULLAT E BRENDSHME TË PUNËS SË GJYKATAVE neni 8; *Letër Qarkorja e DD-së 2003/7 mbi Qasjen e publikut në drejtësi* [në tekstin e më tutjeshëm *Letër qarkorja*]. Letër qarkorja e drejtësisë gjithashtu kërkon që këto informata të vihen në dispozicion me kërkesën e të gjithë pjesëtarëve të publikut. Mirëpo, kjo kërkesë është larg nga zbatimi i njëtrajtshëm. Ekipi vlerësues nuk ka vërejtur asnjë listë të tillë në asnjërin nga gjykatat e vizituara. *Letër qarkorja* gjithashtu kërkon që informatat e tilla të vihen në dispozicion me kërkesë nga kushdo nga publiku. Gjithashtu, një person i cili pyet për vendin e mbajtjes së një dëgjimi të tillë mund t’ju nënshtrohet pyetjeve të papërshtatshme.

Vazhdojnë të ekzistojnë edhe disa pengesa praktike të qasjes në sallat e gjykimit. Për shembull, përderisa disa raste të profilit të lartë nganjëherë mbahen jashtë gjykatores, në një auditorium, për të garantuar qasje të mediave dhe publikut, shumica e rasteve shqyrtohen në ndërtesat e mbipopulluara të gjykatave. Duke pasur parasysh mungesën e sallave të gjykimit, shumica e gjyqtarëve disa prej seancave i mbajnë nëpër zyrat e tyre. Me përjashtim të kryetarëve të gjykatave, dhomat e të cilëve janë mjaft të gjëra për të pasur një tavolinë të konferencave, këto zyra janë dhoma të vogla, që përmbajnë nga një tavolinë pune një tavolinë të vogël për nëpunësit stenografik të gjyqtarit, dhe disa karrige për palët dhe nganjëherë një ose dy më tepër për anëtarët e familjes. Dëgjimet duhet të mbahen me dyer të mbyllura për të shmangur pengesat, kështu që vëzhguesit apo përfaqësuesit e mediave të cilët marrin pjesë domosdo do ta pengojnë seancën. Me kufizime të tilla në hapësirë, është fizikisht e pamundshme që të përmbushen kërkesat ligjore që procedura mbahet publikisht. Hapësira e pamjaftueshme nëpër gjykata e ka zvogëluar transparencën e gjyqësorit, në një kohë kur po bën hapa të mëdhenj në përpjekjet për të fituar respektin.

Problemi plotësues është se shumë gjyqtar nuk i kanë kuptuar plotësisht përgjegjësitë e tyre sa i përket qasjes së publikut dhe mediave në procedurat gjyqësore, edhe pse janë informuar lidhur me dispozitat përkatëse ligjore. Si gazetarët e shtypit ashtu edhe ata të mediave elektronike tregojnë që, përderisa shumica e gjyqtarëve e marrin këtë përgjegjësi me seriozitet dhe seancat e tyre i mbyllin vetëm për arsye të bazuara në ligj, disa gjyqtar përdorin dispozitat e KPPPK-së nenit 329 si arsyetim për mbylljen e sallës së gjykimit pa dhënë asnjë argument dhe pa bërë të ditur asnjë gjetje qoftë në mënyrë gojore ose me shkrim përkitazi me bazën për këtë vendim. Mungesa e definicioneve lidhur me arsyet për mbajtjen e seancave të mbyllura, e bën më të lehtë për gjyqtarët

që t'i përfundojnë gjykimet pa ndonjë pasojë. Në një rast të përshkruar për ekipin vlerësues, një gjyqtar nuk e ka lejuar as përfaqësuesin e palës që të jetë prezent, përkundër rregullit të qartë të KPPPK-së për të kundërtën.

Janë bërë disa përpjekje për ngritjen e vetëdijes për të drejtën e publikut dhe mediave për të pasur qasje në seancat gjyqësore. Reformimi i Sistemit të Drejtësisë në Kosovë i USAID-së dhe IREX-i kanë organizuar trajnime për gazetarët përkitazi me kuptimin e sistemit gjyqësor dhe terminologjisë juridike, në mënyrë që të promovojnë raportim të saktë. Dokumentari i bërë nga Aktiviteti për Reformimin i Sistemit të Drejtësisë në Kosovë i USAID-së (i paraqitur në faktorin 22 më lart) thekson që gjykatat janë të hapura dhe që qytetarët duhet të marrin pjesë në seancat gjyqësore në mënyrë që të informohen. Gjithashtu Aktiviteti për Reformimin e Sistemit të Drejtësisë në Kosovë i USAID-së ka krijuar një doracak për zyrtarët e gjykatave për informim publik, dhe financimi për pozita të tilla është kërkuar në propozim buxhetin e gjyqësorit për vitin 2008-2010.

Faktori 24: Publikimi i Vendimeve Gjyqësore

Vendimet gjyqësore janë dokumente zyrtare edhe opinionet e rëndësishme që jepen në instancën e apelit publikohen dhe janë të hapura për shqyrtim akademik dhe publik.

Konkluzioni	Korrelacioni: Negativ	Trendi: ↔
Kryesisht, vendimet gjyqësore nuk janë të shkruara mirë; e as nuk shpërndahen te publiku. Përderisa disa vendime të përzgjedhura të Gjykatës Supreme janë publikuar nga Qendra Juridike e Kosovës, Shumica e vendimeve të apelit ende nuk janë të qasshme për gjyqtarët tjerë dhe avokatët. Vendimet gjyqësore gjithashtu nuk janë të shkruara mirë, dhe cilësia do të përmirësohej sikur vendimet të ishin më tepër të qasshme për shqyrtim.		

Analiza/Sfondi:

Ligji për qasje në dokumente zyrtare përcakton rregulla për qasjen e publikut në vendimet gjyqësore. Sipas këtij ligji, vendimet gjyqësore mund të klasifikohen si "dokumente zyrtare". *Shih* LIGJIN MBI QASJEN NË DOKUMENTET ZYRTARE § 2(b), 3.3 (*shpallur nga UNMIK-u me Rregulloren nr. 2003/32*) [më tutje LIGJI PËR QASJE NË DOKUMENTET ZYRTARE]. Të gjitha dokumentet e tilla janë të "qasshme për publikun qoftë pas një kërkesë me shkrim ose drejtpërsëdrejti në formë elektronike përmes zyrës së regjistrimit." *Id.* § 3.4. Qasja mund të mohohet vetëm në rrethana specifike, në të cilat zbulimi do të mund të ndikojë negativisht në mbrojtjen e interesit publik në fushën e sigurisë, mbrojtjes dhe çështjeve ushtarake apo nëse zbulimi do të ndikojë negativisht në jetën private, integritetin dhe interesat individuale të një personi. *Id.* § 4.1-4.2.

Përderisa vendimet gjyqësore janë në dispozicion të publikut, ato zakonisht nuk i shpërndahen publikut të gjerë. Në vend të kësaj, vendimet e formës së prerë iu sigurohen personave të interesuar pas paraqitjes së kërkesës¹⁶. *Shih* KPPPK nenet 89, 123, 395; Ligjin mbi Procedurën

¹⁶ Nëse miratohet projektligji do të ndihmonte përmirësimin e situatës, pasi që siguron që mendimet e shkruara të nxjerra nga Gjykata e Apelit (e cila do të themelohej sipas projektligjit) dhe Gjykata Supreme të "sigurohen për secilën gjykatë tjetër të shkallës më të ulët dhe për të gjitha palët në procedurë." Mirëpo, edhe nëse implementohet projektligji, situata nuk do të rregullohet plotësisht, pasi publiku dhe mediat ende nuk do të kenë

Kontestimore nenet 150, 337. Mirëpo vendimet e nxjerra nga Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme për çështjet që kanë të bëjnë me AKM-në, sipas ligjit përveç palëve, kërkohen që të bëhen të qasshme edhe për publikun. *Shih* RREGULLORJA PËR DHOMËN E POSAÇME PËR ÇËSHTJET E AKM-SË § 9.4-9.5.

Janë bërë disa përpjekje për përmirësim e qasjes së publikut në vendimet gjyqësore. Me financim nga Departamenti i Shtetit të SHBA-ve, Qendra Juridike e Kosovës (më tutje QJK) ka publikuar katër vëllime të Buletinit të Gjykatës Supreme të Kosovës, që përmban aktgjykime të përzgjedhura të Gjykatës Supreme të vendosura që nga viti 1999, të përkthyer në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe. Vëllimi 1 i Buletinit (i publikuar në qershor të vitit 2005) përmbante të gjitha aktgjykimet e Gjykatës Supreme të marra lidhur me KPPPK-në dhe KPPK-në. Mbledhja e këtyre vendimeve ka qenë një proces i vështirë, dhe për shkak të mungesës së një arkivi të centralizuar është dashur që të kontaktohet individualisht secili gjyqtar i Gjykatës Supreme dhe të kopjohen vendimet e tyre. Pasi që këto vështirësi kanë bërë që Vëllimin I ta tejkalojë buxhetin e vet të paraparë, vëllimet tjera (të gjitha të publikuara në vitin 2007) u kufizuan vetëm në përmbledhjen e vendimeve dhe vendimet që në esencë ishin të ngjashme u referuan në fusnotë. Një avantazh që e lehtësojë vazhdimësinë e projektit ishte se të gjitha vendimet e marra pas publikimit të vëllimit të I-rë gjithashtu u futën edhe në një arkiv elektronik.

Kufizimet në financim kanë kufizuar shpërndarjen e kopjeve të letrës së Buletinit të Gjykatës Supreme vetëm te gjyqtarët, prokurorët, avokatët dhe profesionistët tjerë ligjor. Për të plotësuar kërkesën shtesë të palëve të interesuara, përfshirë këtu zyrtarë diplomatike, QJK-ja gjithashtu ka prodhuar një version elektronik të Buletinit të Gjykatës Supreme që është në dispozicion në CD apo si dosje që mund të shkarkohet nga faqja e internetit e QJK-së <http://www.kosovolawcenter.org>. Pasi që financimi për projektin e buletinit ka skaduar në korrik të vitit 2007, vendimet e Gjykatës Supreme ende nuk janë të qasshme në mënyrë uniforme.

Krahas vënies në dispozicion të vendimeve të gjykatave vendore, njëri nga të anketuarit gjithashtu kanë sugjeruar përkthimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në gjuhën shqipe dhe serbe, dhe shpërndarjen e tyre tek gjyqtarët, pasi që KEDNJ është inkorporuar në ligin pozitiv të Kosovës.

Shpresohet se me shpërndarjen më të gjerë të vendimeve do të kemi një përfitim shtesë në inkurajimin e gjyqtarëve që të përfshijnë gjetjet faktike dhe arsyetimin ligjor në vendimet e tyre me shkrim. Shtimi i publikimeve të vendimeve gjyqësore gjithashtu mund të ndihmojë edhe në përmirësimin e afateve kohore të nxjerrjes së vendimeve të shkruara nga gjyqtarët. Vonesat në dorëzimin e aktgjykimeve kanë qenë burim i shumë ankesave në NJIGJ. Divizioni i auditimit ka hetuar këtë çështje në vitin 2006, duke gjetur se vetëm diku rreth 30% të aktgjykimeve nxjerrjen brenda afateve të kërkuara kohore dhe se nxjerrja e disa vendimeve vonohej deri në tri vite.

Të anketuarit gjithashtu raportuan që shumë vendime gjyqësore ishin të shkruara aq dobët sa që nuk ishte gjithnjë e qartë se cilat janë faktet e një rasti caktuar, dhe se pse është aplikuar ligji në bazë të atyre fakteve. Ankesat disiplinore kundër gjyqtarëve shpeshherë referohen në aktgjykime të shkruara dobët. Mangësitë janë evidente posaçërisht në vendime gjyqësore të cilat kanë të bëjnë me zgjatjen e paraburgimit në rastet penale dhe ka mungesë të sanksioneve alternative. KPPPK kërkon që gjyqtarët që shqiptojnë dënimet të marrin para sysh sanksionet alternative dhe në pjesën e dënimit të përfshijnë një "shpjegim të të gjitha provave materiale." *Shih* KPPPK, nenin 283. Mirëpo, ekipi monitorues i OSBE-së ka gjetur se në "shumicën e madhe të rasteve", "gjykatat e Kosovës ende nuk i arsyetojnë si duhet aktvendimet për shqiptimin e paraburgimit". *Shih* Raportin mujor të Departamentit për të drejtat e njeriut, decentralizim dhe komunitete – OSBE (tetor 2007). Të anketuarit kanë pohuar se disa gjyqtarë kanë nxjerrë të njëjtin aktgjykim të shkruar

qasje të lehtë në vendimet e gjyqësorit. Një gjë që edhe më tepër e komplikon situatën është nevoja që vendimet të jenë të qasshme në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe.

për lëndë të ndryshme duke kopjuar kështu të gjithë tekstin e një aktgjykimi në aktgjykimin tjetër dhe duke ia ndërruar vetëm emrin e të pandehurit. Veç kësaj, disa prokurorë sipas raportimeve nuk kanë siguruar prova për të mbështetur propozimin për paraburgim, por ata nuk janë mbajtur përgjegjës nga gjyqtarët për këtë.

Faktori 25: Mirëmbajtja e Procesverbalit Gjyqësor

Procesverbali dhe shkresat tjera të procedurës gjyqësore mirëmbahen dhe janë në dispozicion për publikun.

Konkluzioni	Korrelacioni: Negativ	Trendi: ↔
Sipas Ligjit gjyqtarët kërkojnë që të mbajnë procesverbal lidhur me seancat gjyqësore. Mirëpo, këto procesverbale nuk mbahen në mënyrë të njëtrajtshme, dhe nuk mirëmbahen gjithnjë si duhet. Disa projekte së voni kanë bërë përpjekje që të përmirësojnë procesverbalet e gjykatave dhe ruajtjen e shënimeve të gjykimeve.		

Analiza/Sfondi:

Me ligj gjykatat obligohen të mbajnë procesverbal për seancat në procedurë kontestimore dhe penale. Ligji mbi procedurën kontestimore, kërkon që të mbahet procesverbal për “të gjitha veprimet e ndërmarra gjatë seancave gjyqësore.” Këto dosje duhet të përmbajnë emrin dhe përbërjen e gjykatës, datën e veprimit, palët dhe përfaqësuesit e tyre si dhe “informata relevante lidhur me kontekstin në të cilin është ndërmarrë veprimi.” Këtu duhet të përfshihet një e dhënë se a ka qenë gjykimi i hapur për publikun, çfarë deklaratash dhe dëshmish janë dhënë nga palët, si dhe pyetjet e bëra për dëshmitarët dhe çfarë vendimi që është marrë nga gjykata. LIGJI MBI PROCEDURËN KONTESTIMORE nenet 123, 124. Shënimet e seancës (p.sh procesverbali i seancës gjyqësore) kryesisht bazohen në përmbledhjen gojore të gjyqtarit, edhe pse ligji lejon që marrja e shënimeve të bëhet përmes metodave stenografike apo të audio incizimit. *Shih* KPPPK nenet 86, 90, 92, 348; *shih gjithashtu* RREGULLAT PËR VEPRIMTARI TË BRENDSHME TË GJYKATAVE nenet 182-186. Nëse një rast është dëgjuar nga kolegji i gjyqtarëve, procesverbali duhet të mbahet sipas votimit të tyre, dhe nëse vota e tyre nuk është e njëzëshme, procesverbali duhet të mbahet në këshillim me ta. *Shih* LIGJI MBI PROCEDURËN KONTESTIMORE neni 128. Procesverbalet e gjykatës duhet të nënshkruhen nga kryetari i gjykatës, procesmbajtësi, dhe palët (apo përfaqësuesit e tyre ligjor). *Id.* neni 127.

Nuk ka dispozita që garantojnë qasjen e publikut në stenogramet apo procesverbalet e seancave gjyqësore. Vetëm palët në atë çështje kanë qasje të drejtpërdrejtë, kurse palët tjera të interesuara mund të kenë qasje pas lejimit nga kryetari i gjykatës. LIGJI MBI GJYKATAT E RREGULLTA neni 113; KPPPK nenet 89(1), 350; LIGJI MBI PROCEDURËN KONTESTIMORE neni 150. Gjyqtarët nuk ua sigurojnë madje edhe avokatëve procesverbalet edhe pse një kërkesë me shkrim te kryetari i gjykatës zakonisht prodhon rezultate të dëshiruara.

Në praktikë procesverbalet e seancave gjyqësore nuk mbahen në mënyrë të njëtrajtshme, dhe sipas raportimeve nuk janë edhe aq të thukëta. Procesverbalet fjalë për fjalë të seancave janë të rralla. Është raportuar që në Gjykatën e Qarkut në Prizren avokatët e nënshkruajnë procesverbalin ashtu siç kërkohet me ligj, por vetëm në rastet civile. Një i anketuar e ka përshkruar procesverbalin e gjykatës si të përbërë vetëm nga përmbledhjet e dëshmive të dhëna të “dëshmitarëve kryesorë”. Krahas kësaj, disa avokatë si duket ende ngrenë zërin kundër procesverbaleve fjalë për fjalë. Mirëpo, një i anketuar ka komentuar se procesverbalet fjalë për fjalë i inkurajojnë avokatët që të

fokusohen më mirë në detyrën e tyre. Për dallim, procesverbalet fjalë për fjalë janë përdorur në seancat e udhëhequra nga gjyqtarët ndërkombëtar dhe kanë marrë komente të mira.

Janë bërë përpjekje për të inkurajuar mbajtjen e procesverbaleve të sakta dhe të thukëta të seancave gjyqësore. Në Qershor të vitit 2004 një pilot-projekt i Aktivitetit për Reformimin e Sistemit të Drejtësisë në Kosovë i USAID-së ka vendosur dhjetë komplete të pajisjeve për audio incizim në pesë vende nëpër gjykata për të inkurajuar praktikën e përdorimit të transkriptove fjalë për fjalë në procedurat penale. Iu është siguruar trajnim përdoruesve të tyre dhe një zyrtar i DAGJ-it është trajnuar që të vazhdojë të sigurojë trajnim për përdoruesit e tyre. Në fillim të projektit, gati të gjitha pilot vendet, përveç njërit, kishin filluar përdorimin e pajisjeve. Reagimi pozitiv, rezultojë në kërkesë për 30 komplete shtesë të pajisjeve në buxhetin e vitit 2006. Mirëpo, që nga korriku 2006, paratë nuk janë ndarë dhe nuk janë blerë as pajisjet e reja. *Shih VLERËSIMIN E USAID i vitit 2005 në f. 25.* Në mënyrë efektive, përdorimi i pajisjeve varej nga prioritetet e individëve të përfshirë, dhe se nuk kishte monitorim se a janë përdorur pajisjet. *Id.* Komentet nga kryetari i njëres nga pilot gjykatat i konfirmojnë komentet e USAID-it përkitazi me prioritetet. I anketuari i njëjtë e ka informuar ekipin e vlerësimit se në fillim kishte probleme me cilësinë e pajisjeve dhe si rezultat i kësaj nuk janë përdorur shumë shpesh. Mirëpo, aktualisht ekziston një kërkesë shumë e madhe për përdorim të teknologjisë në sallat e gjykimit të asaj gjykate dhe gjykata ka kërkuar instalimin e dy sistemeve të tilla edhe zyrat e përdorura nga gjyqtarët e procedurës paraprake dhe gjyqtari për konfirmim të aktakuzës. Duhet përmendur se janë bërë edhe disa përpjekje të mëvonshme për ri-trajnimin e personelit gjyqësor për përdorimin e pajisjeve, ndërsa Aktiviteti për Reformimin e Sistemit të Drejtësisë në Kosovë i USAID-së ka raportuar suksese më të mëdha në vitin 2007 nga aspekti i përdorimit të pajisjeve.

Mungesa e gjykatoreve formale gjithashtu e ka penguar përparimin e këtij projekti të Aktivitetit për Reformimin e Sistemit të Drejtësisë (USAID-së), edhe pse është e paqartë përse pajisjet për audio incizim nuk kanë mundur të vendosen edhe në zyrat e gjyqtarëve ku ishin mbajtur dëgjimet, siç ka ndodhur në zyrat e një gjyqtari nga Prishtina.

Një aspekt tjetër problematik përkitazi me mbajtjen e procesverbaleve të seancave gjyqësore ishte gjendja e rëndë e dosjeve të arkivuara. Zakonisht dosjet e lëndëve mbesin në zyrën e gjyqtarit derisa të iu vjen afati i largimit kur ato iu dorëzohen nëpunësit të gjykatës për një periudhë njëvjeçare, pas së cilës ato arkivohen në bodrumet e ndërtesave të gjykatave. Sipas Ligjit numri i viteve për ruajtjen e dosjeve varet nga natyra e rastit dhe dallon nga pese deri në tridhjetë vite. Për shembull, lëndët e arkivuara për rastet penale me dënime duhet të mbahen prej 10 deri në 30 vjet, varësisht nga kohëzgjatja e dënimit të shqiptuar. Dosjet që kanë të bëjnë me konfliktin administrativ dhe kontestet civile duhet të ruhen për 10 vite, ndërsa lëndët për ekzekutimin e aktgjykimeve mbahen për 5 vjet. Pastaj, gjykata mund t'i spastrojë dosjet. *Shih Rregullat e brendshme të gjykatave neni. 266.*

Një projekt i Aktivitetit të USAID-së për Reformimin e Sistemit të Drejtësisë ka bërë hapa të mëdhenj për përmirësimin e praktikës së arkivimit në gjykata. Në fillim të zbatimit të këtij projekti për arkivim, një numër i madh i rasteve nga periudha para vitit 1999 ishin ende nëpër arkiva. Ato nuk ishin mirëmbajtur si duhet apo shënjuar si duhet, shumë prej tyre ishin vjedhur apo hedhur. Me ndihmën e specialistit për administratë gjyqësore nga Aktiviteti i USAID-së për Reformimin e Sistemit të Drejtësisë në Kosovë, përmbi 100.000 nga këto dosje janë inventarizuar në Gjykatën Komunale të Gjilanit në vitin 2002, dhe mbi 70 000 dosje janë spastruar. Të tjerat janë renditur sipas vitit dhe llojit të lëndës. Një donator francez ka ndërtuar një depo për ruajtjen e tyre. Kryetari i gjykatës ka raportuar se tani ai mund ta gjejë një dosje të vjetër tridhjetë vjeçare për vetëm disa minuta. Mirëpo, publiku kryesisht, ende nuk ka të drejtë të ketë qasje në këto dosje.

VI. Efikasiteti

Faktori 26: Stafi Përkrahës i Gjykatave

Çdo gjyqtar ka përkrahje të nevojshme me resurse njerëzore, për ta kryer punën e tij apo saj, p.sh numër të mjaftueshëm dhe kualitativ të stafit përkrahës, për rregullimin e dokumentacionit dhe hulumtim ligjor.

Konkluzioni	Korrelacioni: Negativ	Trendi: ↔
Gjyqtarët kryesisht nuk kanë personel adekuat mbështes për t'i ndihmuar ata në punët administrative dhe detyrat substanciale ligjore, gjë që rezulton në vonesa gjatë procedurave gjyqësore.		

Analiza/Sfondi:

KGJK ka kontroll mbi vendimet për personelin e gjykatave. *Shih RREGULLOREN MBI KGJK-NË § 1.7(c)*. Kryetarët e gjykatave kanë pak hapësirë në kërkimin e punëve nga personeli dhe mund të propozojnë ndryshime vetëm tek KGJK. Shumica e gjyqtarëve të intervistuar nga ekipi i vlerësimit treguan se kanë pasur vetëm një nëpunëse të sekretarisë, dhe asnjëri nuk e kishte bashkëpunëtorin e tyre profesional, edhe pse disa bashkëpunëtor profesional janë në dispozicion në numër të kufizuar të gjykatave. Edhe gjyqtarët ndërkombëtar kanë pasur vetëm një asistent të sekretarisë dhe asnjë personel tjetër. Këto përgjigje janë konfirmuar nga të dhënat në tabelën e më poshtë.

PERSONELI MBËSHTETËS NË GJYKATAT E KOSOVËS

Viti	Numri i gjyqtarëve	Numri i personelit ndihmës (përfshirë personelin sekretarisë)	Numri i personelit të sekretarisë
2004	313	1,280	287
2007	309	1,423	295

Një inspektim më i afërt në disa gjykata demonstroi situata posaçërisht problematike sa i përket nivelit të gradave. Përderisa në gjykatat e Mitrovicës së veriut numri i rasteve është dyfishuar që nga lufta e vitit 1999, numri i gjyqtarëve dhe personelit të punësuar atje vazhdon të jetë i njëjtë si në vitin 2000 – gjithsej 37 personel mbështetës për nëntë gjyqtarë të qarkut. Gjykata Komunale e Prizrenit me 11 gjyqtarë, raportohet se gjithashtu vuan nga mungesa e personelit, me vetëm një bashkëpunëtor profesional në gjithë gjykatën.

Ekipi vlerësues ka gjetur disa shembuj specifik për nevojën për më shumë personel përkrahës nëpër gjykata. Për shembull, një numër i madh i rasteve në listën e lëndëve “jashtë-kontestimore” është e përbërë prej dokumenteve që thjeshtë kërkojnë një vërtetim, siç janë kontratat dhe autorizimet. Në një gjykatë të vizituar gjatë intervistave, ekipi i vlerësimit e vërejt një rend të gjatë të njerëzve që prisnin të kryenin lëndët jashtë-kontestimore. Vetëm një person nga personeli i gjykatës e shërbente këtë radhë të njerëzve. Disa njerëz kishin ardhur ta nxinin rendin qysh në orën 04:00 të mëngjesit. Një avokat raportoi se kishte pritur në rend që nga ora 06:00 e mëngjesit

për ta vërtetuar një kontratë për klientin e tij; ai nuk ishte shërbyer nga referenti deri në orën 11:45¹⁷.

Një shembull tjetër i mungesës së personelit është mungesa e bashkëpunëtorëve të trajnuar profesional për gjyqtarët. Në këtë drejtim është sugjeruar se produktiviteti i secilit gjyqtar do të rritej po ta kishte *praktikantin* (bashkëpunëtorin). Aktualisht, gjyqtarët duhet t'i shqyrtojnë të gjitha lëndët e reja pas pranimit, për të shikuar nëse janë plotësuar kushtet formale dhe materiale, punë kjo e cila do të mund të kryhej nga *praktikanti*. Praktikantët gjithashtu do të mund të shqyrtonin të ashtuquajturat "lëndët e pakontestueshme" dhe të nxjerrin rekomandime për gjyqtarin në lidhje me përfundimin e tyre. Veç kësaj, praktikantët do të mund të ndihmonin gjyqtarët në hulumtim ligjor dhe në përgatitjen e draft aktvendimeve, për të përmirësuar cilësinë e analizës në ato vendime. Një zhvillim pozitiv nga kjo fushë është miratimi i rregullores së fundit të KGJK-së për krijimin e pozitave njëvjeçare për *praktikantë* nëpër gjykata. Mirëpo, nuk janë ndarë mjetet për pagimin e bursave për këto pozita njëvjeçare. *Shih gjithashtu* faktorin 19 për diskutim përkitazi me programin e SHGJK/ROL për *praktikantë*.

Në nivelin e politikave, Plani strategjik i KGJK-së e përcakton si synimin e tij të katërt "themelimin e një strukture të shndoshë organizative dhe një sërë politikash dhe procedurash për menaxhimin e personelit jo-gjyqësor/administrativ, si staff esencial për funksionimin e gjykatave." PLANI STRATEGJIK I KGJK-SË NË 18-19. Në këtë drejtim, Plani strategjik bën thirrje për mbledhjen e informatave përkitazi me klasifikimin e pozitave nga shtetet tjera dhe "përgatitjen e një propozimi gjithëpërfshirës për një sistem të ri të klasifikimit të personelit." *Id.* 19.

Faktori 27: Pozitat Gjyqësore

Ekziston sistemi i tillë i cili mundëson që pozitat e reja gjyqësore të kenë mundësi të krijohen sipas nevojës.

<i>Konkluzioni</i>	<i>Korrelacioni: Negativ</i>	<i>Trendi: ↓</i>
Nuk ekziston asnjë sistem për të krijuar pozita gjyqësore sipas nevojës, dhe numri i pozitave me pagë në gjyqësi ka shënuar rënie gjatë viteve të fundit. Një nga synimet e elaboruar në Planin strategjik të KGJK-së parasheh zhvillimin e procedurës për krijimin e pozitave të reja gjyqësore, por një procedurë e tillë ende nuk është krijuar.		

Analiza/Sfondi:

Nuk ka asnjë sistem të themeluar për krijimin e pozitave të reja gjyqësore sipas nevojës. Në fakt, përkundër rritjes së numrit të lëndëve të pazgjdhura dhe ngarkesës së tyre, edhe numri i pozitave me pagë në gjyqësi ka shënuar rënie në vitet e fundit. Kjo rënie në gjyqësinë e Kosovës korrespondon me shkurtimin e vendeve të punës anekënd institucioneve të Kosovës. Vendimi i qeverisë së Kosovës për shkurtimin e vendeve të punës nëpër institucionet qeveritare ishte i bazuar në konkluzionet e Fondit Monetar Ndërkombëtar se numri i të punësuar në qeveri ishte tepër i madh. Zhvillimet në numrin e gjyqtarëve nëpër nivelet e ndryshme të gjyqësisë së Kosovës është ilustruar në tabelën në vijim.

¹⁷ Ligji në pritje për miratim mbi zyrat e noterisë do të transferonte disa nga përgjegjësitë gjyqësore për disa lloje të lëndëve jo-kontestimore tek noteritë (p.sh. juristët profesionistë dhe zyrtarët publik të emëruar nga Ministria e Drejtësisë).

NUMRI I POZITAVE GJYQËSORE NËPËR GJYKATAT E KOSOVËS				
	2004		2007	
Niveli i gjykatës	Pozitat buxhetore	Pozitat plotësuar e	Pozitat buxhetore	Pozitat plotësuar e
Gjykata Supreme	16	14	16	13
Gjykatat e qarkut	48	46	54	49
Gjykatat komunale	165	139	151	141
Gjykatat për kundërvajtje	118	100	92	89
Gjykata e lartë për kundërvajtje	5	5	5	5
Gjykata Ekonomike	11	9	4	4
Totali:	363	313	322	301

Një informatë e pakonfirmuar është raportuar se numri total i lëndëve në sistemin gjyqësor është dyfishuar që nga viti 2000, ndërsa numri i gjyqtarëve ka mbetur përafërsisht i njëjtë. Siç paraqitet në tabelën në vijim, sipas të dhënave të siguruar nga KGJK për ekipin vlerësues, numri aktual i lëndëve të pazgjdhura në gjykatat e Kosovës e tejkalon numrin 165,000 të lëndëve, ku nga ky numër, vetëm në gjykatat komunale janë 150,000 syresh.

NUMRI I LËNDËVE TË PAZGJIDHURA DHE ATYRE NË PUNË NË GJYKATAT E KOSOVËS					
Viti, niveli i gjykatës	Të pazgjdhura në fillim të vitit	Lëndë të pranuar	Gjithsej lëndë në punë	Zgjdhura gjatë vitit	Të pazgjdhura në fund të vitit
Totali 2005	126,760	252,707	379,467	235,166	143,341
Gjykatat komunale	115,350	231,642	346,992	217,306	129,357
Gjykatat e qarkut	10,517	17,177	27,964	15,261	11,802
Gjykata Ekonomike	152	451	603	469	134
Gjykata Supreme	741	3,437	4,178	2,130	2,048
Totali 2006	143,341	253,466	396,807	245,954	150,713
Gjykatat komunale	129,357	230,045	359,402	224,021	135,245
Gjykatat e qarkut	11,802	17,427	29,229	16,883	12,343
Gjykata Ekonomike	134	686	820	601	218
Gjykata Supreme	2,048	5,308	7,356	4,449	2,907
Totali 2007	151,148	202,636	353,784	185,562	166,619
Gjykatat komunale	135,245	190,069	325,313	173,235	150,025
Gjykatat e qarkut	12,343	12,568	24,911	12,327	12,585
Gjykata Ekonomike	653		653		653
Gjykata Supreme	2,907		2,907		2,907

Propozim Buxheti i KGJK-së për vitet 2008-2010 ka kërkuar një rritje prej 322 pozitave gjyqësore për vitin 2007 dhe në 402, për vitin 2008. Veç kësaj, Plani strategjik i KGJK-së propozon shfrytëzimin e “shënimeve të azhurnuara të rasteve të pazgjdhura dhe informata tjera përkitazi me rastet e pazgjdhura dhe nevojat për resurse të gjykatave,” si bazë për të arsyetuar nevojën për më shumë gjyqtar në Kuvend. PLANI STRATEGJIK I KGJK-SË, 15. Rastet e pazgjdhura dhe vonesat në sistemin gjyqësor, me sa duket i mbështesin gjetjet e Sekretariatit të KGJK-së se nevojitet të krijohen më shumë pozita gjyqësore.

Si alternativë ndaj krijimit të pozitave të reja gjyqësore, me qëllim të reduktimit të lëndëve të pazgjdhura, Plani strategjik i KGJK-së parashikon mundësinë e lëvizjes së gjyqtarëve përkohësisht nga gjykatat me numër të vogël të rasteve në gjykata më të ngarkuara. PLANI STRATEGJIK, 17. KGJK gjithashtu lejon shfrytëzimin e shënimeve për rastet e pranuar të pazgjdhura për qëllime të kufizuara të sigurimit të bazës për caktimin dhe shfrytëzimin e gjyqtarëve, por jo për përcaktimin se sa gjyqtar të rinj nevojiten. Janë ndërmarrë disa hapa tjerë plotësuese për ta reduktuar numrin e rasteve të pazgjdhura dhe për të qenë në hap me rastet e reja që sillen. Për shembull, kryetarët e gjykatave janë trajnuar mbi bazat e parimeve të menaxhimit të gjykatës (p.sh rrjedha e lëndëve dhe resurset njerëzore). Më tutje, pas një hulumtimi të bërë nga Aktiviteti për Reformimin e Sistemit të Drejtësisë në Kosovë i USAID-së, KGJK ka publikuar disa standarde të përkohshme të trajtimit të lëndëve. *Shih në përgjithësi QARKOREN E KGJK-SË PËR IMPLEMENTIMIN E STANDARDEVE KOHORE.* Mirëpo, është e rëndësishme të theksohet se standardet e trajtimit të rasteve nuk janë të papara që drejtpërsdrejti të bëjnë orarin dhe të menaxhojnë lëndët në mënyrë më efikase. Gjyqtarët e intervistuar nga ekipi i vlerësimit në mënyrë të njëtrajtshme kanë theksuar që nuk mund t'i plotësojnë këto standarde me resurset aktuale dhe duke pasur parasysh ekzistimin e rasteve të vjetra.

Së fundi duhet të theksohet që ekipi i vlerësimit ka vështruar shembuj të përdorimit të mangët të kohës gjyqësore, Për shembull, në shumicën e Gjykatave të vizituara nga ekipi i vlerësimit ka pasur disa ose asnjë rast që po shqyrtohej aktualisht; me fjalë tjera, shpërndarja aktuale e rasteve nuk ka pasur sukses në furnizimin e gjykatave me raste. Mund të përfundohet gjithashtu se demoralizimi i shkaktuar nga pagat e dobëta, si dhe nevoja për të fituar jashtë pagës, mund të zvogëlojë motivimin për të trajtuar raste dhe periudhën kohore të shpenzuar në dëgjimin e rasteve.

Faktori 28: Depozitimi i Lëndëve dhe Sistemi i Përcjelljes

Sistemi gjyqësor e ka një sistem të regjistrimit dhe përcjelljes së lëndëve i cili siguron që lëndët shqyrtohen në një mënyrë të arsyeshme dhe efikase.

Konkluzioni	Korrelacioni: Neutral	Trendi: ↔
Gjykatat e Kosovës ende mbështeten në sistemin e vjetërsuar dhe manual të depozitimit dhe përcjelljes së lëndëve. Një sistem elektronik i menaxhimit të lëndëve është në proces të implementimit; mirëpo deri më tani, ka pak dëshmi se sistemi i përcjelljes po rezulton të jetë efikas në caktimin dhe dëgjim e rasteve.		

Analiza/Sfondi:

Aktualisht, gjykatat e Kosovës ende mbështeten në sistemin e vjetërsuar, manual dhe të bazuar në libra të deponimit dhe përcjelljes së lëndëve, i cili është i mbushur me mangësi dhe lehtë i ndjeshëm ndaj abuzimeve. Prandaj, gjyqësori dhe organizatat tjera kanë bërë përpjekje që të përmirësojnë dhe azhurnojnë sistemet e regjistrimit dhe përcjelljes së rasteve. Aktiviteti i USAID-së për Reformim e Sistemit të Drejtësisë në Kosovë e ka identifikuar menaxhimin e rrjedhës së

rasteve si “funksionin më të rëndësishëm administrativ¹⁸”. USAID, *Aktivitetet e reformimit të sistemit të drejtësisë në Kosovë, buletini 21 (korrik 2006)*. Aktiviteti i USAID-së për Reformim e Sistemit të Drejtësisë në Kosovë fillimisht kishte parashikuar krijimin e një programi të teknologjisë informative, që do të përmbante një plan të rrjetëzimit për të mundësuar një tipar konsistent dhe efektiv të menaxhimit të rrjedhës së lëndëve. Mirëpo, ky angazhim ishte ndërprerë në vitin 2003 pasi që AER-i nisi një iniciativë të ngjashme të sistemit informativ të menaxhimit të rasteve (në tekstin e mëturshëm CMIS). Fatkeqësisht kishte disa probleme me CMIS. Prandaj, përpjekjet për ta implementuar CMIS-in u shoqëruan me pak informata nga përdoruesit përfundimtar në lidhje me dizajnin, dhe pak përcjellje për të parë se a po përdoren pajisjet dhe shkathtësitë e fituara. Përveç kësaj, ishte vërejtur një shkoputje midis përfshirjes së kryetarëve të gjykatave dhe administratorëve dhe “përfshirjes qenësore” nga ana e DAGJ-it për zhvillimin e sistemit të përcjelljes së lëndëve. *Id.* 22. Deri në hartimi e këtij raporti, CMIS ishte implementuar deri diku me sukses vetëm Gjykatën e Qarkut të Gjilanit, ku është në përdorim që nga viti 2006. Sidoqoftë, kryetari i gjykatës ka raportuar se softueri arkivonte “vetëm 1% të asaj që është dashur të arkivojë.” *Id.* 23. Përkundër kësaj të metë të raportuar, Gjykata e Qarkut në Gjilan ka arritur mbi 90% efikasitet në plotësimin e standardeve për regjistrimin dhe trajtimin e lëndëve.

Si pjesë e Projektit të Aktivitetit për Reformimin e Sistemit të Drejtësisë në Kosovë USAID kishin vendosur një këshilltar teknik në DAGJ. Mirëpo, DAGJ-i ka raportuar se mungesa e resurseve njerëzore dhe aftësisë për planifikim afatgjatë e bën të vështirë mbajtjen e CMIS-it. *Shih Id.* 21. Nuk është e ditur nëse KGJK, e cila ka marrë për sipër përgjegjësitë e administratës, do të ketë kapacitete që të mbështesë dhe të ndërtojë më tej këtë përpjekje. Personeli i DAGJ-it tani përbën personelin e Sekretariatit të KGJK-së. Megjithatë, Plani strategjik i KGJK-së parashikon inventarizimin e të gjitha lëndëve të pazgjidhura (përfshirë moshën) dhe zhvillimin e bazës së shënimeve për monitorimin e procedimit të lëndëve. *Shih Plani strategjik i KGJK-së 5.* Plani përfshinë gjithashtu edhe përdorimin efektiv të sistemeve moderne të menaxhimit të informatave, përfshinë implementimin e plotë të CMIS-it deri në fund të vitit 2007; mirëpo deri në automatizimin e sistemit të përcjelljes së lëndëve, në plan parashikohet krijimi i sistemit efektiv manual të përcjelljes së lëndëve. *Id.* synimi 6.

Faktori 29: Kompjuterët dhe Pajisjet e Zyrës

Sistemi gjyqësor vepron me një numër të mjaftueshëm të kompjuterëve dhe pajisjeve tjera për të mundësuar që norma e punës të realizohet në mënyrë efikase.

<i>Konkluzioni</i>	<i>Korrelacioni: Neutral</i>	<i>Trendi: ↔</i>
<p>Gjyqësori posedon numër të mjaftueshëm të kompjuterëve dhe pajisjeve tjera, por shumica e këtyre pajisjeve janë të vjetruara. Gjyqtarëve gjithashtu iu mungojnë edhe njohuritë teknike dhe duhet të trajnohen për të zhvilluar shkathtësitë e nevojshme për përdorimin e teknologjisë së re në mënyrë të efektshme.</p>		

Analiza/Sfondi:

Aktualisht gjyqësori i Kosovës posedon 971 kompjuter. Të anketuarit vërtetuan se ata kryesisht kanë qasje në këta kompjuterë, edhe pse shumica e kompjuterëve janë të vjetër dhe jashtë modës. Në kohën e fundit janë bërë përpjekje për të ngritur teknologjinë e përdorur në gjykatat e Kosovës.

¹⁸ Ekzistojnë faktorë që kontribuojnë në trajtimin e joefikas të lëndëve, tjera nga ata të mungesës së sistemit të depozitimit dhe përcjelljes. Ata përfshijnë vonesat në gjykime siç është diskutuar në faktorin 9; mbipopullimi i ndërtesave të gjykatave, siç u diskutua në faktorin 12, dhe personeli i gjykatës dhe gjyqtarët e mbingarkuar dhe të trajnuar jo-mjaftueshëm, siç është diskutuar në faktorët 26 dhe 27 më sipër.

Në vitin 2006, AER-i i ka siguruar KGJK0së 150 kompjuterë shtesë, dhe KGJK tani është duke negociuar me AER-in për pranimin e një donacioni prej 320 kompjuterëve shtesë. Kjo pritet të plotësohet nga një donacion tjetër prej 580 kompjuterësh nga AER-i. Mirëpo është raportuar se shumë prej kompjuterëve të instaluar në vitet e kaluara, nuk janë përdorur për arsye të mungesës së trajnimit dhe shkathtësive kompjuterike në mesin e gjyqtarëve dhe personelit të gjykatave. Një i anketuar përshkroi një shembull kur sekretarja kishte fshirë aktgjykimet e gjyqtarit sapo ishin shkruar, për shkak të mungesës së njohurive të mundësisë së ruajtjes së dokumenteve në atë aparat.

Personeli i gjykatës i ngarkuar me pranimin dhe regjistrimin e lëndëve të reja sipas raportimeve nuk e përdorin vazhdimisht kompjuterin, pjesërisht për shkak të mungesës së hapësirës së mjaftueshme nëpër zyra, dhe pjesërisht për shkak të ngurrimit të lënies së sistemeve të vjetra të regjistrimit në libër. Disa të anketuar kanë raportuar që lëndët fillimisht regjistroheshin në libër, dhe informatat pastaj transferohen në kompjuter. Në disa raste, CMIS i instaluar nga AER-i nuk është përdorur. Pa trajnim adekuat për ndërtim të besueshmërisë, personeli më shumë i beson sistemeve të tyre të vjetra të regjistrimit në libër.

Qasja në Internet në gjykatë nuk është diçka e zakonshme, edhe pse gjyqtarët shpeshherë kanë qasje në kompjuterë, ata zakonisht nuk mund t'i qasen internetit për të bërë ndonjë kërkim apo për të kontaktuar gjyqtarët tjerë me postë elektronike. Zakonisht, shumica e gjykatave e kanë nga një kompjuter me qasje në internet dhe gjyqtarët nuk kanë qasje në internet nga kompjuterët që i kanë në zyrë. Krahas nevojës për kompjuter të rinj, të anketuarit gjithashtu raportuan se ata kanë nevojë për makina të reja të fotokopjimit, pasi që ato që janë aktualisht në përdorim në ndërtesat e gjykatave kanë filluar të prishen. Të anketuarit gjithashtu raportuan se edhe furnizimet tjera të nevojshme për zyrë siç është letra e printerit, mund të jetë vështirë për t'u blerë. Përderisa mungesa e energjisë elektrike është raportuar si problem në vitin 2004, të anketuarit e intervistuar nga ekipi i vlerësimit në vitin 2007 kanë raportuar që gjykatat tashmë janë të pajisura me gjeneratorë për të punuar në rast të mungesës së energjisë elektrike.

Faktori 30: Shpërndarja dhe Renditja e Ligjit të Tanishëm

Sistemi ekziston në bazë të të cilit, të gjithë gjyqtarët i pranojnë ligjet e tanishme dhe jurisprudencën vendëse me kohë, dhe ekziston një sistem i pranuar kombëtar për identifikimin dhe organizimin e ndryshimeve në ligj.

Konkluzioni	Korrelacioni: Neutral	Trendi: ↔
Ekziston një sistem i kufizuar për shpërndarjen e ligjeve të reja, dhe shpërndarja shpeshherë nuk bëhet me kohë. Mungesa e një sistemi për identifikimin e ndryshimeve në ligje e rendon edhe më tepër konfuzionin ekzistues përkitazi me atë se cilat nga shumë ligje të Kosovës dhe rregulloreve të UNMIK-ut janë kontrolluese.		

Analiza/Sfondi:

Shpërndarja e ligjeve bëhet disi si kuturu dhe jo në kohë, por janë bërë disa përpjekje së voni për të rritur qasjen e publikut në legjislacion edhe pse këto nuk e adresojnë gjithëherë nevojën për qasje të shpejtë në ligjet e reja.

Në vitin 2006 Qeveria e Kosovës e ka krijuar Zyrën për menaxhim dhe administrimin e gazetës zyrtare (më tutje GZ). *Shih* LIGJIN MBI GAZETËN ZYRTARE NENI 5.1 (*shpallur në fuqi me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/25*). Ligji kërkon publikimin mujor të GZ në gjuhën shqipe, serbe, angleze, turke dhe boshnjake, *Id. nenet 4.1, 3.1*. Gazeta u shpërndahet te të gjithë gjyqtarët pa pagesë, dhe është në dispozicion për blerje nga çdokush përmes zyrave lokale të postës, me pagesë prej 2 eurosh. Mirëpo GZ përmban vetëm tekstin e ligjeve të Kuvendit dhe udhëzimeve të IPVQ-ve, (*shih id. nenin 2.1*), dhe nuk bënë shpërndarjen e tyre me kohë. Shumë ligje të shpallura gjatë viteve 2005 - 2007 ende nuk janë përfshirë në GZ. Me ligj, përmbajtja e GZ-së duhet gjithashtu të vihet në dispozicion edhe në formën elektronike, pa pagesë (*shih id. nenin 2.3*) dhe kështu mund të gjendet në faqen e saj të internetit www.gazetazyrtare.com edhe pse faqja nuk azhurnohet rregullisht, dhe legjislacioni nuk identifikohet me citime të plota. GZ nuk publikon rregulloret e UNMIK-ut apo urdhëresat administrative; mirëpo ato mund të gjenden në faqen e Gazetës Zyrtare të UNMIK-ut, në faqen e internetit të UNMIK-ut www.unmikonline.org ku aktet e UNMIK-ut janë të numëruara në mënyrë kronologjike, në vend të mënyrës së titujve. Edhe UNMIK-u e bën shpërndarjen e këtyre materialeve tek gjyqtarët.

Krahas GZ-së dhe faqes së internetit të UNMIK-ut, janë publikuar edhe disa tregues legjislativ ose kjo mundësi është duke u shqyrtuar. Para krijimit të GZ-së, ligjet e Kosovës janë publikuar në një kompilacion të vetëm nga QJK-ja. QJK-ja (me ndihmën e OSBE-së) ka arritur të bëjë publikimin e ligjeve për patundshmëritë, ligjet civile, ligjet administrative dhe disa ligje tjera në vitin 2000. Në mes të viteve 2002 dhe 2004, ABA/CEELI ka publikuar një indeks tremujor të rregulloreve të UNMIK-ut, dhe QJK-ja po vazhdon me publikimin e rregulloreve të UNMIK-ut dhe Ligjeve të Kuvendit. Këto vëllime janë në dispozicion për blerje.

Aktualisht Kuvendi i Kosovës e ka një faqe të internetit www.assembly-kosova.org e cila përmban një bazë të dhënash ligjore të ligjeve të reja. Kjo faqe e internetit është aktualisht më gjithëpërfshirëse se sa faqja e internetit e GZ. KGJK është në proces të themelimit të një faqeje të internetit me qëllim të përfshirjes së legjislacionit relevant të Kosovës për sistemin e drejtësisë, duke përfshirë dokumentet ndërkombëtare të drejtave të njeriut, dokumentet e BE dhe artikuj ligjor akademik. Do të vihen në dispozicion për çdokënd që ka qasje në internet; mirëpo në kohën e shkrimit të këtij vlerësimi, kjo faqe e internetit nuk ishte funksionalizuar ende.

Fatkeqësisht, qasja në informata ligjore në internet nuk duket si zgjidhje e përshtatshme kur kemi para sysh infrastrukturën ekzistuese të gjyqësorit në Kosovë. Siç është vërejtur në faktorin 29 (më sipër), përderisa shumica e gjykatave e kanë së paku nga një kompjuter me qasje në internet, shumica e gjyqtarëve nuk kanë qasje në internet nga zyrat e tyre, apo u mungojnë njohuritë kompjuterike të nevojshme për t'u qasur informatave në internet.

Lista e Shkurtesave

ABA	Shoqata e juristëve amerikanë
ABA/CEELI	Shoqata e juristëve amerikanë, Iniciativa ligjore për Evropën Qendrore dhe Euro Azinë
KEFD	Konventa për eliminim e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas
AVL	Arsimimi i vazhdueshëm ligjor
CMIS	Sistemi informativ i menaxhimit të lëndëve
DAGJ	Departamenti i administratës gjyqësore
DiD	Departamenti i Drejtësisë i UNMIK-ut
AER	Agjencia evropiane për rindërtim
KEDNJ	Konventa Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive themelore të Njeriut
BE	Bashkimi Evropian
PNDCP	Pakti ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike
PCN	Përfaqësuesi civil ndërkombëtar
KPGJP	Komisioni i pavarur gjyqësor dhe prokurorial
PFAL	Programi fillestar i arsimimit ligjor
GDN	Grupi drejtues ndërkombëtar
KDGJ	Komisioni disiplinor gjyqësor
NJIGJ	Njësia për inspektimin gjyqësor
IRGJ	Indeksi i reformës gjyqësore
AKA	Agjencia e Kosovës për akreditim
OAK	Oda e avokatëve të Kosovës
KFOR	Forca e NATO-s në Kosovë
SHGJK	Shoqata e gjyqtarëve të Kosovës
KGJK	Këshilli gjyqësor i Kosovës
KGJPK	Këshilli gjyqësor dhe prokurorial i Kosovës
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
QJK	Qendra juridike e Kosovës
AKM	Agjencia kosovare e mirëbesimit
LKA	Ligji mbi konfliktin administrativ
LPP	Ligji i procedurës së përmbartimit
LPSP	Ligji për përmbartimin e sanksioneve penale
LPPA	Ligji i përgjithshëm i procedurës administrative
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MD	Ministria e Drejtësisë
NATO	Organizata e Aleancës Veri-Atlantike
GZ	Gazeta zyrtare
ZKJ	Zyra e këshilltarit juridik e PSSP-së
OSBE	Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë
KPP	Kodi i përkohshëm penal
KPPP	Kodi i përkohshëm i procedurës penale
IPVQ	Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes
ROL/Iniciativa	Iniciativa për sundimin e ligjit
RSFJ	Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë
PSSP	Përfaqësuesi special i sekretarit të përgjithshëm
KB	Kombet e Bashkuara
UNDP	Programi zhvillimor i Kombeve të Bashkuara
UNICEF	Fondi për fëmijë i Kombeve të Bashkuara
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
USAID	(Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar)



INDEKSI I REFORMËS GJYQËSORE

KOSOVË

VËLLIMI III

GUSHT 2007

Indeksi i Reformës Gjyqësore (IRGJ) është një nga instrumentet që punohet nga ekspertë të reformës ligjore e gjyqësore si dhe të zhvillimit ndërkombëtarë në Shoqatën e Avokatëve Amerikan (ABA). Shoqata e Avokatëve Amerikanë Iniciativa për Sundimin e Ligjit është pjesë e përpjekjeve të shumta globale për të vendosur një sistem gjyqësor të paanshëm dhe funksional, prandaj Indeksi mbi Reformën e Gjyqësorit (IRGJ) i publikuar nga ABA ofron një bazë të mirë empirike për ekzaminimin e pavarësisë së gjyqësorit në nivel ndërkombëtar dhe ambientin në të cilin vepron gjyqësori në të gjitha demokracitë në zhvillim.

IRGJ bazohet në krahasimin e normave ligjore vendore dhe standardeve ndërkombëtare të nxjerra nga Kombet e Bashkuara dhe Këshilli i Evropës, si dhe organizatat e tjera, për çështjet që kanë të bëjnë me kualitetin, arsimimin dhe përfaqësimin e grupeve të ndryshme të gjykatësve; kompetencat e gjyqësorit; burimet financiare; qëndrueshmëria strukturore; transparenca dhe përgjegjësia; si dhe efikasiteti.

IRGJ evaluon rrethanat dhe praktikat vendore duke përdorur 30 faktor që janë karakteristikë e një gjyqësori të pavarur, të përgjegjshëm dhe efektiv. Ky proces përmban një analizë të thellë të strukturës ligjore të vendit të lidhur me funksionimin e gjyqësorit, si dhe intervista të strukturuar informative me gjykatës, profesionistë ligjor, zyrtarë qeveritarë, si dhe përfaqësues të sektorit të tretë.

IRGJ shërben si një udhëzues i mirë për të gjithë ofruesit e asistencës teknike ligjore, përkrahësit e reformës ligjore dhe asaj gjyqësore si dhe komunitetin ndërkombëtar. Gjithashtu, ky indeks u ndihmon gjyqtarëve, dhe të tjerëve që janë pjesë e komunitetit ligjor, në punën e mëtutjshme me qeveritë dhe organizatat joqeveritare në përkrahje të iniciativave për reformën e gjyqësorit.



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA